

NDËRHYRJET PËR SJELLJET POZITIVE NË SHKOLLË SI MËNYRË PËR PARANDALIMIN E DHUNËS

UDHËZUES PËR SHKOLLAT 9-VJEÇARE

2019





Publikimi “Ndërhyrjet për sjelljet pozitive në shkollë” u realizua në kuadrin e bashkëpunimit të Institutit të Zhvillimit të Arsimit me UNICEF-in. Opinionet dhe sugjerimet e paraqitura në këtë botim i përkasin autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht këndvështrimet e UNICEF-it.

Autorë

Albana Markja

Evis Mastrori


Gerti Janaqi

Për hartimin e manualit kontribuan Znj. Shqiponja Lamçe, Specialiste e Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë, specialistë të Edukimit dhe e Fëmijërisë së Hershme në UNICEF si dhe shumë mësues e punonjës arsimor në vend.

PËRMBAJTJA

Hyrje

FAQE 7



KUADRI LIGJOR NDËRKOMBËTAR DHE KOMBËTAR PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE	9
Kuadri Ligjor ndërkombëtar për mbrojtjen e fëmijëve në Shqipëri	11
Kuadri Ligjor kombëtar për mbrojtjen e fëmijëve në Shqipëri	13
Përgjegjësitë e stafit arsimor për referimin e fëmijëve në nevojë për mbrojtje	17



NDËRHYRJET PËR SJELLJEN POZITIVE (NSP) NË SHKOLLË	23
Koncepti i Ndërhyrjeve për Sjelljen Pozitive (NSP-të)	25
Parimet bazë të NSP-ve	27
Përse është e rëndësishme të përqendrohemi në mësimin e sjelljeve shoqërore pozitive?	27
Qasja tri nivelesh e ndërhyrjes për parandalimin e sjelljeve problematike	28
Si funksionojnë NSP-të?	31



MODULI 3	ZBATIMI I NSP-ve NË SHKOLLË	35
	Karakteristikat dhe parimet e zbatimit të NSP-ve në shkollë	36
	Hapat dhe proceset e zbatimit të NSP-ve në shkollë	38
	NIVELI 1 – i ndërhyrjes për sjelljet pozitive	38
	NIVELI 2 – i ndërhyrjes për sjelljet pozitive	47
	NIVELI 3 - i ndërhyrjes për sjelljet pozitive	50
	Ekipi koordinues i NSP-ve në shkollë	51
	Roli i ekipit koordinues të shkollës	52
	Përbërja e ekipit koordinues të shkollës	52
	Vlerësimi i nevojave	53
	Krijimi i një plani të shkollës	54
	Vendosja e pritshmërive për shkollën sipas MNSP-ve	54



PËRMBAJTJA



MODULI 4

STRATEGJI TË NSP-ve NE NIVEL KLASË	57
Praktikat e NSP-ve në klasë	59
Vetëvlerësimi ndërhyrjeve dhe mbështetjes në klasë	61
Tabela 1. Matrica e hapave fillestarë për NSP-të në klasë	62
Tabela 2. Matrica e praktikave për ndërhyrjet dhe mbështetjet në klasë	66
Tabela 3. Matrica e sistemeve të të dhënave për ndërhyrjet dhe mbështetjet në klasë	74



MODULI 5

VETËVLERËSIMI I PRAKTIKAVE TË NSP-VE NË SHKOLLË DHE NË KLASË	85
Instrument për shkollën dhe mësuesin	88
Instrument për shkollën	89
Instrument për shkollën	90
Instrument për klasën & mësuesin	91
Instrument për nxënësin	92
Fishë vetëvlerësimi: Menaxhimi i klasës	93
Fishë e planit të veprimeve për përmirësimin e menaxhimit të klasës	95

SH TOJ CA	97
------------------	-----------



NSP	Ndërhyrjet për Sjelljet Pozitive
PNF	Përvojat Negative në Fëmijëri
COMBI	Komunikimi për Ndryshimin e Sjelljes
MASR	Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë
MRD	Mënyrat e Reja të Disiplinës
NSP	Ndërhyrjet për Sjelljen Pozitive
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
DHNF	Dhuna ndaj Fëmijëve
KDF	Konventa për të Drejtat e Fëmijës
OKB	Organizata së Kombeve të Bashkuara
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
NJMF	Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës
PMF	Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijëve
PIM	Plani Individual i Mbrojtjes
GTN	Grupi Teknik Ndërsektorial
NJAV	Njësive Arsimore Vendore

AKRONIME



Hyrje

Ecuria drejt pakësimit të dhunës ndaj fëmijëve (DHNF) në shkollat shqiptare ka qenë proces i ngadaltë, por me hapa të sigurt. Në vitin 2010, UNICEF-i në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Rinisë (MASR) filloi të pilotojë programin novator të Komunikimit për Ndryshimin e Sjelljes në disa shkolla të përzgjedhura publike, duke targetuar drejtuesit e shkollave, mësuesit dhe prindërit në mënyrë që të ndryshonin qëndrimet dhe praktikat ndaj disiplinimit të dhunshëm të fëmijëve.

Rreth 3,900 mësues në shkollat e arsimit publik bazë kanë zbatuar praktikën “Mënyrat e Reja të Disiplinimit” (MRD), në kuadër të programit COMBI, ndërkohë që janë mbajtur rreth 4,000 diskutime joformale me mësuesit për zgjidhjen jo të dhunshme të konflikteve, dhe 5,200 advokues të MRD-së, anëtarë të grupeve advokuese të MRD-së, kanë promovuar disiplinimin pozitiv në shkolla. Nga ana e mësuesve, DHNF-ja është pakësuar falë ndikimit të Programit të Komunikimit për Ndryshimin e Sjelljes (COMBI). Krahasimi i matjeve të dhunës në shkolla, i kryer gjatë zbatimit të programit COMBI, në vitet 2015-2016, tregoi se kërcënimet e mësuesve ishin pakësuar nga 22% në 14%, ndërsa ofendimet nga 16% në 10%. Përgjithësisht, në vetëm 12 muaj u vu re një rënie midis 2% dhe 8% e llojeve të ndryshme të dhunës fizike dhe psikologjike, e përdorur nga mësuesit për të disiplinuar nxënësit¹.

1. Raporti i Vlerësimit Krahasues “Dhuna ndaj fëmijëve në shkolla në Shqipëri” në kuadër të Programit Kombëtar COMBI, Dhjetor 2016



DHNF-ja në shkolla mbetet një shqetësim, pavarësisht ecurisë së shënuar. Një studim i kryer² në vitin 2017 tregoi se 83% e nxënësve në arsimin e detyruar vuajnë nga lloje të ndryshme të dhunës nga mësuesit, duke përfshirë ofendime, gjuhë tallëse dhe poshtëruese, etiketime dhe nofka. Gjithashtu, studimi tregoi se fëmijët shpreheshin se i kishin përjetuar të gjitha format e dhunës, verbale, emocionale dhe fizike, edhe nga prindërit e tyre.

Përpjekjet për të mbështetur sjelljet pozitive në shkolla vazhdojnë dhe kanë shënuar një prioritet të dukshëm në punën e institucioneve arsimore. Por, detyra është e vështirë. Na duhet të ballafaqohemi sistematikisht me sfidat që ky fenomen sjell dhe të identifikojmë strategji të plota për të ndërhyrë dhe mbështetur sjelljet pozitive dhe parandaluar rastet e dhunës.

Udhëzuesi “Ndërhyrjet për sjelljet pozitive në shkollë (NSP)” vjen si material burimor që synon tu vijë në ndihmë shkollave 9 vjeçare, duke ofruar dhe nxitur metodologji dhe praktika disiplinimi, që përdoren për të nxitur sjelljen pozitive në shkollë. Praktikant NSP i ndihmojnë mësuesit të kuptojnë rëndësinë e menaxhimit të klasës si dhe të nxisin maksimalisht suksesin e nxënësve. Strategjitë e NSP -ve janë thelbësore për t’iu mundësuar të gjithë fëmijëve një mjedis sa më të mirë të të nxënës.

Thelbi i programit të NSP–ve është parandalimi dhe jo ndëshkimi. Përvojat në vende që zbatojnë programe të tilla, tregojnë se me anë të NSP-ve është rritur siguria dhe sjelljet pozitive në shkollë. Nxënësit që ndëshkohen më pak, arrijnë rezultate më të larta dhe ndjehen më mirë në shkollë.

Përdorues të drejtpërdrejtë të këtij udhëzuesi janë mësuesit, nxënësit, drejtuesit e shkollave, prindërit, specialistë të Njësive Arsimore Vendore (NJAV), aktorë dhe partnerë të tjerë të institucioneve të arsimit 9-vjeçar. Shpresojmë që udhëzuesi të ndihmojë institucionet arsimore të planifikojnë ndërhyrje, të cilat ndihmojnë në edukimin dhe përgatitjen e nxënësve, stafeve të shkollave dhe anëtarëve të tjerë të komunitetit për të menaxhuar situatat që mund të lindin për shkak të sjelljeve të papërshtatshme.

Falënderojmë UNICEF për ndërmarrjen dhe mbështetjen e kësaj iniciative, si dhe të gjithë individët, grupet dhe institucionet që kanë kontribuar në përgatitjen e këtij produkti.

Autorët


2. <https://ec.europa.eu/epale/sites/epale/files/raport-studimin-etika-ne-sistemin-arsimor-ne-shqiperi.pdf>





MODULI 1

**KUADRI LIGJOR
NDËRKOMBËTAR DHE
KOMBËTAR PËR MBROJTJEN E
FËMIJËVE**



KUADRI LIGJOR NDËRKOMBËTAR DHE KOMBËTAR PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE

PRITSHMËRITË:

- Njohja me kuadrin ligjor ndërkombëtar për mbrojtjen e fëmijëve
- Njohja dhe përskrimi i kuadrin ligjor kombëtar për mbrojtjen e fëmijëve
- Identifikimi dhe kuptimi i hapave për referimin e fëmijëve në nevojë për mbrojtje

Gjatë viteve të fundit Shqipëria ka përjetuar ndryshime të rëndësishme për sa i përket ratifikimit dhe nënshkrimit të konventave dhe akteve të ndryshme ndërkombëtare për mbrojtjen e fëmijëve. Kushtetuta e Shqipërisë parashikon një hierarki pozitive të ligjit ndërkombëtar, duke e vendosur normën ndërkombëtare, përmbi kodet dhe ligjet e vendit. Një ndër karakteristikat e normës ndërkombëtare, është se ajo është e detyrueshme për t'u zbatuar nga shteti ratifikues dhe organet e zbatimit të ligjit, njësoj si ligji i brendshëm. Një ndër dokumentet më të hershëm që thekson të drejtat e njeriut është aprovimi i **"Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut nga OKB-ja**, që do të paraprinte përgatitjen dhe aprovimin e **"Konventës për të Drejtat e Fëmijës"** (KDF) nga Asambleja e Përgjithshme në 20 Nëntor 1989. KDF-ja është ratifikuar nga 195 shtete. Shqipëria e ratifikoi KDF-në në 28 Shkurt të vitit 1992 dhe ajo hyri në fuqi një muaj më pas. KDF ngrihet mbi katër parime bazë, të cilat janë: Mosdiskriminimi; Interesi më i lartë i fëmijës; E drejta për mbijetesë dhe zhvillim; Pjesëmarrja e fëmijëve. KDF-ja përmban disa nene që i dedikohen mbrojtjes së fëmijëve nga dhuna dhe keqtrajtimi, përfshirë edhe mbrojtjen e fëmijëve nga të gjitha format e shfrytëzimit, duke e konsideruar atë si një ndër format më të rënda të dhunës ndaj fëmijëve. Neni 19, paragrafi i parë, i KDF-së thotë: "Shtetet Palë marrin të gjitha masat legjislative, administrative, shoqërore dhe edukative për mbrojtjen e fëmijës nga çdo formë e dhunës fizike ose mendore, fyerja ose keqtrajtimi, braktisja



apo mospërfillja, nëpërkëmbja ose shfrytëzimi, përfshirë abuzimin seksual, për sa kohë që ai është nën ruajtjen e prindërve të tij ose të njërit prej tyre, të përfaqësuesit ose përfaqësuesve të tij ligjorë ose të çdo personi tjetër të cilit i është besuar.” Neni 19 gjithashtu përcakton se masat e mbrojtjes, të propozuara në paragrafin 1 më sipër, përfshijnë ndër të tjera edhe “procedura të efektshme për hartimin e programeve shoqërore për përkrahjen e nevojshme të fëmijës dhe atyre që kujdesen për të, si dhe për forma të tjera parandalimi dhe identifikimi, raportimi, referimi, hetimi, trajtimi dhe ndjekjeje të rasteve të keqtrajtimit të fëmijës, të përshkruara më lart, duke përfshirë, nëse duhet, procedurat e ndërhyrjes gjyqësore.” Neni 34: “Shtetet Palë marrin përsipër të mbrojnë fëmijën nga çdo lloj forme e shfrytëzimit seksual dhe keqtrajtimit seksual. Për këtë qëllim, Shtetet Palë marrin në mënyrë të veçantë të gjitha masat e duhura në planin kombëtar, dypalësh dhe shumëpalësh për të mos lejuar që:

- (a) Fëmijët të nxiten ose të detyrohen për t’u përfshirë në veprimtari të paligjshme seksuale;
- (b) Fëmijët të shfrytëzohen për qëllime prostitucioni ose praktika të tjera seksuale të paligjshme;
- (c) Fëmijët të shfrytëzohen për shfaqje ose materiale pornografike”.

Neni 35: “Shtetet Palë marrin të gjitha masat e nevojshme në planin kombëtar, dypalësh dhe shumëpalësh, për të mos lejuar rrëmbimin, shitjen, ose trafikun e fëmijëve për çdo

qëllim dhe në çfarëdo forme qoftë”. Neni 36: Shtetet Palë mbrojnë fëmijën nga çdo formë tjetër shfrytëzimi, që dëmton në çfarëdo aspekti mirëqenien e tij.

Sot Konventa për të Drejtat e Fëmijës është një nga aktet kryesore ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe dokumenti më universal për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në botë, pasi ndër të tjera ka këto karakteristika: - Është një instrument universal; - Është një instrument ligjërshët i zbatueshëm; - Krijon një vizion për fëmijën; - Ripërforcon rëndësinë e mbrojtjes së dinjitetit njerëzor; - Mbron rolin e familjes në jetën e fëmijës ; - Kërkon respekt për fëmijët; - Ngarkon përgjegjësi të qarta për të gjitha palët. Ajo cakton standarde universale për të drejtat e fëmijëve, të cilat nuk janë të negociueshme e që i japin mbrojtje dhe mbështetje fëmijëve e të drejtave të tyre.

“Konventa e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi dhe Abuzimi Seksual”¹ e njohur ndryshe si **“Konventa e Lanzarotit”**, është një ndër aktet ndërkombëtare më të të rëndësishme për mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi dhe shfrytëzimi seksual në Europë. Konventa është e detyrueshme për t’u zbatuar vetëm në vendet që janë pjesë e Këshillit të Evropës. Një Komitet Ekspertësh të Këshillit të

1. <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=090000168046e1e3>



Europës e përgatiti këtë dokument që hyri në fuqi në 1 Korrik 2010. Objektivi i Konventës është mbrojtja e fëmijëve nga çdo lloj formë e dhunës dhe shfrytëzimit seksual. Qëllimi i këtij dokumenti është mbrojtja e viktimave të dhunës nga njëra anë, dhe parandalimi i shfrytëzimit dhe dhunës seksuale të fëmijëve nga ana tjetër, duke kërkuar në mënyrë të posaçme përndjekjen por dhe trajtimin e atyre që kryejnë krime seksuale ndaj fëmijëve. Ndër të tjera Konventa garanton një frymë koherente dhe mbrojtje të barabartë për fëmijët, duke vendosur standarde dhe përkufizime të zbatueshme në të gjithë Europën. Shqipëria e ratifikoi Konventën e Lanzarotit në 14 Prill 2009, duke u renditur ndër katër vendet e para që vepruan në këtë mënyrë. **“Konventa e Këshillit të Europës mbi Ushtrimin e të Drejtave të Fëmijëve”**² është ratifikuar vetëm nga 17 shtete anëtare të Këshillit të Europës, ndërkohë që vetëm 11 prej tyre e kanë nënshkruar atë. Konventa ka për qëllim të mbrojë interesin më të lartë të fëmijës nëpërmjet masave procedurale, të cilat lejojnë që fëmijët të ushtrojnë pa pengesa të drejtat e tyre, sidomos në procedurat familjare përpara autoriteteve gjyqësore. Kjo Konventë u hap për nënshkrim dhe ratifikim në Strasburg në 25 Janar 1996 dhe hyri në fuqi në 1 Korrik 2000, ndërsa vendi ynë e ratifikoi këtë instrument në 1 Shkurt 2012.

2. <https://www.parlament.al/Files/sKuvendi/Femijet/Guida-e-Parlamentareve-2016-FINALE-version-botimi.pdf>

Kuadri Ligjor kombëtar për mbrojtjen e fëmijëve në Shqipëri

Gjatë dy dekadave të fundit Shqipëria ka përjetuar ndryshime të konsiderueshme në fushën e mbrojtjes së fëmijëve, duke ndërmarrë iniciativa nga më të ndryshmet për të parandaluar dhe trajtuar rreziqet që prekin sigurinë e fëmijëve. Qeveria, në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile dhe partnerë të tjerë, ka ndërmarrë masa për miratimin e një sistemi për mbrojtjen e fëmijëve. Për sa i përket kuadrit ligjor kombëtar duhet theksuar që është bërë një punë e rëndësishme me përmirësimin tij por mbetet për t'u thënë që kemi ende punë përpara. Në Shqipëri tashmë ekzistojnë ligje, dispozita normative, urdhra, rregullore, udhëzime që janë riparë duke vendosur theksin tek mbrojtja e fëmijëve nga çdo lloj dhune. Akti kryesor juridik i vendit tonë **“Kushtetuta e Shqipërisë”**: trajton çështje të dhunës ndaj fëmijëve në mënyrë specifike dhe të drejtpërdrejtë, duke i siguruar fëmijëve të drejtën themelore për t'u mbrojtur (Neni 54). Sipas Kushtetutës, fëmijët kanë këto të drejta: të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti; të drejtën për t'u mbrojtur nga dhuna dhe keqtrajtimi; të drejtën për t'u mbrojtur nga shfrytëzimi dhe puna që mund të jetë e dëmshme ose që mund të vërë në rrezik shëndetin ose zhvillimin e tyre. **Ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”**³ në nenin 2 thekson qëllimet

3. <http://femijet.gov.al/wp-content/uploads/2017/07/LIGJI-NR-18->



që ka ky ligj dhe disa nga prej tyre janë a) mbrojtja e fëmijës, nëpërmjet plotësimit të kuadrit ligjor e institucional, në zbatim të Kushtetutës, të Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës, të akteve ndërkombëtare që veprojnë në këtë fushë, si dhe të legjislacionit në fuqi; ç) marrja e masave për t'i siguruar fëmijës ushtrimin e të drejtave, në përputhje me zhvillimin e personalitetin, bazuar në interesin më të lartë të tij; dh) sigurimi i bashkëpunimit ndërmjet strukturave dhe autoriteteve qendrore e vendore, si dhe organizatave që mbrojnë të drejtat e fëmijës; e) parashikimi i mekanizmave efektivë dhe funksionimi i institucioneve të ngarkuara me marrjen e masave konkrete për promovimin, respektimin e mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, si dhe për ngritjen e një sistemi të integruar e funksional të mbrojtjes së fëmijës, për parandalimin dhe përgjigjen efikase ndaj të gjitha formave të dhunës, abuzimit, shfrytëzimit e neglizhimit. Gjithashtu, në nenin 5 përshkruhen parimet kryesore për realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijës: Fëmija është bartës i të drejtave dhe këto të drejta janë universale, të patjetërsueshme, të pandashme, të ndërvarura dhe progresive. Një tjetër parim është interesi më i lartë i fëmijës për çdo veprim që ka të bëjë me fëmijën. Barazia dhe mosdiskriminimi është një tjetër parim. Në këtë nen thuhet gjithashtu se për mbrojtjen e fëmijës të gjithë aktorët duhet të ndajnë përgjegjësitë, prindërit ose kujdestarët e fëmijës, autoritetet shtetërore dhe

[2017-%E2%80%9CP%C3%8BR-T%C3%8B-DREJTAT-DHE-MBROJTJEN-E-F%C3%8BMIJ%C3%8BS%E2%80%9D.pdf](#)



shoqëria. Çdo fëmijë duhet të jetojë e të rritet në një mjedis të përshtatshëm familjar dhe ndarja e fëmijës nga familja duhet parë si zgjidhja e fundit. Decentralizimi i shërbimeve që ofrohen për mbrojtjen e fëmijës, ndërhyrja ndërsektoriale dhe partneriteti ndërmjet institucioneve publike e jopublike, të autorizuara me ligj është një tjetër parim. Ofrimi i shërbimit të personalizuar e të specializuar duhet të jetë për çdo fëmijë. Disa parime të tjera janë: respektimi i dinjitetit, nderit dhe personalitetit të fëmijës, pjesëmarrja, dëgjimi dhe respektimi i mendimit të fëmijës, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar. Gjithashtu garantimi i stabilitetit dhe vazhdimësisë në kujdesin, rritjen dhe edukimin e fëmijës, duke mbajtur parasysh formimin e tij etnik, fetar, kulturor dhe gjuhësor.

Në nenin 23 “Mbrojtja nga të gjitha format e dhunës” përcakton:

1. Fëmija ka të drejtë të mbrohet ndaj të gjitha formave të dhunës, duke përfshirë abuzimin, neglizhimin, shfrytëzimin, trafikimin, pengmarrjen, pornografinë, abuzimin seksual, si dhe forma të tjera të dhunës, pavarësisht vendit ku kryhet, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. Fëmija mbrohet edhe nga të gjitha format e migracionit të paligjshëm, sipas legjislacionit në fuqi për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror.
2. Prindërit e fëmijës ose kujdestari, në bashkëpunim me

institucionet e kujdesit shëndetësor, të edukimit, strukturat e mbrojtjes së fëmijës dhe ofruesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror marrin të gjitha masat e nevojshme për të bërë të mundur rehabilitimin fizik, psikologjik e emocional, si dhe integrimin social të fëmijës viktimë e dhunës, neglizhimit, shfrytëzimit ose abuzimit, sipas legjislationit në fuqi.

3. Subjektet e përmendura në pikën 2, të këtij neni, sigurojnë të gjitha kushtet e nevojshme, me qëllim integrimin e fëmijës në një jetë normale dhe duke respektuar dinjitetin e vetëvendosjen e fëmijës, në përputhje me moshën e tij.

4. Ndalohet ndëshkimi trupor ose i ndonjë forme tjetër, që sjell pasoja në zhvillimin fizik dhe mendor të fëmijës". Në nenin 3 pika 16 thuhet: "Shërbimi psiko-social shkollor" është shërbimi që u ofron mbështetje nxënësve dhe punonjësve të institucioneve arsimore për identifikimin dhe trajtimin e problematikave të ndryshme, sipas nevojave psiko-sociale të komunitetit shkollor, i cili sigurohet nga njësitë arsimore vendore".

Në Nenin 18 gjithashtu thuhet: Ministria përgjegjëse për arsimin parauniversitar, si autoritet publik përgjegjës, si dhe njësitë arsimore vendore marrin masa konkrete, me qëllim që: g) të ngrenë mekanizma efikase për parandalimin, trajtimin brenda shkollës dhe raportimin tek autoritetet përgjegjëse të situatave të dhunës, duke përfshirë edhe ato ndërmjet vetë fëmijës brenda shkollës (bulizmi); gj) të parashikojnë dhe

zbatojnë sanksione të përshtatshme për personelin arsimor, në rastet kur ai lejon, nxit, toleron ose nuk raporton veprime të dhunshme ose ngacmimi të fëmijës në institucionet e edukimit, sipas këtij ligji.

Gjithashtu dhe nenet 24, 26, 27 dhe 28 parashikojnë mbrojtje të fëmijës nga forma të veçanta të dhunës apo abuzimit: shfrytëzimi ekonomik, ku përfshihen fëmijët në situatë rruge, mbrojtja e fëmijëve në internet nga përmbajtje të dëmshme ose të paligjshme, mbrojtja nga konfliktet e armatosura dhe në situata emergjence civile, mbrojtja nga trafikimi, abuzimi apo shfrytëzimi seksual.

Ndërsa neni 45 përcakton: "1. Punonjësit e strukturave për mbrojtjen e fëmijës, si dhe punonjësit, të cilët punojnë me fëmijët, nuk mund të punësohen dhe, kur janë të punësuar, përfundojnë marrëdhënien e punës në rast se: a) janë dënuar me dënim të formës së prerë për vepra penale kundër personit, të kryera me dashje; b) ndaj tyre është marrë, me vendim gjykate, një nga masat mbrojtëse ndaj dhunës në familje. Në Nenin 67 "Detyrimi për raportim" thuhet: "Mësuesit dhe ofruesit e shërbimit psiko-social shkollor kanë për detyrë të raportojnë çdo rast të dyshuar apo të ndodhur, abuzimi, neglizhimi apo shfrytëzimi të fëmijës në njësitë arsimore vendore ose strukturat për mbrojtjen e fëmijës. Njësia arsimore vendore, në çdo rast, kur merr dijeni për fëmijë në nevojë për mbrojtje, bën raportimin te strukturat për mbrojtjen e fëmijës".



Instrumente të tjera themelore ligjore e kombëtare janë “Kodi Penal”, “Kodi Civil”, “Kodi i Familjes”, Ligji “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, “Ligji për Asistencën dhe Shërbimet Sociale”, “Ligji kundër Trafikimit”, “Ligji për mbrojtjen nga Diskriminimi”, dhe një sërë ligjesh dhe vendimesh specifike që përmbajnë dispozita që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo tërthorazi kanë të bëjnë me respektimin e të drejtave të fëmijëve dhe mbrojtjen e tyre.

Një dokument tjetër i rëndësishëm është “Agjenda Kombëtare Për të Drejtat e Fëmijëve 2017-2020”⁴ që ka si qëllim thelbësor mbrojtjen efektive dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve. Gjithashtu “Strategjia e Mbrojtjes Sociale 2015-2020” vendos objektiva të qarta për të ndërtuar një sistem të konsoliduar dhe gjithëpërfshirës të mbrojtjes sociale në Shqipëri. “Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015 – 2020” është dokumenti kryesor strategjik kombëtar që mbështet zhvillimin e qëndrueshëm social dhe ekonomik të vendit duke shërbyer si parandalim për dhunën ndaj fëmijëve. Një nga prioritetet e “Strategjisë së Arsimit Parauniversitar 2014-2020”⁵ është: “Krijimi i një mjedisi miqësor dhe pa dhunë për fëmijët”. Ligji i Arsimit Parauniversitar nr. 69/2012” i ndryshuar në Ligjin. 48/2018, në nenin 6.3 thotë: “Në sistemin

4. <http://femijet.gov.al/wp-content/uploads/2017/05/Permbledhje-e-Agjendes-Kombetare-per-te-Drejtat-e-Femijeve-2017-2020.pdf>.

5. http://www.arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2017/10/Ligji_Parauniversitar.pdf

arsimor parauniversitar, nxënësve dhe punonjësve u ofrohet mbrojtje nga çdo formë veprimi ose mosveprimi që mund t’u shkaktojë diskriminim, dhunë, keqtrajtim ose dëm moral”. Ndërsa në dispozitat normative, neni 40 në pikën 1 dhe pikën 2 (a) pohohet se: Punonjësi arsimor respekton Kodin e Etikës së Mësuesit. 2. Në veçanti, punonjësi arsimor e ka të ndaluar: a) të ushtrojë dhunë fizike ose psikologjike ndaj nxënësve ose kolegëve. Ndërsa në nenin 69 në pikën 2 (a dhe b) thuhet se: “Mësuesi ka për detyrë: a) të trajtojë këdo, në mjediset e institucionit arsimor, me respekt, me dinjitet, në mënyrë të kulturuar dhe të moralshme, pa presione, pa padrejtësira, pa fyerje, pa diskriminime, pa dhunë; b) të përkujdeset për mbarëvajtjen e çdo nxënësi të tij”.

Gjithashtu në nenin 85 në pikën 1 (a,b,c) thuhet: “Nxënësi ka të drejtë: a) të kryejë veprimtaritë e tij në institucionin arsimor në kushte të qeta dhe të sigurta për jetën dhe shëndetin; b) të trajtohet me respekt, me dinjitet, në mënyrë të kulturuar dhe të moralshme në institucionin arsimor, pa presione, pa padrejtësira, pa fyerje, pa diskriminime, pa dhunë; c) të njihet me të drejtat dhe detyrat e tij në institucionin arsimor”. Urdhri nr.344 Nr. 19.08.2013⁶ (riparë nr.150, datë 03.04.2018) i MASR parashikon ngritjen e njësisë së shërbimit psiko-social pranë Drejtorive Arsimore dhe Zyrave Arsimore. Numri i psikologëve shkollorë llogaritet mbi bazën e numrit të nxënësve dhe

6. http://www.vet.al/files/ligje%20etj/2013_2014/urdher-344-sherbimi-psiko-social.pdf



nivelin e shkollimit të tyre. Rregullimet ligjore të këtij urdhri përfshihen edhe në Dispozitat Normative për Arsimin Parauniversitar ku: "Shërbimi psiko-social vlerëson gjendjen psiko-sociale të nxënësve me probleme të nxënësve ose sjelljes dhe, në bashkëpunim me mësuesit, drejtuesit e institucioneve arsimore dhe prindërit, planifikon e realizon shërbime të përshtatshme që ndihmojnë në zhvillimin arsimor, social dhe personal të nxënësit.

Një dokument tjetër i rëndësishëm është "**Vendimi nr. 578, datë 3.10.2018 "Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes"**. Për informacione më të detajuara mund të lexoni në: (<http://www.qbz.gov.al/Botime/Akteindividuale/Janar%202018/Fletore%20144/VKM%20nr.%20578,%20date%203.10.2018.pdf>)

Përgjegjësitë e stafit arsimor për referimin e fëmijëve në nevojë për mbrojtje

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 54, të ligjit nr. 18/2017, "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave vendosi miratimin e "**Vendimit nr. 578, datë 3.10.2018 "Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit**

individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes": Qëllimi i këtij vendimi është të përcaktojë rregullat dhe procedurat e referimit dhe të menaxhimit të rastit të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, mënyrën e hartimit dhe përmbajtjen e Planit Individual të Mbrojtjes (PIM), financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes. Ndër të tjera përcaktimet e këtij vendimi janë të detyrueshme për të gjitha autoritetet shtetërore, mekanizmat këshillimorë e koordinues institucionalë, strukturat për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës në nivel qendror dhe nivel vendor, institucionet publike apo private, organizatat jofitimprurëse dhe të gjithë personat e tjerë, të cilët kanë për detyrë funksionale, profesionale, kontraktuale apo ligjore të kryejnë referim, menaxhim, koordinim apo të ofrojnë një shërbim, në kuadër të ligjit nr. 18/2017, "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës".

Parimet udhëheqëse në menaxhimin e rastit bazohen në parimin e interesit më të lartë të fëmijës, të respektimit të nderit, dinjitetit dhe personalitetit të fëmijës, konfidencialitetit, promovimin e së drejtës së fëmijës për mbrojtje dhe përkujdesje, respektimin e së drejtës për t'u dëgjuar, informuar, në lirinë e shprehjes, mosdiskriminimin, partneritetin e bashkëpunimin, si dhe në respektimin e përgjegjësieve.



Hapat e menaxhimit të rastit të rastit të fëmijës në nevojë për mbrojtje:

1. Identifikimi;
2. Raportimi;
3. Vlerësimi fillestar;
4. Vlerësimi i plotë;
5. Hartimi i Planit Individual të Mbrojtjes;
6. Zbatimi, ndjekja dhe monitorimi i PIM-it;
7. Mbyllja e rastit.



Më poshtë do të përshkruajmë disa nga hapat e menaxhimit të rastit të rastit të fëmijës në nevojë për mbrojtje:

- 1) Identifikimi;
- 2) Raportimi;
- 3) Vlerësimi fillestar;
- 4) Vlerësimi i plotë;
- 5) Hartimi i Planit Individual të Mbrojtjes;
- 6) Zbatimi, ndjekja dhe monitorimi i PIM-it;
- 7) Mbyllja e rastit.

Identifikimi i një fëmije në nevojë për mbrojtje bëhet nga çdo person fizik ose juridik, çdo punonjës i institucioneve publike dhe private, i cili vihet në kontakt me fëmijën, mësuesit, ofruesit e shërbimit psikosocial shkollor, strukturat e Policisë së Shtetit, Drejtoria për Azilin dhe Antitrafikimin, Qendra Kombëtare e Pritjes për Azilkerkuesit, punonjësit e institucioneve shëndetësore apo të përkujdesjes së fëmijës, publike apo private, si dhe vetë fëmijët.

Gjithashtu Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës (NJMF) dhe Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijës (PMF) kanë për detyrë të kryejnë identifikimin e fëmijëve në nevojë për mbrojtje, nëpërmjet punës në terren dhe verifikimit të njoftimit të marrë nga çdo person fizik ose juridik. Pas identifikimit të fëmijës në nevojë për mbrojtje, çdo person fizik ose juridik, i cili vihet në kontakt me fëmijën për shkak të profesionit, duhet të bëjë **raportimin** pranë strukturave vendore të mbrojtjes së fëmijës ose pranë organeve të Policisë së Shtetit.

Çdo mësues, ofrues i shërbimit psikosocial shkollor, punonjës i institucioneve shëndetësore apo i përkujdesjes së fëmijës, publike

apo private, pas identifikimit të fëmijës në nevojë për mbrojtje, duhet të bëjë raportimin pranë Njësisë Arsimore Vendore, drejtorit të institucionit, organeve të Policisë së Shtetit dhe strukturave për mbrojtjen e fëmijës. Profesionistët e përmendur më lart ose struktura përgjegjëse pranë institucionit/ve raportojnë menjëherë, me çdo mjet komunikimi, rastet që identifikohen si në rrezik⁷ të menjëhershëm apo të lartë, ndërsa, rastet e tjera të rrezikut, të mesëm apo të ulët, raportohen brenda 24 orëve nga identifikimi. Në rast se është e pamundur të kontaktohen këto struktura, njoftohet Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës. Me marrjen e raportimit, NJMF-ja/PMF-ja ka detyrimin të verifikojë informacionin e dhënë fillimisht dhe bën **vlerësimin fillestar të rastit** (vlerësim i nivelit të rrezikut, mundësisht brenda 24 orëve). PMF-ja, pas vlerësimit të rrezikut vlerëson nevojat bazë (ushqim, higjienë, strehim dhe kujdes shëndetësor) dhe bën gjithashtu një analizë të; shërbimeve të domosdoshme, me qëllim përmbushjen e nevojave të identifikuara në kushtet e emergjencës. Nëse pas vlerësimit fillestar rezulton se fëmija nuk është në nevojë për mbrojtje, atëherë PMF-ja nuk hap dosje, por e referon atë pranë institucioneve përgjegjëse për ndjekje të situatës apo ofrimin e shërbimit të nevojshëm.

Nëse pas vlerësimit fillestar PMF-ja konstaton ekzistencën e rrezikut, edhe pasi i ka siguruar fëmijës shërbimet e nevojshme, për shkak të kushteve të emergjencës, ajo hap një dosje specifike për fëmijën. PMF-ja bën **vlerësimin e plotë** që kryhet për çdo rast të fëmijës në nevojë për mbrojtje dhe përcakton nivelin e rrezikut, në të cilin ndodhet fëmija dhe mbledh informacionin e nevojshëm për hartimin e **Projektplanit Individual të Mbrojtjes (PIM)**⁸. Gjithashtu PMF-ja përveç shkallës së rrezikut

7. "Rrezik i menjëhershëm", situata në të cilën gjendet fëmija, i cili, në momentin e identifikimit nuk ka aftësi vetëmbrojtëse dhe, nëse lihet në rrethanat aktuale, pa asnjë ndërhyrje mbrojtëse apo kujdes shëndetësor, mund të vdesë, të dëmtohet ose të plagoset rëndë, mund të abuzohet seksualisht, të trafikohet apo të jetë pre e keqtrajtimit të tjera, të konsideruara vepër penale, sipas Kodit Penal. Ndërhyrja, në këtë rast, duhet të jetë urgjente dhe të sigurojë largimin e fëmijës nga situata e rrezikut. "Rrezik i lartë", situata në të cilën gjendet fëmija, i cili, për shkak të faktorëve të ndryshëm rrezikon që të dëmtohet rëndë, të jetë subjekt i llojeve të ndryshme të abuzimit në mënyrë të vazhdueshme apo të dëmtohet në mënyrë të tillë që të vuajë nga paaftësi të përhershme ose t'i rrezikohet seriozisht mirëqenia, nëse nuk merren masa për ta mbrojtur atë. "Rrezik i mesëm", situata në të cilën gjendet fëmija, për të cilin nuk ka të dhëna që të jetë në rrezik për të pësuar dëmtime të rënda apo të ketë pësuar dëmtime të rënda, por ekziston mundësia që të dëmtohet apo të abuzohet nëse nuk merren masa për ta mbrojtur atë. Ndërhyrja për të mbrojtur fëmijën dhe për të ofruar shërbime është e domosdoshme. "Rrezik i ulët", situata në të cilën gjendet fëmija, i cili është relativisht i sigurt, nuk vuan nga dëmtime që kanë ardhur si rrjedhojë e abuzimit dhe ka aftësi për të mbrojtur veten. Vlerësohet se ka prezencë të faktorëve të rrezikut dhe se fëmija mund të bëhet pre e abuzimit, dhunës, neglizhimit apo shfrytëzimit nëse nuk realizohen ndërhyrje për t'i ofruar respektimin dhe aksesin në të drejta apo nëse nuk i ofrohen shërbimet, për të cilat fëmija ka nevojë.

8. Projektplanin Individual i Mbrojtjes hartohet mbi bazën e nevojave të identifikuara të rastit dhe përmban veprimet, ndërhyrjet konkrete dhe shërbimet e nevojshme për të ulur nivelin e rrezikut, vendimin për masën e mbrojtjes, autoritetet dhe aktorët përgjegjës, afatet kohore.



vlërëson edhe periudhën dhe faktorët e rrezikut. Në rastet kur fëmija në nevojë për mbrojtje është në nivel rreziku të mesëm dhe të lartë, PMF-ja ka detyrimin të mbledhë Grupin Teknik Ndërsektorial⁹ (GTN) (për më shumë informacion mbi detyrat e GTN shikoni shtojcën numër V), ndërsa kur rreziku është i ulët, PMF-ja mbledh GTN-në vetëm nëse e vlerëson të nevojshme.

PMF-ja ose drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki u dërgon anëtarëve të GTN-së formularin e PIM-it, projektin e PIM-it, formularin e vlerësimit dhe analizën e rrezikut, së bashku me kërkesën për mbledhjen e GTN-së.

Në këtë mbledhje anëtarët e GTN -së: finalizojnë vlerësimin e plotë, shqyrtojnë projektin e PIM-it (sipas nenit 54 të ligjit 18/2017, "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", të gjitha ndërhyrjet e parashikuara në PIM jepen falas), japin rekomandime për ndërhyrjet apo shërbimet e nevojshme për rastin, duke caktuar detyrat dhe afatet për secilin anëtar të GTN-së.

PMF-ja referon zyrtarisht rastin të shërbimit të përcaktuar në

9. Grupi teknik, ndërsektorial përbëhet nga: a) Përfaqësues të strukturave të policisë; b) Përfaqësues të strukturave të shërbimeve sociale; c) Përfaqësues të institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar; ç) Përfaqësues të strukturave shëndetësore; d) Përfaqësues të strukturave të drejtësisë; dh) Përfaqësues të organizatave jofitimprurëse; e) Çdo specialist tjetër, që ka njohuri për situatën e fëmijës ose që mund të kontribuojë në marrjen apo zbatimin e masave për mbrojtjen e fëmijës. Pjesëmarrja në GTN e përfaqësuesve të strukturave të sipërpërmendura është e detyrueshme.

PIM dhe u kërkon informacion, sipas afateve të përcaktuara në PIM, për realizimin e ndërhyrjeve, të shërbimeve e detyrave të tjera anëtarëve të GTN-së dhe autoriteteve të tjera, të cilat është referuar rasti.

Gjithashtu PMF rishqyrton PIM (jo më vonë se 6 javë pas hartimit të PIM-it të parë) kjo mund të bëhet më shpesh duke kryer vizita në familje ose, në kuadër të masës së mbrojtjes, pranë institucionit, kujdestarit apo të personi pranë të cilit është vendosur fëmija. Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës merr informacion, në lidhje me fëmijën dhe marrëdhëniet e tij me familjen e origjinës, vëllezërit, motrat, zbatimin detyrat e PIM-it dhe sa rivlerëson rrezikun bën hartimin e PIM-it të rishikuar. PIM-i i rishikuar diskutohet në mbledhjen e radhës së GTN-së, e cila zhvillohet në të njëjtën mënyrë si mbledhja e parë. Plani Individual i Mbrojtjes së Fëmijës, i rishikuar, miratohet brenda 2 ditëve pune nga drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki. PIM-i i rishikuar i dërgohet drejtorit, së bashku me formularin e shqyrtimit të progresit. Drejtuesi i NJMF-së është përgjegjës për **monitorimin** e punës së PMF-së, në lidhje me **zbatimin** e PIM-it, përfshirë PMF-në pranë NJMF-së apo PMF-në pranë njësisë administrative. Drejtuesi i NJMF-së, i mbështetur nga PMF-ja përgjegjëse për ecurinë e PIM-it, realizon vizita monitoruese për të verifikuar situatën e fëmijës dhe të familjes së tij, me qëllim verifikimin e progresit në zbatimin e PIM-it.



Më poshtë do të listojmë disa nga rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve arsimore bazuar në Vendimin nr. 578, datë 3.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”:

1. Punonjësit e institucioneve arsimore, çdo mësues dhe çdo ofrues i shërbimit psiko-social në shkolla, bëjnë identifikimin e fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe referimin në kohë të NJMF-ja, në nivel bashkie apo të PMF-ja, në nivel njësie administrative dhe, në varësi të rrethanave të rastit, pranë organeve të policisë.
2. Drejtuesi i institucionit arsimor cakton personin përgjegjës që do të asistojë punonjësit e institucionit, për raportimin e rasteve të identifikuara dhe koordinimin e veprimeve për mbrojtjen e fëmijëve, në kuadër të menaxhimit të rastit dhe njofton Agjencinë për emrin e personit të caktuar.
3. Personi përfaqësues i institucionit arsimor, i caktuar sipas pikës 2 të këtij neni:
 - a) Është përgjegjës për lehtësimin dhe mbështetjen e zbatimit të PIM-it, i cili parashikon ndjekjen e shkollës nga fëmijët në nevojë për mbrojtje;
 - b) Merr pjesë në takimet e GTN-së dhe mbështet zhvillimin e zbatimit të PIM-it për fëmijën;
 - c) Merr masa që fëmijës në nevojë për mbrojtje t’i sigurohen tekste dhe mjete shkollore falas.







MODULI 2

NDËRHJRJET PËR SJELLJEN POZITIVE (NSP) NË SHKOLLË





NDËRHYRJET PËR SJELLJEN POZITIVE (NSP) NË SHKOLLË

PRITSHMËRITË:

- **Kuptimi i strategjive NSP (Ndërhyrjet për Sjelljet Pozitive) në shkollë**
- **Dallimi i parimeve bazë mbi të cilat funksionon sistemi i NSP-ve në shkollë**
- **Përshkrimi dhe kuptimi i modelit tri nivelesh të ndërhyrjeve për sjelljet pozitive në shkollë**
- **Ballafaqimi i strategjive të ndërhyrjes për sjelljet pozitive në shkollë në raport me qasjet tradicionale disiplinore**

Ndërhyrjet për Sjelljen Pozitive (NSP) është një program/strategji për mësuesit, drejtuesit dhe punonjësit e tjerë arsimor, i cili përdoret për të nxitur sjelljen pozitive në shkollë. Përmes zbatimit të NSP-ve, përmes lëndëve dhe veprimtarive që zhvillohen në shkollë, nxënësit mësojnë rreth sjelljes dhe qëndrimeve pozitive, ashtu siç mësojnë dhe përmbajtjen kurrikulare. Thelbi i programit të NSP-ve është parandalimi dhe jo ndëshkimi. Përvojat në vende që zbatojnë programe të tilla, tregojnë se me anë të NSP -ve është rritur siguria dhe sjelljet pozitive në shkollë.

Përvojat e suksesshme në këtë aspekt, kanë treguar gjithashtu se gjëja më e dobishme që mësuesit duhet të bëjnë për të trajtuar sjelljen problematike, është në radhë të parë ta parandalojnë atë. Programi i Ndërhyrjes për Sjelljet Pozitive (NSP) i ndihmon mësuesit të kuptojnë rëndësinë e menaxhimit të klasës dhe parandalimit të sjelljeve problematike në shkollë si dhe të nxisin maksimalisht suksesin e nxënësve. Strategjitë e NSP -ve janë thelbësore për t'iu mundësuar të gjithë fëmijëve një mjedis sa më të mirë të të nxënit.

Një nga përparësitë më të mëdha të disiplinimit në shkollë është vënia e theksit në sistemet e mbështetjes me bazë të gjerë, që përfshijnë





Parimet bazë të NSP-ve

- Çdo fëmijë mund të mësojë se si duhet të sillet;
- Masat e hershme mund të parandalojnë probleme më të komplikuar të sjelljes;
- Çdo fëmijë është i ndryshëm dhe shkollat duhet të mundësojnë lloje të ndryshme të mbështetjes për sjelljen;
- Mënyra se si shkollat mësojnë sjelljen duhet të bazohet në hulumtime dhe mendimin e ekspertëve;
- Është me rëndësi të ndiqet ecuria e sjelljes së një fëmije;
- Shkollat duhet të mbledhin dhe të përdorin të dhëna për të marrë vendime për problemet me sjelljen.



strategji proaktive për përcaktimin, mësimin dhe mbështetjen e sjelljeve të përshtatshme të nxënësve për të krijuar mjedise miqësore dhe pozitive shkollore. Në vend të përdorimit vetëm të një qasje bazuar në planet individuale të menaxhimit të sjelljes, zbatohet një mbështetje në vazhdimësi e sjelljes pozitive për të gjithë nxënësit, brenda një shkolle, duke përfshirë mjediset brenda dhe jashtë klasës (të tilla si klasat, korridoret, tualetet, mjediset e pushimit, oborri etj).

Ndërhyrjet për Sjelljen Pozitive, NSP është një qasje proaktive për mbështetjen jo vetëm të sjelljes pozitive por edhe të promovimit të kulturës sociale e të nevojshme për të gjithë nxënësit për të siguruar mirëqenien sociale, emocionale dhe akademike të nxënësve. Kujdesi përqendrohet në krijimin dhe mbështetjen e sistemeve parësore (me bazë shkollën), dytësore (me bazë klasën) dhe sistemi i tretë (me bazë individin) që përmirësojnë rezultatet e jetesës (personale, shëndetësore, sociale, familjare, punë, krijimtari) për fëmijët, duke u fokusuar tek sjelljet problematike dhe sjellja e dëshiruar.

NSP-të përbëjnë një sistem parandalimi që funksionon për të gjithë nxënësit

NSP-të përbëjnë një sistem parandalimi që funksionon për të gjithë nxënësit. Ato janë hartuar si një alternativë kundrejt ndërhyrjeve ndëshkimore, të përdorura ndaj nxënësve që paraqesin çrregullime të sjelljes. NSP -të nuk janë një teori e re për sjelljen, por një qasje e një sistemi të bazuar në sjellje, për të nxjerrë në pah aftësinë e shkollës që të mundësojë mjedise të dobishme që favorizojnë mësimdhënien dhe mësimnxënien cilësore. Ndërhyrjet për Sjellje Pozitive ofrojnë një sistem me shumë nivele që funksionon për çdo nxënë.

Duhet mbajtur parasysh se NSP-ja nuk është një trajtim ose terapi. Është një kornizë për t'u ndjekur nga mësuesit, drejtuesit dhe punonjësit e tjerë arsimorë. Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se kur një shkollë përdor NSP-të, ajo e përdor atë për të gjithë nxënësit e saj.

Parimet bazë të NSP-ve

- Çdo fëmijë mund të mësojë se si duhet të sillët;
- Masat e hershme mund të parandalojnë probleme më të komplikuar të sjelljes;
- Çdo fëmijë është i ndryshëm dhe shkollat duhet të mundësojnë lloje të ndryshme të mbështetjes për sjelljen;
- Mënyra se si shkollat mësojnë sjelljen duhet të bazohet në hulumtime dhe mendimin e ekspertëve;
- Është me rëndësi të ndiqet ecuria e sjelljes së një fëmije;
- Shkollat duhet të mbledhin dhe të përdorin të dhëna për të marrë vendime për problemet me sjelljen.

Përse është e rëndësishme të përqendrohemi në mësimin e sjelljeve shoqërore pozitive?

Shpesh lind pyetja, “Përse duhet t’i mësojmë fëmijët të sillen mirë? Ata e dinë se si duhet të sillen. Përse nuk mund të presim që ata të sillen mirë?”. Në të kaluarën, disiplina shkollore është përqendruar kryesisht te kundërpërgjigja ndaj sjelljes së keqe të një nxënësi të caktuar, duke vënë në zbatim strategjitë ndëshkimore, duke përfshirë qortimet, heqjen e privilegjeve, dërgimet në drejtori, pezullimet dhe përjashtimet. Studimet kanë treguar se zbatimi i një mase ndëshkimore nuk është e dobishme, veçanërisht kur përdoret në mënyrë selektive dhe duke mos u ndërthurur me strategji të tjera pozitive.

Prezantimi, modelimi dhe përforcimi i sjelljes shoqërore pozitive është një hap i rëndësishëm në përvojën edukative të një nxënësi. Nxënësve u tregohen pritshmëritë që ka shkolla për sjelljen e tyre dhe nëse ata përgëzohen në momentin që sillen bazuar në rregulla, sjellja e tyre do të forcohet në drejtim pozitiv.

Qëllimi i NSP-ve në shkollë është të krijojnë një klimë në të cilën sjellja e duhur është standardi. Të mësuarit e sjelljes në mënyrë aq të zellshme sa mësojmë për matematikën, leximin apo lëndë të tjera është veprimi bazë i parandalimit, premtimit dhe ndikimit që fshihet pas NSP-ve.




Qasja tri nivelesh e ndërhyrjes për parandalimin e sjelljeve problematike

Sistemi i mbështetjes së sjelljes pozitive është një model i ndërhyrjes me tre nivele që përfshin disa strategji të vlerësuara si Ndërhyrjet për Sjelljet Pozitive - NSP, për parandalimin e sjelljes problematike në shkollë dhe menaxhimin e këtyre sjelljeve kur ato ndodhin. Në thelb, NSP-të janë një sërë strategjish dhe sistemesh për të rritur kapacitetin e shkollave për të reduktuar sjelljet problematike në shkollë dhe për të edukuar të gjithë nxënësit, përfshirë edhe ata me sjellje problematike.

Diagrami i mëposhtëm ilustron qasjen tri nivelesh të ofruar për të gjithë nxënësit në shkollë. Nivelet përfaqësojnë sisteme të mbështetjes, jo kategorizime të fëmijëve.

Programi i ndërhyrjes NSP-ve paraqitet zakonisht në formën e një piramide të tillë:



Duhet kuptuar se nivelet e piramidës pasqyrojnë se sa vëmendje dhe përqendrim pritet që mësuesi t'iu kushtojë këtyre përpjekjeve për parandalimin, të cilat vlerësohen zakonisht me 80% (Niv.1) – 15% (Niv.2) – 5% (Niv.3).

Vini re këto janë përshkrime të situatave të sjelljes, dhe jo etiketime për vetë nxënësit, pasi NSP-të nuk i etiketojnë nxënësit.



Kjo qasje përqëndrohet më tepër te forcimi i sjelljes pozitive të klasës në tërësi, me anë të një sistemi shpërblimesh, që mund të caktohet nga vetë mësuesi dhe të zgjidhet në praninë e klasës. Sipas qasjes me 3 shkallë, kurdoherë që ka probleme me sjelljen, ato duhet të zgjidhen shpejt me anë të ndërhyrjeve të grupeve të vogla, duke përfshirë vetëm nxënësit në fjalë, ndërsa pjesa tjetër e klasës vazhdon me forcimin e sjelljes pozitive. Rezistenca ose probleme të ndërlikuara të sjelljes zgjidhen me anë të ndërhyrjeve intensive dhe individuale, me mbështetjen e drejtuesve dhe administratës së shkollës. Duhet përmendur gjithashtu se mësuesit ose psikologu i shkollës ka detyrë ligjore të raportojë rastet e fëmijës në nevojë për mbrojtje të NJMF dhe nëse është e nevojshme pas analizës së rrezikut aktorët e shkollës duhet të jenë pjesë e tryezave të GTN për menaxhimin e rastit (për më shumë detaje mund t'i referoheni modulit 1).

Niveli	Përshkrimi i 3 niveleve të parandalimit / ndërhyrjes
<p>I.</p> <p>Niveli 1 i parandalimit 80%</p> <p>(I përgjithshëm)</p>	<p>Parandalimi i zhvillimit të rasteve të reja të sjelljeve problematike, duke mundësuar një mjedis të nxëni të një cilësie të lartë, për të gjithë nxënësit dhe stafin në të gjitha mjediset (pra në mbarë shkollën, brenda dhe jashtë klasës), nëpërmjet vendosjes së disa pritshmërive të përbashkëta (p.sh. I sigurt; I respektueshëm; I përgjegjshëm). Të gjithë nxënësit në klasë bien dakord me këto pritshmëri, të cilat ndahen me prindërit nëpërmjet takimeve me ta, në mënyrë që të mund të përforcohen dhe në shtëpi.</p>
<p>II.</p> <p>Niveli 2 i parandalimit 15%</p> <p>(I synuar)</p>	<p>Pakësimi i rasteve ekzistuese të sjelljeve problematike, që nuk reagojnë ndaj praktikave të ndërhyrjes parësore, duke ofruar reagime në grupe të vogla më të përqendruara, intensive, dhe të shpeshta, në situata ku ka probleme me sjelljen ose që ka gjasa të ndodhin. Këto ndërhyrje të synuara bëhen në përgjithësi me personin në fjalë apo me një grup të vogël nxënësish, të cilët shfaqin sjellje të padëshiruar. Pjesa tjetër e klasës nuk përfshihet dhe vazhdon të mbajë qëndrim pozitiv.</p>
<p>III.</p> <p>Niveli 3 i parandalimit 5%</p> <p>(Intensiv)</p>	<p>Ulja e intensitetit dhe/ose ndërlikimeve të rasteve ekzistuese të sjelljeve problematike, që janë rezistente dhe/ose nuk kanë gjasa të zgjidhen nga përpjekjet e bëra me parandalimin parësor dhe dytësor. Në këtë nivel reagohet me përgjigje individuale ndaj situatave ku ka një problem me sjelljen ose ku ka gjasa të ndodhë. Shpesh këto ndërhyrje individuale realizohen jashtë klasës, me ndihmën e drejtuesve dhe administratës së shkollës.</p>



Në vijim, përshkruhen praktikat/ndërhyrjet që zhvillon shkolla për secilin nga nivelet:

I. Niveli 1 - Të gjithë nxënësit, i gjithë stafi, të gjitha mjediset

- Ekip koordinues me pjesëmarrjen aktive të drejtuesve të shkollës.
- Vendosja e pritshmërive/synimeve dhe sjelljeve pozitive në nivel shkolle.
- Vendosja e pritshmërive dhe rutinave në nivel klase, të cilat janë në përmbushje të pritshmërive/synimeve në nivel shkolle.
- Rutina efektive për zhvillimin e takimeve të ekipit koordinues të shkollës.
- Procedura për monitorimin e vazhdueshëm bazuar në të dhëna dhe vlerësimin e tyre.
- Procedura për trajnimin dhe mbështetjen e stafit të shkollës.
- Procedura për inkurajimin e partneritetit shkollë-familje.

II. Niveli 2 – Grupe të vogla nxënësish

- Ekip ndërhyrës.
- Proces formal për identifikimin e nxënësve që kanë nevojë për më shumë mbështetje se Niveli 1.
- Ekspertizë për sjelljet.
- Saktësi në mbledhjen e të dhënave lidhur me korrektësinë e zbatimit dhe monitorimin e progresit.
- Akses në trajnime dhe mbështetje teknike mbi ato të nivelit 1.
- Rritje e mundësive për përforsim pozitiv.

III. Niveli 3 – Nxënës të veçantë

- Të gjitha ndërhyrjet e Nivelit 1 dhe 2.
- Ekip multidisiplinar bazuar në nevojat individuale të nxënësve.
- Ekspertizë për mbështetjen e sjelljes.
- Plane për mbledhjen e të dhënave formale në lidhje me zbatimin korrekt të planifikimeve të ndërhyrjeve për sjelljet e veçanta (shpesh këta janë fëmijë në nevojë për mbrojtje ndaj dhe mësuesit ose psikologu i shkollës duhet t'i raportojë rastet tek NJMF dhe nëse është e nevojshme të marrë pjesë tek takimet e GTN për menaxhimin e rasteve dhe të mbështesë fëmijën bazuar në PIM).



- Vlerësim i vazhduar përfshirë vlerësimin e sjelljes funksionale.
- Plane të individualizuara të mbështetjes që përfshijnë strategjitë për:
 - a) parandalimin;
 - b) mësimdhënien;
 - c) përforcimin pozitiv;
 - d) reduktimin e kontrolluar të shpërblimeve për problemet e sjelljes, dhe
 - e) sigurinë.
- Mbështetje dhe plan mbështetje i fokusuar te individi, me përfshirjen aktive të familjes dhe komunitetit.
- Mbledhje formale dhe përdorim i të dhënave në lidhje me impaktin që kanë planet e mbështetjes në rezultatet e nxënësve.

Si Funksionojnë NSP-të?

Në një shkollë ku përdoren qasje tradicionale disiplinore, mësuesit përpiqen të korrigjojnë sjelljen nëpërmjet ndëshkimit. Më poshtë gjendet një shembull tipik:

Një nxënëse e ulur në fund të klasës hedh një topt h letre. Mësuesi reagon duke e qortuar ashpër nxënësen ose e dërgon në zyrën e drejtorit. Pasi nxënësj merr ndëshkimin, kthehet në klasë dhe pritët që ajo të sillët mirë. Rregullat janë të njëjta për të gjithë nxënësit. Ndëshkimi është i njëjtë për secilin fëmijë që thyen rregullat. Nëse sjellja përkeqësohet, masa ndëshkimore rëndohet.

Nga ana tjetër, një shkollë që përdor NSP-të, përqendrohet në parandalimin e problemit. Që në fillim, nxënësit mësojnë se cila konsiderohet sjellje e përshtatshme, ashtu siç mësojnë matematikën ose shkencën. Nxënësit mësojnë për aftësitë shoqërore, duke përfshirë mënyrën se si të sillen në mjedise të ndryshme, si p.sh në klasë, në oborr apo me miqtë e tyre. Ata mund të mësojnë nëpërmjet lojërave apo me anë të mësimëve konkrete. Stafi i shkollës duhet të lavdërojë vazhdimisht fëmijët për sjellje të mirë.



Me anë të NSP-ve, mësuesit mundohen të identifikojnë probleme të vogla me sjelljen, dhe i parandalojnë ato që të mos kthehen në probleme më të mëdha. Përpara se të hidhet topthi prej letre, mësuesi mund ta dallojë se cili nxënës po kërkon vëmendje. Mësuesi mund ta trajtojë këtë nevojë në mënyrë pozitive, përpara se nxënësi të kërkojë të tërheqë vëmendjen duke gjuajtur me topthi prej letre.

Nëse nxënësi reagon ashpër, shkolla krijon një strategji për të parandaluar atë lloj sjelljeje që të mos ndodhë përsëri. Kjo strategji mund të përfshijë elementë të tillë, si: pak kohë pushim për t'u qetësuar, ose një bashkëmoshatar që e mban atë nën mbikëqyrje. Shkolla mund të mundësojë edhe trajnime për prindërit.

Institucioni arsimor ndjek ecurinë e nxënësit në menaxhimin e problemeve të sjelljes dhe mund të ndryshojë strategji nëse diçka nuk po ecën siç duhet. NSP -të kanë në qendër të tyre disiplinimin dhe jo ndëshkimin.





MODULI 3

**ZBATIMI I NSP-ve NË
SHKOLLË**





ZBATIMI I NSP-ve NË SHKOLLË

PRITSHMËRITË:

- Identifikimi i tipareve të një shkolle ku zbatohen efektivisht NSP-të
- Dallimi i hapave dhe proceseve të zbatimit të NSP-ve në shkollë, për secilin nivel të ndërhyrjes
- Identifikimi dhe kuptimi i alternativave për zgjidhjen e problemeve të sjelljes në shkollë
- Vlerësimi i rolit të ekipit të shkollës për të koordinuar procesin e ndërhyrjeve për sjelljet pozitive
- Kuptimi i rëndësisë së hartimit të planit të veprimit për shkollë.

Shkollat dhe institucionet arsimore vendore duhet të veprojnë në mënyrë të tillë që çdo nxënës të përfitojë maksimalisht, në mënyrë efektive dhe të përshtatshme. Shkollat në të cilat zbatohen NSP-të janë institucione të cilat duhet të sigurojnë që sjelljet dhe praktikat sociale të fokusohen drejt një qëllimi të përbashkët dhe të përmbushin pritshmëri të përbashkëta. Shkolla të tilla kanë vizion të përbashkët, gjuhë të përbashkët, zhvillojnë përvoja të përbashkëta dhe drejtim cilësor. Skema e mëposhtme përshkruan tiparet e një shkolle ku zbatohen NSP-të:



- Shkollat të cilat punojnë për NSP-të kanë të përcaktuar qartë një mision/qëllim që përkrahen nga pjesa më e madhe e anëtarëve të shkollës, i cili reflekton shkëmbimin e përvojave dhe shërben si bazë për vendimmarrjen dhe planifikimin e veprimtarive.
- Në këto shkolla komunikohet me gjuhë të përbashkët e cila përfshin terminologji, fraza dhe koncepte që përshkruajnë vizionin e shkollës, veprimet dhe procedurat, në mënyrë që komunikimet të jenë të kuptueshme, informuese, efektive dhe të rëndësishme për anëtarët e shkollës.
- Këto shkolla zhvillojnë përvoja të përbashkëta të cilat përfshijnë një tërësi veprimesh, rutinash, proceduarsh që praktikohen nga të gjithë anëtarët e stafit të shkollës, që përfshijnë sistemin e të dhënave, që shërbejnë për të vlerësuar cilësinë e zbatimit dhe lidhjen e veprimtarive me rezultatet.

Karakteristikat dhe parimet e zbatimit të NSP-ve në shkollë

Zbatimi i NSP-ve në shkollë ndjek parimet e mëposhtme:

- Të gjithë anëtarët e shkollës në të gjitha mjediset (në mënyrë të veçantë në klasë) duhet të sigurojnë një bazë efektive dhe të nevojshme të mbështetjes së sjelljeve

pozitive dhe mjedisit social (Niveli 1) që vendos në fokus organizimin e mjediseve të të nxënit dhe marrëdhëniet miqësore.

- Zbatim i NSP-ve në të gjithë shkollën. Nxitja e një kulture sociale miqësore dhe pozitive në shkollë kërkon që të gjithë nxënësit dhe stafi i shkollës të marrin pjesë në procesin e zbatimit. Si një qasje e të gjithë shkollës, korniza e NSP-ve zbatohet nga dhe me individët brenda klasës dhe ndërmjet mjediseve të tjera (p.sh., korridor, palestër, oborr i shkollës etj).
- Më së pari investim në parandalim. Të gjithë anëtarët e një mjedisi të nxëni (shkolle, klase) duhet të sigurojnë një bazë efektive të mbështetjes akademike, mjedisit social dhe mbështetjes së sjelljes që vendos në fokus organizimin e mjediseve cilësore të të nxënit dhe mësimdhënies:
 - ✎ Mësimdhënie të drejtpërdrejtë për aftësitë sociale.
 - ✎ Monitorim i vazhdueshëm i progresit.
 - ✎ Mundësi të shumëfishta për të aplikuar aftësitë sociale.
 - ✎ Inkurajim i veçantë dhe vlerësim i përdorimit të aftësive sociale.
 - ✎ Rindërtim i marrëdhënieve kur ndodh një sjellje e gabuar.
- Sigurim i një mbështetje të vazhdueshme e cila adreson nevojat e të gjithë nxënësve. Mbështetja e vazhdueshme e sjelljes karakterizohet nga një sërë praktikash të bazuara në të dhëna (p.sh., ndërhyrje dhe strategji që adresojnë



një sërë sjelljesh problematike, bazuar në intensitetin dhe shkallën e sjelljes problematike). Një mbështetje e vazhdueshme e sjelljes nuk dallohet (karakterizohet) nga vendosja e nxënësve në nivele, por mbi të gjitha nga praktika të mësimdhënies bazuar në kompetenca.

- Përzgjedhje dhe përdorim i ndërhyrjeve bazuar në të dhëna. Pasi një problem ose nevojë është përcaktuar si e rëndësishme, duhet të përzgjidhen ndërhyrje që adresojnë problemin në kontekstin/situatën e treguar. Në masën më të madhe të mundshme, të dhënat duhet të mbështeten nga gjykime formale dhe të kontrolluara që dokumentojnë ndryshimin në rezultatet e të nxënësve.
- Fuqizim i kapaciteteve me mbështetje dhe asistencë teknike. Në procesin e zbatimit të NSP-ve shkollat duhet të sigurojnë ekspertizën e nevojshme për identifikimin dhe trajtimin e sjelljeve problematike.
- Dokumentim me korrektësi i praktikës së zbatimit. Në mënyrë që nxënësit të përfitojnë sa më shumë, duhet të ndërtohen struktura dhe sisteme mbështetje që sigurojnë zbatimin e praktikave bazuar në të dhëna me shkallë të lartë korrektësie; të kryhen vlerësime të vazhdueshme të një zbatimi korrekt dhe monitorim i reagimit të nxënësve ndaj ndërhyrjeve të kërkuara.

- Mbledhje e të dhënave. Gjashtë pyetjet e mëposhtme ndihmojnë në këtë drejtim:
 - a) Cila çështje/problem/nejvojë duhet adresuar? Kur? Ku? Si?
 - b) Cila praktikë ose ndërhyrje e adreson nevojën/problemimin?
 - c) Sa të përgatitur janë personat që do të ndërhyjnë?
 - d) Me sa korrektësi është zbatuar praktika/ndërhyrja?
 - e) Si i përgjigjen nxënësit ndërhyrjes?
 - f) Çfarë ndërhyrjesh duhen bërë për përmirësimin e zbatimit?
- Përshtatje me kulturën e shkollës. Mbështetjet dhe ndërhyrjet që i përshtaten nevojave dhe preferencave të nxënësve, familjeve dhe komunitetit të shkollës janë më efektive se ato që zbatohen në një format të përgjithshëm.



Hapat dhe proceset e zbatimit të NSP-ve në shkollë

Strategjitë më efektive për parandalimin e sjelljes problematike në shkollë përfshijnë:

- ✎ Pritshmëri të qarta dhe pozitive të sjelljes
- ✎ Pritshmëri për mësimdhënien dhe të nxënit
- ✎ Staf i trajnuar në aftësitë e mbikëqyrjes
- ✎ Hartimi i planeve të sjelljes të lidhura me pritshmëritë e shkollës

Këto strategji bazohen në të kuptuarin që promovimi i sjelljeve pozitive është më efektiv për disiplinimin sesa beteja kundër sjelljeve negative kur ato ndodhin. Strategjitë e NSP-ve krijojnë një klimë pozitive të shkollës duke siguruar një bazë për ndërveprime pozitive të nxënësve me të rriturit dhe duke ndryshuar stilet e menaxhimit të sjelljeve nga reaguese (reaktive) në proaktive.

Në vijim përshkruhen hapat dhe proceset e zbatimit të NSP-ve në shkollë, për secilin nivel:

NIVELI 1 – i ndërhyrjes për sjelljet pozitive

Hapi 1: Bëhet hulumtimi dhe mblidhet informacioni

Përmes përdorimit të një instrumenti monitorimi për NSP-të ose duke bërë një vlerësim të nevojave për menaxhimin e sjelljes në shkollë (Shih shtojcën), hulumtoni dhe mblidhni informacion në lidhje me:

- ♪ Çfarë do të vlerësonin mësuesit, nxënësit dhe prindërit si sjelljet më problematike të nxënësve?
- ♪ Në cilat mjedise në shkollë ndodhin sjelljet më problematike?
- ♪ Në cilën kohë të ditës mësimore ndodhin shkeljet apo sjelljet problematike?
- ♪ Cilët nxënës kanë më shumë sjellje problematike?
- ♪ Cilët anëtarë të stafit janë përgjegjës për tu marrë me nxënësit problematikë?
- ♪ Çfarë sjelljesh pozitive do të donit të demonstronin nxënësit dhe stafi në shkollë?
- ♪ Politikatat në lidhje me sjelljen që tashmë keni vendosur. Si mund të përmirësohen ato?



Hapi 2: Rishikohen rregullat në shkollë, përcaktohen pritshmëritë/synimet e sjelljes

1. Shqyrtoni rregullat që keni të vendosura në shkollën tuaj. A fillojnë ata me “jo”, “nuk lejohet” ose “mos”? A janë ato të thjeshta për t’u mbajtur mend? Nëse po, i riformuloni ato si pohime pozitive për të treguar sjelljen që dëshironi të shihni.

2. Merrni informacion nga stafi dhe nxënësit për të përfunduar me përzgjedhjen e 3 – 5 pritshmërive bazuar në sjelljet që dëshironi të shihni në shkollë.

Pritshmëritë/synimet duhet të jenë:

1. Të shprehura pozitivisht (3 I-të: I sigurtë, I respektueshëm, I përgjegjshëm)
2. Të shkurtra dhe tërheqëse
3. Të lidhura me nevojat e shkollës
4. Të orientuara drejt veprimeve
5. Të lidhura me vizionin dhe misionin e shkollës

3. Me pjesëmarrjen e nxënësve, zhvilloni një logo apo akronim që reflekton pritshmëritë dhe kulturën, vizionin dhe misionin e shkollës. Pastaj zhvilloni një frazë ose mesazh tërheqës, që të mbetet në mendje, që përcjell kuptimin e pritshmërive. Idetë mund të merren përmes kutive të sugjerimeve, logo të projektuara si shembuj, zhvillohen gjithashtu nominime dhe votime mbi opsionet për logon dhe mesazhin.

SHKOLLAT QË ZBATOJNË NSP-të

- ♪ “Krijojnë mjedise të rregullta, të parashikueshme dhe pozitive të mësimdhënies dhe të nxënësve pozitiv.
- ♪ Trajtojnë të rriturit dhe kolegët për të shërbyer si modele pozitive.
- ♪ Krijojnë sisteme për të grumbulluar të dhëna në mënyrë të rregullt.
- ♪ Përgëzojnë nxënësit kur janë “duke bërë gjënë e duhur” .
- ♪ Përmirësojnë kompetencën qytetare.
- ♪ Zhvillojnë mjedise që mbështesin suksesin akademik.

NSP NUK ËSHTË NJË PROGRAM I PAKETUAR ...

Përkundrazi, është një mënyrë për të krijuar një mjedis pozitiv të favorshëm për të nxënësit bazuar në një kulturë shoqërore pozitive për çdo shkollë.



Hapi 3: Nxënësit mësojnë për sjelljet e pritshme sikurse janë përcaktuar në matricën e pritshmërive/synimeve

- Pritshmëritë për mjediset rreth shkollës operacionalizohen. Shkolla mund të ndërtojë një matricë mësimore e cila përdoret për të treguar se çfarë sjelljesh priten në çdo mjedis të shkollës.
- Sjelljet e duhura mësohen në mënyrë aktive përmes modelimit dhe udhëzimit të drejtpërdrejtë në çdo mjedis të shkollës ku pritet të ndodhin sjelljet. Jepen arsyttime pse secila sjellje është e rëndësishme.
- Për mësimin e sjelljeve të pritshme hartohen plane mësimore ditore.
- Bëhet një plan për kur, kush dhe si do të mësohen mësimet.
- Kur mësohen pritshmëritë përcaktohen vlerat abstrakte si respekti dhe përgjegjësia, duke përdorur shembuj dhe jo shembuj të asaj se si ato shprehen dhe tingëllojnë në mjedis të ndryshme të shkollës.
- Përfshini nxënësit në mësimin e pritshmërive (dramë, muzikë, lojë rolesh).
- Përdorni teknologjinë (p.sh. videot YouTube mbi sjelljet e pritshme të filmuara nga nxënësit)
- Integrimi i mësimin të pritshmërive në kurrikul (p.sh. Për një shkollë me pritshmëri mbi sigurinë, respektin dhe përgjegjësinë nxënësit mund të shkruajnë histori rreth një karakteri i cili mëson se si të jetë përgjegjës ose nxënësit mund të krijojnë postera duke treguar se çfarë do të thotë të jesh i sigurtë në shkollë).
- Përdorimi i posterave ose mediave të tjera për të përforcuar pritshmëritë.
- Organizoni takime me prindërit dhe nxënësit për pritshmëritë dhe për të diskutuar atë që ato nënkuptojnë për jetën në shkollë dhe në komunitet.
- Pritshmëritë, logot dhe fraza e gjetur përfshihen në korrespondencën me prindërit për të ndihmuar përforcimin në shtëpi.



Hapi 4: Monitorimi i sjelljes së nxënësit

Mbikëqyrja aktive

Meqenëse NSP-të varen nga qëndrueshmëria dhe përforcimi, është e rëndësishme që të gjithë të rriturit në shkollë të marrin pjesë në mënyrë aktive në monitorimin e sjelljes së nxënësve në klasa dhe jashtë tyre.

Stafi i shkollës duhet të trajnohet mbi aftësitë mbikëqyrëse për të mbështetur përdorimin e tyre. Këto aftësi përfshijnë:

1. **Lëvizjen** - Gjatë mbikëqyrjes lëvizet rreth mjediseve të shkollës rregullisht dhe në mënyrë të paparashikuar.
2. **Ndërveprimin** - Gjatë mbikëqyrjes ndërveprohet shpesh dhe pozitivisht me nxënësit.
3. **Skanimin** - Gjatë mbikëqyrjes skanohet zona e caktuar për mbikëqyrje vazhdimisht dhe haptazi.

Monitorimi i nxënësve përmes mbledhjes së të dhënave

Një mënyrë tjetër për të siguruar që nxënësit monitorohen në mënyrë të vazhdueshme është ndjekja e sjelljes së nxënësit nëpërmjet përdorimit të formularëve të referimit, formave të raportimit të incidenteve të vogla dhe ditareve të sjelljes. Për të ndihmuar prindërit të monitorojnë sjelljen e fëmijës së tyre në shkollë mund të përdoren formatet e njoftimit të prindërve.

Këto formate sigurojnë të dhëna të cilat mund të përmbledhen dhe analizohen për vendimmarrje të mëtejshme. Të dhënat gjithashtu u mundësojnë shkollave të identifikojnë dhe ndërhyjnë në mënyrë të përshtatshme me ata nxënës që kanë nevojë për mbështetje më të madhe.

SA AKTIVE ËSHTË MBIKËQYRJA NË SHKOLLËN TUAJ?

Gjatë mbikëqyrjes së stafit në shkollë duhet t'i përgjigjeni pyetjeve:

1. A bashkëpunohet pozitivisht me shumicën e nxënësve?
2. A zhvendoset stafi vazhdimisht në të gjitha mjediset?
3. A skanohet rregullisht?
4. A ka të paktën katër ndërveprime pozitive për çdo sjellje të papërshtatme të nxënësit?
5. A trajtohen në mënyrë efikase shkeljet e rregullave të vogla?
6. A ndiqen në mbarë shkollën procedurat për trajtimin e shkeljeve kryesore të rregullave?
7. A njihen pritshmëritë/synimet e shkollave?
8. A përgëzohen pozitivisht nxënës të ndryshëm për shfaqjen e sjelljeve të pritshme?



Hapi 5: Falenderimi i nxënësve


Shkollat që ndërtojnë një kulturë të mirënjohjes/falenderimit përmirësojnë frekuencën dhe cilësinë e ndërveprimeve midis nxënësve dhe të rriturve në shkollë. Kjo nga ana tjetër:

- krijon një klimë miqësore në shkollë
- nxit marrëdhënie më të mira nxënës – mësues
- kontribuon në një ndjenjë të bashkësisë
- përforcon sjelljet pozitive të studentëve
- kryeson ndryshimet pozitive në sjellje

Për më tepër, nxënësit shfaqin arritje më të larta të rezultateve akademike dhe të sjelljes kur të rriturit janë mbështetës në ndërveprimet e tyre me nxënësit. Këtu janë disa këshilla që duhet të merren parasysh gjatë zbatimit të një sistemi të falenderimit në arsimin bazë.

Stimujt duhet të jenë:

- të thjeshtë dhe të lehtë për t'u zbatuar;
- të arsyeshëm (koha, shpenzimet);
- të bazuar në interesat dhe kontributin e nxënësve;
- të përshtatshëm për moshën (p.sh. disa adoleshentë ndjehen të zënë ngushtë nëse veçohen);
- të ofruar si një grup mundësish që përfshin kombinime;
- të ndryshojnë çdo dy javë për të mbajtur interesin.



Në vijim prezantohen shembuj të ndryshëm të një sistemi falenderimi:

Kujdesi nga të rriturit

Vëmendja pozitive nga të rriturit është një nga përforcuesit më të fuqishëm të sjelljes së duhur të nxënësve. Duke rënë dakord si staf për të synuar dhënien e vëmendjes pozitive ndaj nxënësve, të paktën 4 herë për çdo ndërveprim korrekt, të rriturit mund të vendosin një shpërblim në klasat e tyre. Hulumtimet tregojnë që shpërblimet që u jepen fëmijëve nga të rriturit janë një mënyrë efektive për të bërë të mundur ndryshimin e sjelljes së nxënësve.

Aktivitete Pozitive të Mirënjohjes

Nxënësit që kanë përmbushur kriteret e sjelljes për periudhën e specifikuar kohore (muaji / periudha / viti shkollor) mund të ftohen në një ngjarje të veçantë festive, si piknik, shfaqje apo ekskursion). Kjo duhet bërë në nivel klase dhe shkolle. Është e rëndësishme që nxënësit që përjetojnë sfida akademike, të falënderohen/shpërblehen që të japin më të mirën në drejtim të sjelljes.

Hapi 6: Zhvillimi i një sistemi strikt por të drejtë pasojash

Zbatimi i një sistemi të përshkallëzuar pasojash

Konsistenca është thelbësore për menaxhimin e sjelljes në mënyrë efektive. Është e rëndësishme që nxënësit të presin dhe të marrin përgjigje të parashikueshme nga i gjithë stafi për shkeljet e sjelljes. Përcaktimi se kush quhen shkelje të vogla dhe të mëdha u mundëson mësuesve të "qëndrojnë në të njëjtën linjë". Ata duhet të përcaktojnë se cila është sjellja e papranueshme dhe se si duhet të trajtohet ajo.

Kur zbatohet një sistem i përshkallëzuar pasojash, do të ishte e dobishme të implementohet një tërësi masash që përdoret me disa ndryshime nga cikli fillor në ciklin e lartë të arsimit bazë. Një tërësi bazë masash mund të përfshijë:

- Një paralajmërim
- Konsultimi dhe këshillimi mësues - nxënës
- Kontakti me prindin
- Referimi në Komisionin e etikës dhe sjelljes

Zgjidhja në klasë përkundrejt menaxhimit nga Komisioni i shkollës

Duhet të ketë qëndrueshmëri në atë se cila sjellje dërgohet në drejtorinë e shkollës. Për të arritur këtë, stafi duhet të identifikojë shkeljet e sjelljes të cilat janë të zakonshme në shkollën e tyre dhe të përcaktojnë se cilat shkelje do të trajtohen në nivelin e klasës dhe cilat do të trajtohen nga zëvendës drejtori ose drejtori. Përveç kësaj, strategjitë për të menaxhuar në mënyrë të përshkallëzuar shkeljet duhet të përshkruhen qartë, për t'i fuqizuar mësuesit për të menaxhuar në mënyrë efektive klasat e tyre. Duhet të zhvillohet trajnimi i stafit për menaxhimin e klasës.



THELBI I SISTEMEVE EFEKTIVE TË MIRËNJOHJES

Për të krijuar një sistem efektiv dhe të qëndrueshëm mirënjohje:

1. Bëjeni të thjeshtë
2. Ndryshoni veprimtaritë
3. Mundësoni që stafi dhe nxënësit të dinë se kur dhe çfarë do të ndodhë

Mësuesit efektivë dhe mbështetja akademike

Disa sfida të sjelljes vijnë si rezultat i sfidave akademike. Përveç mbështetjes së sjelljes përmes njohjes dhe përgjigjeve korrigjuese ndaj shkeljeve, është e rëndësishme të krijohen përkrahje akademike për nxënësit dhe të zhvillohen veprimtari praktike efektive mësimore. Mësuesit mund të maksimizojnë të nxënit dhe të minimizojnë shkeljet duke ndjekur gjashtë hapat e mëposhtëm të mësimdhënies. Gjatë orës mësimore mësuesit:

1. Përhëndesin nxënësit kur hyn në klasë
2. Lidhin mësimin me mësimet e mësuara më parë
3. Tregojnë entuziazëm për përmbajtjen e veprimtarive mësimore
4. Paraqesin qartë rezultatet e të nxënit dhe direktivat
5. I përgjigjen pozitivisht dhe përgëzojnë nxënësit që ndjekin udhëzimet
6. I sigurojnë mundësi të gjithë nxënësve të përgjigjen dhe të marrin pjesë



ALTERNATIVA PËR ZGJIDHJEN E PROBLEMEVE TË SJELLJES	PËRSHKRIMI
Masa ndëshkuese në shkollë	Kjo duhet të jetë e strukturuar mirë dhe të përfshijë mësimin e aftësive sociale që lidhen me sjelljen problematike të demonstruar nga nxënësi. Për shembull, një nxënës, sjellja problematike e të cilit janë zënkat e luftimet, duhet të mësojë përmirësimin e aftësive emocionale. Duhet të ketë një procedurë të përcaktuar qartë për klasat e zakonshme. Duhet të tregohet kujdes për të siguruar që masa ndëshkuese në shkollë nuk përdoret si një mënyrë për të shmangur ndjekjen e mësimit.
Zgjidhja e problemeve	Qasjet për zgjidhjen e problemit mund të ndihmojnë nxënësit të mësojnë për të marrë vendime të shëndetshme. Marrëveshjet me nxënësit mund të aplikohen për të mbajtur nxënësit në rrugën e duhur. Pranimi dhe mbështetja duhet të përfshihen për të përforcuar sjelljen e duhur dhe për të dekurajuar sjelljen e papërshtatshme.
Praktikat e restaurimit	Kjo i lejon nxënësit të paraqesë justifikime për veprimet e tij. Kjo bëhet duke adresuar drejtpërsëdrejti problemet e shkaktuara nga sjellja e tij. Për shembull, një nxënës që ka dëmtuar muret, pritet të pastrojë ose të punojë për të përmirësuar mjedisin fizik të shkollës.
Këshillimi	Mbështetja nga një profesionist i trajnuar mund të jetë e nevojshme për të ndihmuar nxënësit të punojnë me çështjet personale ose aftësitë e munguara që mund të ndikojnë në sjellje dhe të nxënës.
Planet individuale të sjelljes	Një plan i strukturuar i sjelljes, specifik për nxënësin dhe sjelljen e tij problematike, mund të ndihmojë atë të përqendrohet në përmirësimin e sjelljes së duhur.
Shërbimi komunitar	Për nxënësin mund të bëhen rregullime që të kryejë një sasi të kërkuar orësh në shërbim komunitetit jashtë orarit të shkollës
Monitorimi i Sjelljes	Çiftimi i nxënësit me një të rritur mentor që punon me nxënësin ndihmon për të monitoruar përparimin e sjelljes.
Përfshirja e prindërve	Kontakti mes prindërve dhe shkollës duhet të rritet me qëllim shtimin e mbikëqyrjes prindërore dhe përfshirjen e prindërve në strategjitë mbështetëse të sjelljes që zbatohen me fëmijën tyre.



Hapi 7: Kuptimi dhe përdorimi i të dhënave mbi përdorimin e vendimit

Efektiviteti i strategjive të NSP-ve në shkollë mund të vlerësohet përmes mbledhjes së të dhënave për rastet e mëposhtme për një periudhë të caktuar kohore:

- Llojet e sjelljeve problematike që përsëriten;
- Numri i sjelljeve problematike të trajtuara nga mësuesit;
- Numri i referimeve në Komisionin e etikës dhe sjelljes në shkollë;
- Numri i sjelljeve problematike të trajtuara nga zyra e drejtuesve të shkollës;
- Përgjashtimet.

Formulari i referimit të sjelljeve në zyrën e drejtuesve të shkollës mund të shërbejë si burim primar i të dhënave. Për të siguruar që sistemi i mbledhjes së të dhënave funksionon në mënyrë efektive:

1. Formulari duhet të mbledhë të dhëna për:
 - a) Kush e ka bërë referimin;
 - b) Llojin e sjelljes problematike;
 - c) Vendndodhja e incidentit;
 - d) Koha e incidentit;
 - e) Kush është përfshirë;
 - f) Veprimet e mësuesit;
 - g) Veprimet administrative.
2. I gjithë stafi duhet të trajnohet në mënyrë korrekte për të plotësuar formularin e referimit dhe procedurën për paraqitjen e formularit.
3. Duhet të ketë një proces të qartë për hedhjen e informacionit nga formatet e referimit në një bazë të dhënash, duke përmbledhur informacionin dhe duke ndarë të dhënat me stafin, nxënësit dhe prindërit.



PYETËSOR

Si mund të kuptohet nëse keni ndërtuar një kulturë pozitive bazuar në implementimin e NSP-ve në shkollën tuaj?

A mundet një vizitor të identifikojë pritshmëritë e sjelljes brenda 5 minutash nga hyrja në shkollën tuaj?

A arrijnë nxënësit të përmendin pritshmëritë e përcaktuara të sjelljes? - Pyet 10 nxënës të përzgjedhur rastësisht.

A dallohen nxënësit për sjellje të përshtatshme? - Pyesni 10 nxënës të përzgjedhur rastësisht nëse janë përgëzuar për sjellje të përshtatshme në javën e kaluar.

A i njeh stafi dhe familjarët pritshmëritë e sjelljes?

A reflektojnë ndërveprimet mes moshatarëve pritshmëritë e caktuara?

A nxisin nxënësit njëri tjetrin që të ndjekin pritshmëritë e sjelljes?

A është kujdesur për mjedisin fizik? Dritaret e thyera dhe mbishkrimet mund të kontribuojnë në nxitjen e sjelljeve antisociale.

A i qasen nxënësit të rriturve me shqetësimet dhe idetë e tyre?

NIVELI 2 – i ndërhyrjes për sjelljet pozitive

Një nga përfitimet e implementimit të mbështetjes dhe ndërhyrjeve për sjelljet pozitive është ofrimi i strukturave mbështetëse për të gjithë nxënësit. Njihet fakti se disa nxënës do të kenë vështirësi t'i përgjigjen në vazhdimësi ndërhyrjeve në nivel shkollë të ofruara në nivelin e parë. Këta nxënës janë në rrezikun e zhvillimit të problemeve kronike të sjelljes. Për këtë arsye, ndërhyrjet në nivelin 2 të NSP-ve ofrojnë mbështetje për këtë përqindje të vogël nxënësish.

Hapi 1: Mbështetjet e përcaktuara në nivel shkollë funksionojnë si duhet për të gjithë nxënësit

Përpara zbatimit të ndërhyrjeve të nivelit të dytë, është thelbësore që shkollat të sigurojnë se po e zbatojnë nivelin e parë në mënyrë të vazhdueshme dhe efektive. Duhet mbajtur parasysh ndërhyrjet e nivelit të parë:

- ♪ A janë identifikuar, mësuar dhe përsëritur pritshmëritë e shkollës dhe klasës?
- ♪ A ka një plan për nxitjen e sjelljes së duhur nëpërmjet vlerësimeve dhe falenderimeve?
- ♪ A ka një sistem për adresimin e sjelljeve të papërshtatshme kur ato ndodhin?
- ♪ A u mësohen nxënësve aftësi sociale dhe emocionale?

Efektiviteti i ndërhyrjeve të nivelit të parë mund të vlerësohet gjithashtu duke shqyrtuar të dhënat nga burime të tilla si numri i referimeve në shkollë, vendndodhjet e problemeve, intervalet kohore problematike të ditës në shkollë dhe pezullimet.

Hapi 2: Krijohet një ekip për mbështetjen e nxënësve

Ky ekip mund të përbëhet nga mësues, mësues ndihmës, psikologu, punonjësi social dhe drejtues të shkollës. Mund të përfshihen edhe persona burimorë nga komuniteti (p.sh. mësues në pension, oficerë të sigurisë etj.). Në realitetin e sistemit tonë arsimor ky ekip përbën "Komisionin e Etikës dhe Sjelljes" në shkollë. Ekipi është krijuar për të identifikuar dhe për të ndërhyrë me nxënësit e nivelit dy dhe tre që kanë nevojë për mbështetje. Kjo arrihet me një rishikim dhe analizë të të dhënave të mbledhura për të identifikuar nxënësit.



Hapi 3: Identifikohen nxënësit në nevojë për ndërhyrjet e nivelit 2

- Kush ka nevojë për më shumë mbështetje akademike ose të sjelljes?
- Kush mund të përfitojë nga alternativat e masave ndëshkuese?
- Kush mund të përfitojë nga monitorimi, reagimi ose mentorimi?
- Kush demonstron sjelljeje të ngjashme problematike?

Nxënësit mund t'i referohen ekipit pas një numri të caktuar të referimesh në zyrën e drejtuesve të shkollës (p.sh. 3-5). Ata gjithashtu mund të referohen nga këshilli i prindërve.

SHEMBUJ TË NDËRHYRJEVE DHE MBËSHTETJEVE NË NIVELIN E DYTË

- | | |
|---|---|
| <ul style="list-style-type: none">• Takimet prindër – nxënës – mësues• Grupet e formimit të aftësive sociale dhe emocionale• Grupet e trajnimit të aftësive akademike• Mbështetje akademike të shtuar• Plan i sjelljes• Lidhje të shtuara të nxënësit me komunitetin duke kryer detyra domethënëse | <ul style="list-style-type: none">• Grupe mbështetëse prindërisht• Trajtime për prindërit• Mbikëqyrje të shtuar në mjediset jashtë klasës• Kohë e pushimit e strukturuar• Plane dhe orare alternative• Mbikëqyrje aktive• Programe mentorimi• Programe me bazë komunitetin |
|---|---|

Hapi 4: Identifikohen një seri ndërhyrjesh që adresojnë nevoja të ndryshme të nxënësve.

Ndërhyrjet në nivelin e dytë zakonisht përfshijnë strukturën, nxitjen, monitorimin, reagimet dhe udhëzime të shtuara mbi sjelljen dhe aftësinë akademike. Ndërhyrjet përzgjidhen bazuar në nevojat emocionale, të sjelljes dhe akademike të nxënësve, duke marrë parasysh kulturën e shkollës dhe burimet në dispozicion të saj.

Hapi 5: Caktimi i ndërhyrjeve të duhura për nxënësit dhe monitorimi i progresit të tyre

Ndërhyrjet për secilin nxënës duhet të përcaktohen përmes një procesi vendim-marrës duke bërë një vlerësim të plotë për gjendjen e fëmijës në bashkëpunim me ekipin e ngritur për mbështetjen e nxënësve në kuadër të NSP-ve.



EKIPET E MBËSHTETJES SË NXËNËSVE NË VEPRIM

Ky ekip krijohet për të mbështetur nxënësit që kanë sfida kronike akademike dhe të sjelljes. Detyrat kryesore përfshijnë:

- Zhvillimin e një procesi sistematik për identifikimin e nxënësve në rrezik (përmes të dhënave dhe emërimit të mësuesve)
- Identifikimin e nxënësve që kanë nevojë për mbështetje më të madhe
- Përzgjedhjen e ndërhyrjeve për nivelin e dytë
- Përshtatjen e nxënësve me ndërhyrjet më të përshtatshme
- Monitorimin e progresit të nxënësve duke dokumentuar ndërhyrjet dhe rezultatet e tyre
- Monitorimin e efektivitetit të ndërhyrjeve dhe rregullimin sipas nevojës
- Komunikimin e progresit me nxënësin, stafin dhe familjen

Ky ekip duhet të marrë trajnim për hulumtimin dhe ndërhyrjet që lidhen me nivelin e dytë. Ata gjithashtu duhet të trajnohen për të kryer vlerësime funksionale të sjelljes.

Pasi ndërhyrja është zbatuar, nxënësit që tregojnë përmirësim mund të kalojnë në varësi të masave mbështetëse të nivelit të parë, por për ata që vazhdojnë të shfaqin sjellje problematike mund të kenë nevojë të referohen për ndërhyrje më intensive të ofruara nga niveli 3 i ndërhyrjeve.

Hapi 6: Rishikimi i ndërhyrjeve të përzgjedhura për përcaktimin e efikasitetit të tyre

Duhet të bëhet monitorimi i vazhdueshëm i ndërhyrjeve. Të dhënat mund të merren nga burime të tilla si formularët e referimit të shkollës, frekuentimi i nxënësit, vëzhgimi i nxënësit si dhe raportet e stafit dhe familjes për progresin e nxënësit.

Nëse është e nevojshme, ndërhyrjet mund të modifikohen, të rishikohen ose të fshihen nga lista e ndërhyrjeve të përdorura.

Në çdo mjedis shkollor ekziston një grup i vogël nxënësish që nuk i përgjigjen as ndërhyrjeve të nivelit të parë dhe as atyre të nivelit të dytë. Ky grup nxënësish, edhe pse i vogël në numër, ka potencialin për të absorbuar një përqindje të lartë të burimeve të shkollës. Këta nxënës kërkojnë vazhdimin e mbështetjes kryesore të nivelit një dhe dy, por ato gjithashtu kanë nevojë për mbështetje intensive dhe bashkëpunuese. Është veçanërisht e rëndësishme të ndërhyhet me këta nxënës, sepse sjellja e tyre e problematike kronike shpesh i vë ata në rrezik të braktisjes, dëbimit ose përfshirjes në sistemin penal.



NIVELI 3 - i ndërhyrjes për sjelljet pozitive

Hapi 1: Shqyrtimi i ndërhyrjeve të nivelit 1 dhe 2 për t'u siguruar që ato po funksionojnë efektivisht

Vetë raportimet, vëzhgimet, referimet në zyrën e drejtorit, raportet nga nxënësit, prindërit dhe stafi mund të përdoren për të shqyrtuar nëse këto ndërhyrje janë zbatuar në mënyrë efektive ose nëse ato kërkojnë rregullim.

Hapi 2: Përcaktimi se si do të identifikohen nxënësit për mbështetjet e nivelit të tretë

Nëse një ose më shumë ndërhyrje të nivelit të dytë janë zbatuar pa sukses, ekipi mbështetës i nxënësit mund të konsiderojë mbështetje më intensive.

Disa raste ku mund të zbatohen ndërhyrjet e nivelit të tretë përfshijnë:

- Nxënësit që nuk reagojnë ndaj nivelit të parë dhe dytë
- Shkeljet e rrezikshme ose jo të përshtatshme
- Shkeljet kronike

Hapi 3: Përzgjedhja dhe zbatimi i ndërhyrjeve që adresojnë nevojat e ndryshme të nxënësve

Shembuj të ndërhyrjeve përfshijnë:

- Vlerësime funksionale të sjelljes
- Planet individuale për mbështetjen e sjelljes
- Bashkëpunim me prindërit
- Bashkëpunim me qendra sociale dhe specialistë që punojnë me adoleshentët
- Mësim intensiv të aftësive shoqërore
- Referim te një këshillues, punonjës social, psikolog ose mjek



Hapi 4: Identifikimi i personave burimorë dhe agjencie në komunitet te të cilat mund të referohet nxënësi për mbështetje më të mirë.

Mund të jetë e nevojshme të kërkohet mbështetje për këta nxënës jashtë mjedisit shkollor. Shkollat duhet të jenë të vetëdijshme dhe të njohin institucionet dhe agjencitë në komunitet që punojnë me fëmijët dhe familjet e tyre për çështje si prindërimi, abuzimi i substancave, shëndeti mendor dhe mbështetja akademike. Ata duhet të kërkojnë të zhvillojnë një marrëdhënie me këto institucione ose individë, në mënyrë që të mund të bashkëpunojnë ose t'i referohen sipas nevojës.

Ekipi koordinues i NSP-ve në shkollë

(Procesi i zbatimit të NSP-ve ndjek rrugën që paraqet skema e mëposhtme:)

Me fokus planifikimin e veprimtarive, koordinimin dhe zbatimin me sukses të tyre, procesi i zbatimit të NSP-ve nis me ngritjen e ekipit koordinues në nivel shkolle.

- Ekipi koordinues i NSP-ve në shkollë duhet të mbështetet fuqimisht nga drejtuesit e shkollës. Ekipi duhet të ketë përfaqësim të të gjithë anëtarëve të shkollës, duke përfshirë përfaqësimin në nivel klase, ekspertë të sjelljes, staf tjetër ndihmës, përfshirë edhe prindër;
- Drejtuesi i shkollës krijon kushte për mbarëvajtjen e procesit të zbatimit të NSP-ve në shkollë;
- Ekipi koordinues i NSP-ve zhvillon seanca kualifikuese/trajnuese për çështje të ndryshme që lidhen me NSP-të;
- Ekipi i MNSP-ve mblidhet dy herë në muaj në vitet e para të zbatimit, dhe më pas çdo 3-4 javë për t'u siguruar për zbatueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e NSP-ve;
- Ekipi i NSP-ve krijon një sistem efektiv takimesh, duke përfshirë rendin e ditës, duke mbajtur dhe shpërndarë procesverbalet e takimeve, duke vendosur dhe duke respektuar afate, duke analizuar të dhënat dhe duke punuar jashtë orarit ndërmjet takimeve, për të siguruar mbarëvajtjen e punës.



Roli i ekipit koordinues të shkollës

Zbatimi i parimeve të shkollës efektive në drejtim të menaxhimit të sjelljes kërkon një qasje bashkëpunimi. Sapo shkolla të vendosë për zbatimin e NSP-ve duhet të krijohet një ekip në bazë shkolle për të koordinuar procesin e ndërhyrjeve dhe mbështetjes së sjelljes pozitive.

Ky ekip do të jetë përgjegjës për kryerjen e një vlerësimi fillestar të nevojave, zhvillimin e një plani veprimi dhe udhëzimin dhe monitorimin e zbatimit të këtij plani.

SIGURIMI I MBËSHTETJES PRINDËRORE

Mbështetja e prindërve është thelbësore për suksesin e zbatimit të NSP-ve. Kjo mbështetje mund të inkurajohet përmes:

1. Orientimeve të prindërve
2. Ditët e Hapura
3. Vazhdimësia dhe komunikimi përmes metodave të ndryshme
4. Trajnimet e prindërve

Përbërja e ekipit koordinues të shkollës

Ekipi duhet të jetë përfaqësues i të gjithë komunitetit të shkollës. Ai duhet të përfshijë përfaqësues nga të gjitha nivelet e stafit të shkollës: drejtues të shkollës, mësues kujdestar, kryetarë të departamenteve lëndorë, mësues nga departamente të ndryshme lëndorë, psikolog shkollor, punonjës social, përfaqësues të nxënësve dhe përfaqësues të prindërve.

Anëtarët e tjerë të stafit mund të bashkëpunojnë sipas nevojës pasi ekipi fillon të adresojë fusha të ndryshme të zbatimit. Për shembull, ekipi mund të dëshirojë të angazhojë anëtarë të stafit për të shërbyer si një ekip mbështetës për sjelljen e nxënësve, ekip për menaxhimin e të dhënave ose një komitet për sigurinë në shkollë. Për të punuar më mirë dhe për të siguruar përdorimin optimal të burimeve, do të jetë e rëndësishme të përcaktohet se cilat komitete duhet të ngrihen në shkollë, cilat duhet të kombinohen dhe cilat kërkojnë më shumë mbështetje.

Ekipi i shkollës duhet të jetë i trajnuar për të udhëhequr procesin e zbatimit të veprimtarive dhe ndjekjes së hapave që cojnë në ndryshimin e sjelljes dhe më tej në përmirësimin e rezultateve të nxënësve.



Ekipi duhet të takohet të paktën një herë në muaj, por gjatë planifikimit fillestar ekipi mund të duhet të takohet më shpesh për të lehtësuar procesin e vlerësimit të nevojave, për të zhvilluar një plan veprimi dhe për të zgjidhur problemin.

Vlerësimi i nevojave

Një vlerësim gjithëpërfshirës i nevojave mund të ndihmojë shkollat të identifikojnë cilat fusha janë prioritare për stafin dhe nxënësit në shkollë. Nxënësve, mësuesve, stafit jo mësimdhënës dhe prindërve duhet t'u jepet mundësia për të marrë pjesë në vlerësimin e nevojave.

Sondazhet, grupet e fokusit, intervistat dhe vëzhgimi janë disa prej formave me anë të të cilave mund të kryhet vlerësimi i nevojave. Duhet të theksohet se qeveria e nxënësve mund të luajë një rol të rëndësishëm në mbështetjen e procesit të vlerësimit të nevojave.

Fushat mbi të cilat mund të kryhet vlerësimi i nevojave përfshijnë:

- Sigurinë në shkollë;
- Struktura disiplinore në shkollë;
- Pjesëmarrjen e nxënësve;
- Përfshirjen e prindërve;
- Praktikën me në qendër nxënësit;
- Edukimin për shëndetin dhe jetën familjare; etj

Krijimi i një plani të shkollës

Pasi të përfundojë vlerësimi i nevojave, mund të hartohet një plan i shkruar i zbatimit me përfshirjen e të gjithë aktorëve. Plani projektohet me synimin për përmirësimin e disiplinës, të arritjeve akademike dhe klimës së shkollës. Plani duhet të identifikojë një seri aktivitetsesh, burimesh dhe njerëzish të nevojshëm për të arritur qëllimet e shkollës. Plani duhet të përfshijë qëllime afatshkurtra dhe afatgjata pasi procesi i përmirësimit të sjelljeve zgjat për disa vjet. Duke pasur parasysh ngarkesën që kanë mësuesit në arsimin e detyruar, plani mund të ndihmojë mësuesit për të mbajtur parasysh dhe përqendruar te qëllimet më shumë se sa koha e harxhuar dhe kërkesat konkurruese.

KRIJIMI I NJË EKIPI UDHËHEQËS

- ♪ Përdorimi i sa më shumë nga komisionet ekzistuese
- ♪ Përfshirja e praktikave të NSP-ve në aktivitete dhe nismat aktuale
- ♪ Komunikimi i shpeshtë me stafin për t'i ndihmuar ata të ndjehen pjesë e procesit të ndryshimit.
- ♪ Angazhimi i stafit në procesin e zgjidhjes së problemeve



HARTIMI I PLANIT TË VEPRIMIT PËR SHKOLLËN TUAJ

1. Komunikimi i planit.

Pasi plani të jetë finalizuar takohuni me të gjithë aktorët për ta ndarë atë. Përshkruani synimet, hapat e ardhshëm dhe si mund ta mbështesin procesin ata.

2. Zbatimi i planit.

Disa plane nuk arrijnë të realizohen. Drejtuesit dhe koordinatorët duhet në mënyrë aktive të kërkojnë që kjo të mos ndodhë duke përcjellë një mesazh të ndryshimit dhe zbatimit pozitiv. Mendoni qëndrueshmërinë ndërkohë që zbatoni.

3. Vlerësimi i përpjekjeve tuaja.

Përdorni vlerësime, lista kontrolli dhe vëzhgime për të monitoruar dhe vlerësuar zbatimin në mënyrë të vazhdueshme.

ZBATIMI I PARIMEVE TË SHKOLLËS EFEKTIVE

1. Gjithmonë përfshini këshilltarin udhëzues në ekip;
2. Përfshini nxënësit;
3. Përdorni strukturat ekzistuese në mënyrë që të mos dalin si punë shtesë;
4. Kryeni ndërhyrjet bazuar në realitetin e shkollës
5. Jini të vetëdijshëm se është një proces dhe duhet kohë.

Vendosja e pritshmërive për shkollën sipas MNSP-ve

- a. Zhvillohen tre apo më shumë pritshmëri të mëdha (të përgjithshme) të sjelljes që zbatohen në mbarë shkollën dhe aplikohen për të gjithë nxënësit dhe stafin.
- b. Zhvillohet një matricë e gjerë e sjelljes në shkollë e përbërë nga rreth 20 ose më pak rregulla të sjelljes që janë në linjë me 3 apo më shumë pritshmëritë e sjelljes dhe vendndodhjet specifike në shkollë ku ndodhin sjelljet më problematike. Rregullat duhet të jenë specifike, të matshme, të përshtatshme për moshën, të shkurtra dhe të deklaruara në formulime pozitive. Rregullat mund të përsëriten, por duhet të përsëriten përmes një pritshmërie të caktuar.

Ndiq shembullin në faqen pasuese



3 I-të	Në klasë	Në korridor	Në tualete	Në oborr
I sigurtë				
I respektueshëm				
I përgjegjshëm				

c. Mësohen sjelljet e pritshme duke përdorur një qasje të drejtpërdrejtë mësimi të tyre: shpjegim, modele, përfshirje në veprimtari të ndryshme mësimore, gjetja e kohës për praktikë/lojë me role dhe nxitja e kujtesave. Mbikëqyren në mënyrë aktive dhe përforcohen pozitivisht sjelljet e pritshme.

d. Mësuesit duhet të marrin trajnim se si të përfshijnë sisteme më efektive për mbështetjen e sjelljeve në klasë, si për shembull:

- Mësuesit duhet të përcaktojnë dhe të vendosin 5 ose më pak rregulla të klasës të përafuara me pritshmëritë e sjelljes të vendosura në shkollë. Rregullat duhet të jenë specifike, të matshme, të përshtatshme për moshën, të shkurtra dhe të deklaruara me fjalë dhe formulime pozitive.
- Mësuesit duhet të përcaktojnë në mënyrë qartë procedurat në klasë dhe t'ua mësojnë nxënësve rregullisht.
- Mësuesit duhet të zhvillojnë dhe të përcaktojnë një procedurë të reagimit ndaj sjelljeve negative të nxënësve që është e lidhur ngushtë me skemën e përcaktuar në nivel shkolle për sjelljet problematike të vogla.









MODULI 4

**STRATEGJI TË NSP-ve
NË NIVEL KLASË**





ZBATIMI I NSP-ve NË SHKOLLË

PRITSHMËRITË:

- Identifikimi dhe të kuptuarit e formave të ndërhyrjes për ndryshimin e sjelljes në kushtet e klasës
- Vlerësimi i strategjive të NSP-ve në klasë si mjete të rëndësishme për të ulur problemet që lidhen me sjelljen
- Gjetja e rrugëve për integrimin e strategjive në klasë me planifikimin efektiv të mësimdhënies, kurrikulën dhe veprimtaritë mësimore
- Identifikimi i veprimtarive më të nevojshme për kushtet specifike të klasës të secilit mësues
- Prezantimi i shembujve se si mësuesit mund t'i përdorin në klasë strategjitë për të mbështetur sjelljet e nxënësve.

Qëllimi i kësaj pjese është të paraqesë ndërhyrjet për ndryshimin e sjelljes në kushtet e klasës, bazuar në dëshmi dhe strategji mbështetëse për mësuesit. Praktikrat e NSP-ve në klasë përfshijnë qasje parandaluese dhe të përgjegjshme që mund të zbatohen në mënyrë efektive me të gjithë nxënësit në një klasë dhe të intensifikohen për të mbështetur grupe të vogla ose disa nxënës individualisht. Strategjitë e NSP-ve në klasë janë mjete të rëndësishme për të ulur problemet, për të menaxhuar kohën mësimore, për të përmirësuar sjelljen e nxënësve dhe rezultatet akademike të tyre.


Efektiviteti i këtyre strategjive në klasë maksimizohet kur:

- ✎ strategjitë zbatohen brenda një kornize sjelljeje që përfshin mbarë shkollën, siç janë ndërhyrjet pozitive të sjelljes në bazë shkolle prezantuar në pjesët paraardhëse;
- ✎ pritshmëritë e klasës janë të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me ato shkollës;
- ✎ strategjitë në klasë bashkohen apo integrohen me planifikimin efektiv të mësimdhënies, kurrikulës dhe veprimtarive mësimore;
- ✎ të dhënat e mbledhura nga situatat në klasë përdoren për të udhëhequr vendimmarrjen.



Ku duhet filluar?

Harta interaktive, e paraqitur më poshtë, ofron një paraqitje organizative të NSP-ve në klasë dhe disa përkufizime themelore të termave që mund të jenë të dobishme të njihen përpara se të ndërmerret një vetëvlerësim. Mësuesit duhet të fillojnë punën me vetëvlerësimin për të përcaktuar praktikatat e nevojshme të menaxhimit të klasës. Vetëvlerësimi është dizajnuar për të ndihmuar mësuesit të dinë se ku ta përqendrojnë vëmendjen e tyre. Pasi mësuesit të kryejnë vetë-vlerësimin, harta interaktive do t'i drejtojë ata te veprimtaritë që do të jenë më të nevojshme. Ndërsa diagrami i procesit të vendimmarrjes përdoret për të ndihmuar mësuesit në udhëzimin për marrjen e vendimeve për të bërë rregullime brenda klasave të tyre.



Vetëvlërësimi ndërhyrjeve dhe mbështetjes në klasë

Mësuesit duhet të fillojnë me fishën e parë mbi vetëvlërësimin. Kur nuk janë të sigurt për një përgjigje, mësuesit duhet të shkojnë në pjesën e hartës interaktive të mësipërme dhe të lexojnë më shumë rreth praktikës.

Vetëvlërësimi i ndërhyrjeve dhe mbështetjes në klasë		Po	Jo
1.	Klasa është e organizuar fizikisht për të përmbushur nevojat e të gjithë nxënësve.		
	Nëse po, vazhdoni me vetëvlërësimin. Nëse jo, filloni me 1.1 në hartën interaktive.		
2.	Rutinat në klasë zhvillohen, mësohen dhe parashikohen.		
	Nëse po, vazhdoni me vetëvlërësimin. Nëse jo, filloni me 1.2 në hartën interaktive.		
3.	Tre ose më shumë rregulla janë përcaktuar qartë dhe janë shpallur, afishuar dhe mësuar në klasë		
	Nëse po, vazhdoni me vetëvlërësimin. Nëse jo, filloni me 1.3 në hartën interaktive.		
4.	Përdoren kujtesa dhe praktikatat e mbikëqyrjes në mënyrë proaktive.		
	Nëse po, vazhdoni me vetëvlërësimin. Nëse jo, filloni me 2.1 në hartën interaktive		
5.	Mundësitë për t'u përgjigjur janë të ndryshme dhe ofrohen vazhdimisht.		
	Nëse po, vazhdoni me vetëvlërësimin. Nëse jo, filloni me 2.2 në hartën interaktive		
6.	Përdoren shprehje specifike dhe strategji të tjera për të njohur sjelljen.		
	Nëse po, vazhdoni me vetëvlërësimin. Nëse jo, filloni me 2.3 në hartën interaktive		
7.	Përdoren vazhdimisht kujtesa përpara se të ndodhë një sjellje.		
	Nëse po, vazhdoni me vetëvlërësimin. Nëse jo, filloni me 2.4 në hartën interaktive		
8.	Reagimet ndaj sjelljeve të këqija në klasë janë të përshtatshme dhe sistematike.		
	Nëse po, vazhdoni me vetëvlërësimin. Nëse jo, filloni me 2.5 në hartën interaktive		
9.	Sistemet e të dhënave përdoren për të mbledhur informacion rreth sjelljeve në klasë.		
	Nëse po, vazhdoni me vetëvlërësimin. Nëse jo, filloni me tabelën 3 në hartën interaktive		
Nëse vendosët po të gjitha, festoni sukseset!			
Vazhdoni të monitoroni dhe të bëni rregullime sipas nevojës			

Diagrami i vendimmarrjes

Diagrami i vendimmarrjes do të ndihmojë në udhëzimin e mësuesit lidhur me zbatimin e praktikave më të mira në parandalimin dhe reagimin ndaj sjelljeve në klasë.




Tabela 1. Matrica e hapave fillestarë për NSP-të në klasë

1.1 MJEDISI I KLASËS DISENJIMI EEFKTIV I MJEDISIT FIZIK TË KLASËS			
Përshkrimi dhe veçoritë specifike	Shembuj në Ciklin Fillor	Shembuj në Ciklin e Lartë	Shembuj jo korrekt
<i>Çfarë strategjish mund të përdoren për të mbështetur sjelljet pozitive në klasë?</i>	<i>Si mund të përdoret kjo praktikë në klasën e ciklit fillor?</i>	<i>Si mund të përdoret kjo praktikë në klasën e ciklit të lartë?</i>	<i>Çfarë duhet të shmanget kur po zbatohet kjo praktikë?</i>
<ul style="list-style-type: none"> • Organizimi i klasës në funksion të lehtësimit të veprimtarive tipike mësimore (p.sh: grupe të vogla, grup i madh, qendra të nxëni). • Organizimi i orendive për të lehtësuar lëvizjen pa vështirësi të mësuesit dhe nxënësve • Sigurimi që materialet mësimore të jenë të rregullta, të pastra dhe të gatshme për përdorim • Afishimi i materialeve që mbështesin përmbajtjen dhe strategjitë e të nxënit (p.sh. tabelat magnetike, rregullat e shkkrimit, formula matematikore) 	<ul style="list-style-type: none"> • Organizimi i klasës sipas llojit të veprimtarisë që zhvillohet: <ul style="list-style-type: none"> - Tavolinat për qendrat e aktivitetit; - Tavolina të ndara për punë të pavarur; - Sipërfaqe rrethore për detyra në grup. • Mundësimi i aksesit të nxënësit ndaj materialeve didaktike. • Përdorimi i vendeve dhe zonave të shënuara. • Sigurimi i mundësisë që të gjithë nxënësit të mund të shihen. 	<ul style="list-style-type: none"> • Organizimi i klasës sipas llojit të veprimtarisë që zhvillohet: <ul style="list-style-type: none"> - Rrethi i diskutimit; - Vendosja përballë për mësimin që zhvillohet në grup. • Përdorimi i vendeve/karrigeve të shënuara. • Sigurimi i mundësisë që të gjithë nxënësit të mund të shihen. • Gjetja e mundësive për ruajtjen e sendeve personale të nxënësve (p.sh. çantave të shpinës, fletoret apo librat për lëndët e tjera). 	<ul style="list-style-type: none"> • Pajisjet dhe materialet janë të dëmtuara, të pasigurta dhe / ose jo në kushte të mjaftueshme pune ose nuk janë të arritshme për të gjithë nxënësit. • Ambienti i çrregullt, i papastër dhe / ose i pamjaftueshëm. • Disa nxënës dhe / ose pjesë të klasës nuk janë të dukshëm për mësuesin. • Mobilje me përmasa jo të përshtatshme.

1.2 RUTINAT

ZHVILLIMI DHE MËSIMI NË KLASË I RUTINAVE TË PARACAKTUARA

Përshkrimi dhe veçoritë specifike <i>Çfarë strategjish mund të përdoren për të mbështetur sjelljet pozitive në klasë?</i>	Shembuj në Ciklin Fillor <i>Si mund të përdoret kjo praktikë në klasën e ciklit fillor?</i>	Shembuj në Ciklin e Lartë <i>Si mund të përdoret kjo praktikë në klasën e ciklit të lartë?</i>	Shembuj jo korrekt <i>Çfarë duhet të shmangët kur po zbatohet kjo praktikë?</i>
<ul style="list-style-type: none">• Vendosja e modeleve dhe aktiviteteve të paracaktuara.• Promovimi i një funksionimi të mirë të klasës.• Përcaktimi i hapave për përfundimin e aktiviteteve të caktuara.• Mësimi drejtpërsëdrejti i rutinave dhe procedurave.• Praktikimi rregullisht.• Përshëndetja/lavdërimi i nxënësve kur ndjekin me sukses rutinat dhe procedurat në klasë.• Krijimi i rutinave dhe procedurave për vendet apo momentet më problematike.• Promovimi i rutinave dhe orareve të udhëhequr nga vetë nxënësit.	<ul style="list-style-type: none">• Përcaktimi i rutinave dhe procedurave për:<ul style="list-style-type: none">- mbërritjen dhe largimin nga shkolla;- kalimet nga një veprimtari në tjetrën;- vlerësimin e ndihmës;- veprimet pas përfundimit të punës;• Shembull rutinash të mbërritjes:<ul style="list-style-type: none">- Vendosja në varëse e xhupave dhe çantave;- Vendosja e shënimeve dhe detyrave të shtëpisë në "xhepin" e nxënësit;- Mprehja e lapsave;- Ulja në bankë dhe fillimi i veprimtarive nxemëse që janë shkruar në tabelë;- Nëse përfundon më shpejt, lexohet një libër.	<ul style="list-style-type: none">• Merren në konsideratë rutinat dhe procedurat për:<ul style="list-style-type: none">- kthimin në punë;- shpërndarjen e materialeve;- përgatitjen e detyrave të humbura;- veprimet pas përfundimit të punës.• Shembuj të rutinave gjatë orës së mësimi:<ul style="list-style-type: none">- Aktivitete nxemëse për nxënësit;- Rishikimi i mësimëve së mëparshme;- Udhëzim për materiale të reja;- Mundësi për praktikë të udhëhequr ose të pavarur;-Aktivitete përmblyëse.	<ul style="list-style-type: none">• Supozimi nga mësuesi se nxënësit i njohin automatikisht rutinat dhe procedurat e paracaktuara pa dhënë udhëzime.• Mosdhënia e detyrave që nxënësit priten t'i plotësojnë rregullisht.• Mundësitë e munguara për të siguruar: (a) kujtesa vizuale dhe / ose dëgjimore për nxënësit mbi rutinat dhe procedurat e paracaktuara nga mësuesi (p.sh. shenjat, postera, foto, sinjale me duar, muzikë të caktuar, kohëmatës); dhe / ose (b) reagime në lidhje me performancën e nxënësve

1.3 PRITSHMËRITË

SHPALEN, AFISHOHEN DHE MËSOHEN TRE – PESË PRITSHMËRI POZITIVE TË KLASËS

Përshkrimi dhe veçoritë specifike <i>Çfarë strategjish mund të përdoren për të mbështetur sjelljet pozitive në klasë?</i>	Shembuj në Ciklin Fillor <i>Si mund të përdoret kjo praktikë në klasën e ciklit fillor?</i>	Shembuj në Ciklin e Lartë <i>Si mund të përdoret kjo praktikë në klasën e ciklit të lartë?</i>	Shembuj jo korrekt <i>Çfarë duhet të shmangët kur po zbatohet kjo praktikë?</i>
<ul style="list-style-type: none"> • Nëse është një shkollë që zbaton një kornizë për menaxhimin e sjelljes, mund të miratojë tri deri në pesë pritshmëri pozitive të shkollës dhe të zbatohen në çdo klasë. • Pritshmëritë duhet të jenë të vëzhgueshme, të matshme, të deklaruar pozitivisht, të kuptueshme dhe gjithmonë të zbatueshme. • Pritshmëritë mësohen duke përdorur shembuj dhe jo shembuj dhe me mundësinë për t'i praktikuar dhe marrë reagime. • Nxënësit përfshihen në përcaktimin e pritshmërive brenda rutinave të klasës (sidomos në ciklin e lartë). • Duhet të fitohet përkushtimi i nxënësve për të mbështetur pritshmëritë. 	<ul style="list-style-type: none"> • Shpallja: <ul style="list-style-type: none"> - Në klasë dhe në mënyrë të kujdesshme; - Shembull: I sigurt, I respektueshëm, I përgjegjshëm (3 I-të). • Afishimi në çdo mjedis klase apo shkolle: <ul style="list-style-type: none"> - Të jesh i sigurt do të thotë duart dhe këmbët pranë vetes gjatë lëvizjeve; - Të jesh i sigurtë do të thotë të përdorësh të gjitha materialet e klasës në mënyrë korrekte. • Mësimi: <ul style="list-style-type: none"> - Zhvillohen mësimet për t'i mësuar pritshmëritë; - Kur bashkëprohet me nxënësit i referohesh rregullisht pritshmërive (gjatë lëvdatave specifike dhe korrigjimeve të gabimeve) 	<ul style="list-style-type: none"> • Shpallja: <ul style="list-style-type: none"> - Në klasë dhe në mënyrë të kujdesshme; - Shembull: I sigurt, I respektueshëm, I përgjegjshëm (3 I-të). • Afishimi në çdo mjedis klase apo shkolle: <ul style="list-style-type: none"> - Të jesh i sigurt do të thotë duart dhe këmbët pranë vetes gjatë lëvizjeve; - Të jesh i respektueshëm do të thotë të përdorësh gjuhë gjithëpërfshirëse; - Të jesh përgjegjës do të thotë të kesh gjithcka të gatshme në fillim të mësimet. • Mësimi: <ul style="list-style-type: none"> - Zhvillohen mësimet për t'i mësuar pritshmëritë - Kur bashkëprohet me nxënësit i referohesh pritshmërive rregullisht 	<ul style="list-style-type: none"> • Supozimi nga mësuesi se nxënësit i njohin pritshmëritë e përcaktuara. • Të ketë më shumë se pesë pritshmëri. • Të listohen vetëm sjelljet që nuk priten nga nxënësit (p.sh., pa telefon, pa folur, pa xhamcakëz. • Krijimi i pritshmërive që nuk jeni të gatshëm t'i zbatoni vazhdimisht. • Përzgjedhja e pritshmërive që janë të papërshtatshme për nivelin e zhvillimit ose moshën. • Zgjedhja e pritshmërive që nuk mbulojnë mjaftueshëm të gjitha situatat. • Injorimi i pritshmërive të vendosura në nivel shkolle

Tabela 2. Matrica e praktikave për ndërhyrjet dhe mbështetjet në klasë

2.1 MBIKQYRJA

MBIKQYRJA AKTIVE DHE AFËRSIA

Përshkrimi dhe veçoritë specifike	Shembuj në Ciklin Fillor	Shembuj në Ciklin e Lartë	Shembuj jo korrekt
<p><i>Çfarë strategjish mund të përdoren për të mbështetur sjelljet pozitive në klasë?</i></p> <p>Një proces për monitorimin e klasës apo çdo mjedisi të shkollës që duke lëvizur, skanuar dhe bashkëpunuar e vazhdimisht me nxënësit, i cili përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Skanimin: mbulim vizual të tërë hapësirës. • Lëvizjen: lëvizja e vazhdueshme, afërsia. • Ndërveprimin: komunikim verbal në mënyrë të respektueshme, tërheqje të vëmendjes, reagime verbale specifike. 	<p><i>Si mund të përdoret kjo praktikë në klasën e ciklit fillor?</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Ndërsa nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur në qendra/grupe, mësuesi vëzhgon dhe lëviz nëpër klasë, duke kontrolluar nxënësit. • Ndërsa punohet me një grup të vogël nxënësish, mësuesi vazhdimisht vëzhgon dhe skanon klasën për t’u siguruar që nxënësit e tjerë janë akoma në rrugë të mbarë. • Gjatë kalimit nga një veprimtari në tjetrën mësuesi lëviz mes nxënësve për të siguruar afërsinë; skanon vazhdimisht për të parandaluar probleme dhe jep reagime të shpeshta. 	<p><i>Si mund të përdoret kjo praktikë në klasën e ciklit të lartë?</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Ndërsa monitoron nxënësit, mësuesi lëviz rreth zonës, ndërvepron me ta dhe vëzhgon sjelljet e individëve dhe të grupit. Skanon të gjithë zonën ndërsa lëviz nëpër të gjithë qoshet e klasës. • Mësuesi ndërvepron herë pas here me nxënësit. Pyet se si po e kryejnë, komenton ose pyet për interesat e tyre. Tregon interes të sinqertë në përgjigjet e tyre (Kjo është një mundësi për t’u lidhur me nxënësit). 	<p><i>Çfarë duhet të shmanget kur po zbatohet kjo praktikë?</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Qëndrimi ulur ose pa lëvizur atje ku nuk mund të shihet e gjithë klasa ose hapësira, siç është qëndrimi me shpinë nga grupi ose pas tavolinës suaj. • Ecja në të njëjtën rrugë të parashikueshme gjatë gjithë kohës, siç është ecja në rreshtat e tavolinave në të njëjtën mënyrë gjatë gjithë kohës. • Ndalimi dhe biseda me një nxënë të vetëm ose një grup nxënësish për disa minuta. • Bashkëveprimi me të njëjtit nxënë apo grup nxënësish çdo ditë.



Tabela 2. Matrica e praktikave për ndërhyrjet dhe mbështetjet në klasë

2.2 MUNDËSIA SIGURIMI I MUNDËSIVE TË SHUMTA DHE TË NDRYSHME PËR T’U PËRGJIGJUR			
Përshkrimi dhe veçoritë specifike	Shembuj në Ciklin Fillor	Shembuj në Ciklin e Lartë	Shembuj jo korrekt
<p><i>Çfarë strategjish mund të përdoren për të mbështetur sjelljet pozitive në klasë?</i></p>	<p><i>Si mund të përdoret kjo praktikë në klasën e ciklit fillor?</i></p>	<p><i>Si mund të përdoret kjo praktikë në klasën e ciklit të lartë?</i></p>	<p><i>Çfarë duhet të shmanget kur po zbatohet kjo praktikë?</i></p>
<p>Një sjellje e mësuesit që kërkon një përgjigje nga nxënësit (p.sh., duke bërë një pyetje, duke paraqitur një kërkesë)</p> <p>Mundësitë për të reaguar përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Pyetje individuale ose për grupe të vogla: - Përdoret një model përgjigjeje për t’u siguruar që të gjithë nxënësit janë thirrur • Përgjigje në kor: - Të gjithë nxënësit në një klasë i përgjigjen njëkohësisht një pyetjeje të mësuesit • Përgjigjet joverbale: - Kartat e përgjigjeve, sistemet e përgjigjeve të nxënësve, shënimet udhëzuese 	<ul style="list-style-type: none"> • Pyetje individuale ose për grupe të vogla: - Emrat e nxënësve mund të jenë në një tabelë, shirita letrash apo në pusulla të vendosura në një vazo. Pasi drejtohet pyetja tërhiqet një emër i nxënësve • Përgjigje në kor: - Nxënësit lexojnë së bashku një mesazh me zë të lartë; - Nxënësit recitojnë së bashku. • Përgjigjet joverbale: - Gishtin e madh të ngritur nëse jeni dakord me zgjedhjen e bërë. 	<ul style="list-style-type: none"> • Pyetje individuale ose për grupe të vogla: - “Unë vetëm iu tregova se si të bëni #1; unë po nis rreshtin e dytë; Bëhu gati të shpjegosh hapat e mi”. • Përgjigje në kor: - “Shkruani një fjali për të përmbledhur pjesën që lexuat, pastaj ndajeni me shokun para se ta ndani me mua”. • Përgjigjet jo verbale: - “Duart lart nëse morët 25 për përgjigjen”; - “Hyni në internet dhe gjeni dy shembuj të jetës reale për “pikën e ngopjes”. 	<ul style="list-style-type: none"> • Një mësues thotë, “Nuk kemi folur fare për këtë, por ju, për detyrë shtëpie, do ta përmbledhni tërë kapitullin. Punoni në heshtje për 45 minuta në këtë përmbajtje të re, dhe unë do t’i mbledh fletoret tuaja në fund të orës”. (Kjo nuk është nxitëse mjaftueshëm dhe nuk nxit angazhimin aktiv të vazhdueshëm.) • Një mësues zhvillon mësim për 20 minuta pa drejtuar ndonjë pyetje apo duke nxitur ndonjë reagim të nxënësve.

Tabela 2. Matrica e praktikave për ndërhyrjet dhe mbështetjet në klasë

2.3 FALENDERIMET

PËRDOTIMI I SHPREHJEVE SPECIFIKE QË LIDHEN ME SJELLJEN

Përshkrimi dhe veçoritë specifike	Shembuj në Ciklin Fillor	Shembuj në Ciklin e Lartë	Shembuj jo korrekt
<p><i>Çfarë strategjish mund të përdoren për të mbështetur sjelljet pozitive në klasë?</i></p> <p>Deklaratë verbale që përmend në mënyrë të qartë sjelljen dhe përfshin një deklaratë që tregon miratim</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mund t'i drejtohet një individit ose grupi. • Falënderimi duhet të jepet menjëherë pas sjelljes, dhe duhet të jetë i kuptueshëm, kuptimplotë dhe i sinqertë. • Ofrohen rreth pesë deklarata lavdërimi për secilën situatë korrigjuese. • Kur jepen lavdërime specifike të sjelljes, merren në konsideratë karakteristikat e nxënësit (mosha, preferencat) dhe përshtaten në përputhje me rrethanat (p.sh., mund të lavdërohet privatisht dhe jo publikisht) 	<p><i>Si mund të përdoret kjo praktikë në klasën e ciklit fillor?</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Mund të ndiqet një procedurë e tillë kur nxënësit dëgjojnë në heshtje udhëzimet: "Ti bëre një punë të mrekullueshme duke qëndruar ulur në heshtje dhe duke dëgjuar çfarë të bësh më pas". • Gjatë dhënies së udhëzimeve nga mësuesi, një nxënës ngre dorën, mësuesi thotë: "Faleminderit që e ngrite dorën." • Mësuesi ecën drejt një nxënësi dhe pëshpërit: "Faleminderit që hytë në klasë në heshtje". 	<p><i>Si mund të përdoret kjo praktikë në klasën e ciklit të lartë?</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • "Grupi Blu, me të vërtetë më pëlqen mënyra se si të gjithë ju dorëzuat projektet në kohë. Ishte një projekt i komplikuar." • "Besa, faleminderit që erdhët në kohë. Kjo është dita e katër radhazi që ju e bëni këtë, mbresëlënëse." • Pasi e tërheq një karrige pranë Drinit, mësuesi thotë: "Unë e vlerësoj shumë mënyrën se si e lehtësove diskutimin në grupin tënd. Kishte shumë mundësira dhe ju e menaxhuat mirë." • Pas shqyrtimit të esesë së një nxënësi, mësuesi shkruan: "Organizim i mirë. Në shkrimin tuaj, ju po përdorni strategjitë që diskutuam!" 	<p><i>Çfarë duhet të shmangët kur po zbatohet kjo praktikë?</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • "Punë e mrekullueshme! Super! (Kjo është një deklaratë e përgjithshme, jo specifike.) • "Jona, më pëlqen si e ngrite dorën". (Dy minuta më vonë) "Jona, kjo ishte një përgjigje e mirë." (Ky është rasti kur lavdërohet i njëjti nxënës pa pushim duke injoruar nxënës të tjerë.) • Një mësues thotë "Duar të bukura", pasi sheh rreth 20 nxënës njëherësh me dëshirë për të marrë fjalën. • "Faleminderit që u përpoqe të veprosh si një njeri". (Kjo, në rastin të mirë, është sarkazëm dhe jo lavdërim i vërtetë.)



2.3 FALENDERIMET (vazhdim)

PËRDOTIMI I SHPREHJEVE SPECIFIKE QË LIDHEN ME SJELLJEN

Përshkrimi dhe veçoritë specifike	Shembuj në Ciklin Fillor	Shembuj në Ciklin e Lartë	Shembuj jo korrekt
<i>Çfarë strategjish mund të përdoren për të mbështetur sjelljet pozitive në klasë?</i>	<i>Si mund të përdoret kjo praktikë në klasën e ciklit fillor?</i>	<i>Si mund të përdoret kjo praktikë në klasën e ciklit të lartë?</i>	<i>Çfarë duhet të shmanget kur po zbatohet kjo praktikë?</i>
<p>Kontratat e sjelljes: Dokumentimi i një marrëveshjeje midis një mësuesi dhe nxënësve për: (a) sjelljet e pritshme, (b) mbështetjet e disponueshme për të inkurajuar sjelljet e pritshme, (c) shpërblimet e fituara si pasojë e sjelljeve të pritshme dhe (d) pasojat nëse sjellja e pritshme nuk ndodh (ose nëse sjellja e padëshiruar ndodh).</p> <p>Perspektiva në grup: Të gjithë nxënësit kanë mundësinë të përbushin të njëjtën pritshmëri dhe të fitojnë të njëjtin shpërblim. Çmimi mund t'i jepet: (a) të gjithë nxënësve kur një ose disa prej tyre plotësojnë kriterin, (b) të gjithë nxënësve nëse të gjithë e plotësojnë kriterin ose, (c) secilit nxënës nëse nxënësi plotëson kriterin.</p> <p>Shpërblimi: Shpërndarja e një dhurate për sjelljen e përshtatshme.</p>	<p>Kontratat e sjelljes: Në fillim të vitit shkollor, nxënësit e klasës nënshkruajnë një “kushtetutë” të klasës. Dokumenti specifikon: (a) sjelljen e pritshme (i sigurt, i respektueshëm dhe i përgjegjshëm), (b) mbështetje të nevojshme, (c) shpërblime (fitojnë kohë argëtimi të premtën), dhe (d) pasojat (përpun përsëri për javën e ardhshme).</p> <p>Perspektiva në grup: “Të gjithë nxënësit do të dorëzojnë detyrat e shtëpisë deri në datën e duhur. Në qoftë se e përbushim këtë qëllim, të premtën e ardhshme ne do të luajmë në palestër në vend që të zhvillojmë një test”.</p> <p>Shpërblimi: Falë çdo nxënësi që punoi në heshtje me detyrën e matematikës për 10 minutat e fundit, secili prej jush fitoi një “biletë” për ta përdorur në teatrin e qytetit/shkollës.</p>	<p>Kontratat e sjelljes: Në fillim të vitit shkollor, mësuesi i ka ftuar nxënësit e tij të firmosin një garanci integriteti. Ajo thekson se nxënësit do ta përfundojnë punën e tyre në mënyrë të pavarur (sjelljet e pritshme), me ndihmën e mësuesit kur të jetë e nevojshme (mbështetjet), që të kenë mundësi të fitojnë pikë të plota në detyra (shpërblime).</p> <p>Perspektiva në grup: “Si klasë, ne do të formojmë pesë pyetje që janë shembuj të “Sintezës”. Nëse mund ta arrini këtë qëllim deri në 12:15, do t’ju lejoj të uleni aty ku dëshironi për 20 minutat e fundit të orës mësimore.</p> <p>Shpërblimi: “Besa, ju ishit shumë e respektueshme kur shoku yt erdhi dhe kërkoi hapësirë afër teje. Ju keni fituar 10 pikë bonus për arsye të sjelljes tuaj. Të lumtë!</p>	<p>Kontratat e Sjelljes: Në një shkollë, nxënësit nënshkruajnë një kontratë ku thuhet se angazhohen në një nisëm “zero tolerancës ndaj shkeljeve”. Në të kundërt, rezultoni në humbjen e privilegjve në shkollë dhe mund të çojë edhe në pezullim ose përjashtim. Nxënësve nuk iu bëhet asnjë kujtesë për këtë kontratë nëse nuk ka ndodhur një shkelje. Kur shkelja ndodh ata mund të dëbohen, edhe nëse shkelja nuk ishte e rëndë.</p> <p>Perspektiva në grup: Vendosija e një qëllimi të paarrtshëm (p.sh. të gjithë nxënësit do të shfaqin/performojnë sjellje të përsosur gjatë gjithë vitit), duke përdorur një shpërblim që nuk mund të jepni (p.sh., ditë pushimi të premtën). Përdorimi i shpërblimeve për të inkurajuar nxënësit që të angazhohen në sjellje që nuk janë në interesin e tyre më të mirë (kjo është rryshfet).</p> <p>Dhurata: Dhënia e pikëve ose dhuratave pa lavdërim të veçantë ose të të njëjtëve nxënës ose grupe nxënësish ose dhënia e dhuratave apo pikëve pa sjellje të demonstruar.</p>

2.4 NXITËSIT DHE SAKTËSIMET

PARANDALIMI I SJELLJES PROBLEMATIKE PËRMES NXITËSVE DHE KUJTESAVE

Përshkrimi dhe veçoritë specifike	Shembuj në Ciklin Fillor	Shembuj në Ciklin e Lartë	Shembuj jo korrekt
<p><i>Çfarë strategjish mund të përdoren për të mbështetur sjelljet pozitive në klasë?</i></p> <p>Janë kujtesat që përdoren përpara një sjelljeje që pritet të ndodhë, të cilat përshkruajnë se çfarë kërkohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Parandaluese: bëhet para se reagimi i sjelljes të ndodhë; • E kuptueshme: nxitësi duhet të kuptohet nga nxënësi; • E vëzhgueshme: nxënësi duhet të dallojë kur bëhet nxitësi; • Specifike dhe të qarta: përshkruajnë sjelljen e pritshme (dhe lidhen me pritshmëritë e duhura). 	<p><i>Si mund të përdoret kjo praktikë në klasën e ciklit fillor?</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Përpara se nxënësit të fillojnë një detyrë klase, bëhet një kujtesë për se si do të kërkojnë ndihmë dhe materiale nëse ju nevojiten. • Para kalimit nga një klasë në tjetrën mësuesi porositi: “Mos harroni të tregoni respekt gjatë lëvizjes në korridore duke qëndruar në të djathtë dhe duke lejuar hapësirën personale”. • Duke treguar bankën ndërkohë që nxënësi hyn në klasë (për t’i kujtuar se ku duhet të ulet). • Nxënësi shikon sekuenca fotosh që nxisin larjen korrekte të duarve dhe ai me sukses lan duart para se të hajë vaktin në pushim. 	<p><i>Si mund të përdoret kjo praktikë në klasën e ciklit të lartë?</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Duke treguar një shenjë në tabelë, për të treguar se pritet qetësi para fillimit të kohës së punës së pavarur. • Rishikimi i pjesëmarrjes së grupit në veprimtari përpara fillimit të punës së grupit. • Duke firmosur në fletoren e detyrave të shtëpisë për çdo detyrë dhe duke mbajtur një listë kontrolli për dorëzimin e tyre. • Nxënësi kontrollon fletoren e shënimeve, e cila ka kujtesa vizive për mënyrën se si duhet shkruar një detyrë dhe si duhen gjetur materiale ndihmëse në shtëpi për të mundësuar përfundimin e e saj në shtëpi. 	<p><i>Çfarë duhet të shmanget kur po zbatohet kjo praktikë?</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Ndërsa po ndjek mësimin, një nxënës thërret me zë të lartë. Mësuesi thotë, “Në vend që të thërrasësh, unë do të doja që të të ngresh dorën” (Ky është një korrigjim i gabimit, erdhi pas sjelljes). • Para se t’u kërkohet nxënësve të bëjnë një detyrë, mësuesi thotë: “Bëni një punë të mirë”, ose jep sinjal me gishtin e madh lart (Kjo nuk është specifike sa duhet për të nxitur një sjellje të veçantë). • Duke përmendur vetëm “jo”-të (p.sh., mos vraponi, mos flisni) në vend që të përshkruhet sjellja e dëshiruar ose dështimi në përpjekjet për ta lidhur me pritshmëritë



2.5 KORIGJIMI I GABIMEVE

PËRDORIMI I KORIGJUESVE TË SHKURTËR, TË MUNDSHËM DHE SPECIFIK PËR T'U PËRGJIGJUR SJELLJES PROBLEMATIKE

Përshkrimi dhe veçoritë specifike <i>Çfarë strategjish mund të përdoren për të mbështetur sjelljet pozitive në klasë?</i>	Shembuj në Ciklin Fillor <i>Si mund të përdoret kjo praktikë në klasën e ciklit fillor?</i>	Shembuj në Ciklin e Lartë <i>Si mund të përdoret kjo praktikë në klasën e ciklit të lartë?</i>	Shembuj jo korrekt <i>Çfarë duhet të shmangët kur po zbatohet kjo praktikë?</i>
<ul style="list-style-type: none"> • Një deklaratë informuese, zakonisht e dhënë nga mësuesi, që jepet kur ndodh një sjellje e padëshiruar, tregon sjelljen e vëzhguar dhe i tregon nxënësit saktësisht se çfarë duhet të bëjë në të ardhmen. • Jepet shkurtimisht në mënyrë, të përmbledhur, të qetë dhe të respektueshme. Jepet zakonisht në mënyrë private. • Pasi nxënësi angazhohet në sjelljet e duhura shoqërohet me lëvdata specifike. • Tërheqja në fund të korrigjimit të gabimit dhe ridrejtimi. Shmangen "luftërat e pushtetit" 	<ul style="list-style-type: none"> • Pasi një nxënës flet me zë të lartë në klasë, mësuesi përgjigjet: "Ju lutem, ngrini dorën para se të përgjigjeni". • Kur nxënësit po flasin me zë shumë të lartë gjatë punës në grup, mësuesi u thotë: "Ju lutemi përdorni një zë pëshpëritës më të qetë gjatë punës me shokun tuaj". • Kur një nxënës ka lëvizur pa qenë e nevojshme dhe nuk është në vendin e tij, mësuesi i drejtohet: "Ju lutem, mos lëvizni nëpër klasë dhe kthehuni në vendin tuaj për të përfunduar punën". 	<ul style="list-style-type: none"> • Kur një nxënës nuk ka filluar akoma punën brenda një minute, "Joni, ju lutem filloni detyrën tuaj me shkrim" (Më vonë) "Punë e mirë të jesh i përgjegjshëm Joni, paskeni filluar detyrën". • Meqenëse nxënësi po luan me pajisjet e laboratorit në mënyrë të papërshtatshme, mësuesi i drejtohet: "Ju lutem mos luanit më pajisjet e laboratorit dhe mbajini ato në tavolinë" (Më vonë) "Faleminderit që tregoheni i kujdesshëm me pajisjet e laboratorit". 	<ul style="list-style-type: none"> • Thirrja me zë të lartë "Jo!" (Kjo nuk është neutrale apo specifike) • Një bashkëbisedim prej pesë minutash rreth asaj se çfarë po mendon nxënësi (kjo nuk është e shkurtër) • Pas dhënies së një korrigjimi të gabimit, një nxënës nuk pranon angazhimin në sjelljen e duhur. Mësuesi përsërit korrigjimin në një ton të përshkallëzuar dhe vazhdon të debatojë me nxënësin derisa pasohet me të bërtitura (Kjo është një luftë pushteti)



2.6 PËRDORIMI I STRATEGJIVE TË TJERA PËR T'IU PËRGJIGJUR SJELLJEVE PROBLEMATIKE KUR ZGJIDHEN STRATEGJITË MBAHEN PARASYSH PASOJAT POZITIVE TË PËRDORIMIT TË TYRE

Përkthimi dhe veçoritë specifike	Shembuj në Ciklin Fillor	Shembuj në Ciklin e Lartë	Shembuj jo korrekt
<i>Çfarë strategjish mund të përdoren për të mbështetur sjelljet pozitive në klasë?</i>	<i>Si mund të përdoret kjo praktikë në klasën e ciklit fillor?</i>	<i>Si mund të përdoret kjo praktikë në klasën e ciklit të lartë?</i>	<i>Çfarë duhet të shmangët kur po zbatohet kjo praktikë?</i>
<p>Injorimi i planifikuar:</p> <p>Në mënyrë sistematike dhe të qëllimshme nuk i kushton vëmendje një nxënësi kur ai ose ajo shfaq një sjellje të vogël të padëshirueshme.</p> <p>Përforcimi i diferencuar:</p> <p>Duke përforcuar sistematikisht sjell:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shkallë më të ulët e sjelljeve problematike; • Sjellje të tjera; • Një sjellje alternative të përshtatshme; • Një sjellje e përshtatshme fizikisht e papërshtatshme; 	<p>Injorimi i planifikuar:</p> <p>Gjatë një veprimtarie të grupit të madh (tërë klasa), Joni thërret me zë të lartë emrin e mësuesit për të marrë vëmendjen e tij. Mësuesi injoron thirrjen dhe vazhdon me aktivitetin.</p> <p>Përforcimi i diferencuar:</p> <p>Në të njëjtin skenar të mësipërm, mësuesi injoron thirrjet e Jonit, modelon një aftësi për të marrë vëmendjen (p.sh., ngritja e duarve), dhe menjëherë i jep vëmendjen (drejtimi dhe lavdërimet) Jonit kur ngre dorën: “Kështu tregojmë respekt! Ngritje e bukur e dorës”.</p> <p>Kur jep udhëzime para lëvizjes nga një mjedis në tjetrin, mësuesi i kërkon nxënësve të mbajnë një “flluskë” në gojë, e cila do të thotë fizikisht të mos flitet</p>	<p>Injorimi i planifikuar:</p> <p>Gjatë shpjegimit Eda ndërpret mësuesin dhe me zë të lartë drejton pyetjen e saj. Mësuesi injoron Edën derisa ajo ngadalë ngre dorën.</p> <p>Përforcimi i diferencuar:</p> <p>Mësuesi organizon konsultime të veçanta me një nxënës dhe i thotë, “Unë me të vërtetë i vlerësoj kontributet tuaja, por kam nevojë që dhe shokët e tu të kenë gjithashtu një shans për të marrë pjesë në konsultim në grup. Nëse mund t’i zvogëloni kontributet tuaja në pesë ose më pak, do të doja të takohesha me ju gjatë drekës për të folur për pjesën tjetër të ideve tuaja”.</p>	<p>Injorimi i planifikuar:</p> <p>Një nxënës po kritikon me zë të lartë një shok, duke bërë që nxënësit e tjerë të qeshin me shokun që i drejtohet. Mësuesi nuk bën asgjë</p> <p>(Kjo nuk është e parëndësishme dhe tërheq vëmendjen e bashkëmoshatarëve).</p> <p>Përforcimi i diferencuar:</p> <p>Mësuesi i qorton nxënësit çdo herë që ata bëhen pjesë e një sjelljeje problematike dhe injoron sjelljet korrekte apo të duhura.</p> <p>(Kjo është krejt e kundërta e asaj se si duhet përdorur përforcimi i diferencuar).</p>

2.6 (VAZHDIM) PËRDORIMI I STRATEGJIVE TË TJERA PËR T'IU PËRGJIGJUR SJELLJEVE PROBLEMATIKE KUR ZGJIDHEN STRATEGJITË MBAHEN PARASYSH PASOJAT POZITIVE TË PËRDORIMIT TË TYRE

Përshkrimi dhe veçoritë specifike <i>Çfarë strategjish mund të përdoren për të mbështetur sjelljet pozitive në klasë?</i>	Shembuj në Ciklin Fillor <i>Si mund të përdoret kjo praktikë në klasën e ciklit fillor?</i>	Shembuj në Ciklin e Lartë <i>Si mund të përdoret kjo praktikë në klasën e ciklit të lartë?</i>	Shembuj jo korrekt <i>Çfarë duhet të shmanget kur po zbatohet kjo praktikë?</i>
<p>Kostoja e përgjigjes:</p> <p>Fshirja/heqja e diçkaje (p.sh. dhurata, biletat, pikët) bazuar në sjelljen e nxënësit në përpjekje për të pakësuar sjelljet jo korrekte.</p> <p>Pezullimi përkundrejt përforcimit:</p> <p>Heqja për pak e: (a) diçkaje të preferuar (p.sh. aktiviteti, sendi) ose (b) nxënësit nga një mjedis i preferuar bazuar në sjelljen e padëshiruar.</p>	<p>Kostoja e përgjigjes:</p> <p>Kur një nxënës flet pa radhë, mësuesi e tërheq mënjanë, i ofron një korrigjim specifik të gabimit dhe i heq një pikë (ose një sferë) nga kolona e tij/saj (ose ena e tij/saj) në tryezën e mësuesit. Më pas nxënësit i kujtohet se si të rifillojë fitimin e pikëve të reja dhe mësuesi është i kujdesshëm për t'i dhënë rreth pesë pikë për çdo pikë të hequr.</p> <p>Pezullimi kundrejt përforcimit:</p> <p>Një grup nxënësish fillojnë të thyejnë lapsat e dhjamt me ngjyra që po përdorin në një fletë pune. Mësuesi i mbledh lapsat e dhjamt me ngjyra dhe i jep lapsa druri për të përfunduar detyrën.</p>	<p>Kostoja e përgjigjes:</p> <p>Kur një nxënës përdor gjuhë pa respekt, mësuesi reagon duke i folur mënjanë dhe i heq një pikë nga kartela e tij/saj. Mësuesi është i kujdesshëm për t'i dhënë të paktën pesë pikë (dhe vlerësime specifike) për çdo pikë të hequr.</p> <p>Pezullimi kundrejt përforcimit:</p> <p>Pasi një nxënës përplas me forcë një karrige gjatë pushimit të gjatë, mësuesi e tërheq mënjanë dhe i kujton pritshmëritë që kanë vënë dhe afishuar në mur për kohën e pushimit para se ta lejojë atë të rifillojë veprimtaritë mësimore.</p>	<p>Kostoja e përgjigjes:</p> <p>Mësuesi publikisht ngre një kartë (nga jeshile në të verdhë në të kuqe) që sinjalizon se nxënësi ka humbur mundësinë për të patur privilegje. Mësuesja me zë të lartë njofton se “karta u ngrit” dhe, kur pyetet përse, thotë: “ti e di atë që bërë”.</p> <p>(Kjo nuk analizon atë që ka bërë nxënësi gabim ose si të kthehet në rrugën e duhur. Është gjithashtu një qortim publik).</p> <p>Pezullimi kundrejt përforcimit:</p> <p>Mësuesi e largon nxënësin nga një klasë e vështirë. Nxënësit nuk i pëlqen largimi nga klasa. Ai lehtësohet nga një i rritur i preferuar dhe shpesh ndiqet nga shokët e preferuar për pjesën e mbetur të ditës.</p>

Tabela 3. Matrica e sistemeve të të dhënave për ndërhyrjet dhe mbështetjet në klasë

3.1 - 3.2 SISTEMET E TË DHËNAVE			
Përshkrimi dhe veçoritë specifike	Shembuj në Ciklin Fillor	Shembuj në Ciklin e Lartë	Shembuj jo korrekt
<p><i>Çfarë strategjish mund të përdoren për të mbështetur sjelljet pozitive në klasë?</i></p> <p>3.1 Numërimi i sjelljeve</p> <p>Regjistrohen ose dokumentohen sa <i>shpesh</i> ose sa herë ndodh një <i>sjellje (frekuenca)</i> brenda një periudhe të caktuar kohe. Konvertohet në shkallë duke bërë raportin e numërimeve për kohën (minuta ose orë) gjatë të cilës është vëzhguar.</p>	<p><i>Si mund të përdoret kjo praktikë në klasën e ciklit fillor?</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Duke zhvendosur kapëse të letrave ose një send tjetër (shkumësa etj.) nga njëri xhep në tjetrin. • Përdorimi i një numëruesi. • Aplikacion në celular ose tablet. 	<p><i>Si mund të përdoret kjo praktikë në klasën e ciklit të lartë?</i></p> <p>Sjelljet që janë të dallueshme (fillimi dhe mbarimi i qartë), të numërueshme (frekuencë e mjaftueshme për numërim) dhe e qëndrueshme (çdo incident i sjelljes është me kohëzgjatje të ngjashme)</p> <p>Shembuj:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Sa shpesh një nxënës grindet në klasë; • Sa të folura me zë të lartë kundrejt ngritjes së dorës ndodhin gjatë një ore mësimi. 	<p><i>Çfarë duhet të shmangët kur po zbatohet kjo praktikë?</i></p> <p>Sjelljet që nuk janë të dallueshme (të paqarta kur sjellja fillon ose mbaron), të numërueshme (ndodh shumë shpejt për të numëruar) ose të qëndrueshme (p.sh. sjellja zgjat për kohë të ndryshueshme).</p> <p>Shembuj jo korrekt:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Sa herë nxënësi është jashtë detyrës (nuk ka gjasa të jetë e dallueshme ose e qëndrueshme); • Sa shpesh një nxënës nuk është në vendin e vet (ka gjasa të mos jetë e qëndrueshme).
<p>3.2 Minutazhi</p> <p>Regjistrohet ose dokumentohet sa gjatë: (a) zgjat një sjellje (kohëzgjatja nga fillimi në fund), ose (b) sa kohë kalon mes sjelljeve.</p>	<p><i>Si mund të përdoret kjo praktikë në klasën e ciklit fillor?</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Kohëmatësi ose ora (dhe regjistrimi i kohës me letër dhe laps). • Aplikacion në celular ose tablet. • Përdorimi i kohëmatësit vibrues. 	<p><i>Si mund të përdoret kjo praktikë në klasën e ciklit të lartë?</i></p> <p>Sjelljet që janë të dallueshme (fillimi dhe mbarimi i qartë) dhe të vëzhgueshme drejtpërdrejtë</p> <p>Shembuj:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Sa kohë shpenzon një nxënës duke ecur nëpër klasë (koha e qëndrimit larg vendit të tij/saj); • Sa kohë harxhon një nxënës për të filluar detyrën pasi ajo është dhënë (vonesa për të filluar detyrën); • Sa kohë i duhet një nxënësi të fillojë problemin tjetër pas përfundimit të atij të fundit. 	<p><i>Çfarë duhet të shmangët kur po zbatohet kjo praktikë?</i></p> <p>Sjelljet që nuk janë të dallueshme (fillimi dhe mbarimi i qartë) ose të vëzhgueshme direkt.</p> <p>Jo-shembuj jo korrekt:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Sa kohë i duhet një nxënësi për të thënë një fjalë të papërshtatshme me katër shkronja (kohëzgjatja nuk është gjëja më kritike për të matur); • Sa kohë është larg detyrës një nxënës.

3.3 SISTEMET E TË DHËNAVE

Përshkrimi dhe veçoritë specifike <i>Çfarë strategjish mund të përdoren për të mbështetur sjelljet pozitive në klasë?</i>	Shembuj në Ciklin Fillor <i>Si mund të përdoret kjo praktikë në klasën e ciklit fillor?</i>	Shembuj në Ciklin e Lartë <i>Si mund të përdoret kjo praktikë në klasën e ciklit të lartë?</i>	Shembuj jo korrekt <i>Çfarë duhet të shmanget kur po zbatohet kjo praktikë?</i>
<p>3.3 Zgjedhja e kampionit:</p> <p>Vlerësimi se sa shpesh ndodh një sjellje duke regjistruar nëse ajo ka ndodhur gjatë një pjese të një intervali kohor (intervali të pjesshëm), gjatë gjithë intervalit (intervali i plotë), ose në fund të intervalit (marrja e mostrave momentale).</p> <p>Intervale e shkurtra çojnë në matje më të sakta.</p> <p>Intervali i pjesshëm është i përshtatshëm për sjelljet e shkurtra dhe më të shpeshta. Interesi i plotë është i përshtatshëm për sjellje më të gjata, dhe zgjedhja e kampionëve momental lehtëson shumë detyrën (ju shënoni në fund të intervalit).</p>	<p>Krijohet një tabelë, me secilën kuti që përfaqëson një interval kohor (p.sh., 30 sekonda), dhe vendoset se si do të vlerësohet (kampion i pjesshëm, i tërë, momental). Përdoret një kronometër ose një aplikacion për të ndjekur secilin interval dhe regjistrohen sipas rregullave që ju keni vendosur.</p>	<p>Sjelljet që nuk janë të dallueshme (të paqarta kur sjellja fillon ose mbaron), të numërueshme (ndodh shumë shpejt për tu numëruar) ose të qëndrueshme (p.sh., sjellja zgjat për sasi të ndryshme kohore)</p> <p>Shembuj:</p> <ul style="list-style-type: none"> Një vlerësim se sa shpesh nxënësi është jashtë detyrës (përqindja e intervaleve jashtë detyrës); Një vlerësim se sa shpesh një student është larg vendit/karriges së tij/sa (përqindja e intervaleve larg vendit tij/saj). 	<p>Sjelljet që janë të dallueshme (fillimi dhe mbarimi i qartë), të numërueshme (frekuenca e ulët për t'u numëruar) dhe të qëndrueshme (çdo incident i sjelljes ka kohëzgjatje të ngjashme).</p> <p>Shembuj jo korrekt:</p> <ul style="list-style-type: none"> Sa shpesh një nxënës shan në klasë (mund ta llogarisni këtë); Sa shumë biseda me zë kundrejt dorës së ngritur ka gjatë një ore mësimi (mësuesi mund ta numërojë këtë).



Tabela 3. Matrica e sistemeve të të dhënave për ndërhyrjet dhe mbështetjet në klasë

3.4 SISTEMET E TË DHËNAVE			
Përshkrimi dhe veçoritë specifike	Shembuj në Ciklin Fillor	Shembuj në Ciklin e Lartë	Shembuj jo korrekt
<p><i>Çfarë strategjish mund të përdoren për të mbështetur sjelljet pozitive në klasë?</i></p>	<p><i>Si mund të përdoret kjo praktikë në klasën e ciklit fillor?</i></p>	<p><i>Si mund të përdoret kjo praktikë në klasën e ciklit të lartë?</i></p>	<p><i>Çfarë duhet të shmangët kur po zbatohet kjo praktikë?</i></p>
<p>3.4 Kartat e pasojave të sjelljeve të mëparshme, raportet e incidenteve ose referimet disiplinore:</p> <p>Regjistrimi i informacionit për ngjarjet që kanë ndodhur para, gjatë ose pas një incidenti të sjelljes.</p>	<p>Shënime me laps e letër mbi formatet e parapërgatitura.</p> <p>Formate të hartuara për mbledhjen e të dhënave.</p>	<p>Sjelljet që janë të dallueshme (fillimi dhe mbarimi i qartë), të numërueshme (frekuenca e ulët për t'u numëruar), si dhe vëzhgohen dhe vlerësohen direkt të dyja, sjellja dhe konteksti.</p> <p>Shembuj:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Një zemërim i çastit (grumbull i sjelljeve) ku stafi pa atë që e parapriu dhe pasoi; • Një zënkë mes moshatarësh ku drejtuesi ishte në gjendje të mblidhte informacion rreth asaj që ndodhi para dhe pas duke e intervistuar nxënësin 	<p>Sjelljet që nuk janë të dallueshme (fillimi dhe mbarimi i qartë), të numërueshme (frekuenca e ulët për t'u numëruar), dhe / ose sjellja dhe konteksti nuk mund të vëzhgohen drejtpërdrejt.</p> <p>Shembuj jo korrekt:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Sa shpesh një nxënës shan (numërohet); • Sa kohë një një nxënës pushon në mes të detyrave.



Mjete shtesë për mësuesit

Përveç përdorimit të strategjive të bazuara në evidenca të parashikuara në hartën e mësipërme interaktive, vetëvlerësimin dhe tabelave të detajuara, mësuesit duhet të zbatojnë strategjinë e mëposhtme dhe të marrin në konsideratë udhëzimet e mëposhtme kur iu përgjigjen sjelljeve sfiduese të nxënësve.

Duke iu përgjigjur sjelljeve në klasë në mënyrë			
Funksionale	Të kujdesshme	Specifike	Në kohë
Duke iu përgjigjur sjelljes në një mënyrë që përpiqet të adresojë arsyen ose qëllimin se përse nxënësi sillet brenda situatave të caktuara, do të ndihmojë në reduktimin e mundësive që sjellja të ndodhë në të ardhmen.	Një përgjigje e saktë dhe e qëndrueshme, sa më shumë që të jetë e mundur, është thelbësore për të minimizuar sjelljet problematike dhe rritjen e sjelljeve të pajtueshme në klasë.	Kur të trajtohet sjellja e nxënësit, është mirë që të mësuesi të jetë sa më specifik që të jetë e mundur. Përdorimi i emrit të nxënësit dhe arsyes për të reaguar janë shembuj se si mësuesit mund të jenë specifik.	Duke iu përgjigjur sjelljes menjëherë pasi ajo ndodh do ta bëjë reagimin dhe përgjigjen më të fuqishme.
Llojet e sjelljes dhe përgjigjet e zakonshme			
Sjellje të përshtatshme ose të pritshme	Sjellje të rralla dhe jo korrekte	Gabimet e përsëritura dhe jo korrekte të sjelljeve të vogla dhe / ose gabime korrekte të mëdha të sjelljes	Sjelljet e menaxhuara në nivel shkolle
<ul style="list-style-type: none"> • Kur një nxënës bën një sjellje të përshtatshme, krijo mundësinë që nxënësi ta dijë duke i treguar se çfarë ai ose ajo ka bërë dhe si lidhet kjo sjellje me pritshmëritë e vëna në shkollë. • Jini sa më specifik të jetë e mundur dhe përpiquni të përdorni gjithmonë emrat e nxënësve. • Përdorni shprehje lavdëruese bashkë me strategji të tjera të falënderuese. 	<ul style="list-style-type: none"> • Kur ndodh një sjellje e keqe, përpiquni t'i jepni sa më pak që të mundeni vëmendje sjelljes. • I bëni nxënësve kujtesa për atë që pritet prej tyre. • Modeloni atë që pritet. • Përforconi atë që pritet duke përdorur lëvdata specifike ose strategji të tjera falënderuese. 	<ul style="list-style-type: none"> • Ndiqni procedurat shkollore për t'iu përgjigjur shkeljeve të rregullave dhe planeve të mbështetjes individuale të sjelljes. • Përpiquni sa të mundeni për të parashikuar se kur mund të ketë probleme. Le ta dinë nxënësit se çfarë prisni dhe merrni pak kohë për të ushtruar rutinat. • Mblidhni të dhëna për të ndihmuar në përcaktimin e arsyeve pse sjelljet ndodhin. 	<ul style="list-style-type: none"> • Ndiqni procedurat e shkollës për t'iu përgjigjur shkeljeve të rregullave dhe planeve të mbështetjes individuale të sjelljes.

Skenarë të përdorimit të strategjive NSP në klasë

Veprimtaritë e mëposhtme janë disa shembuj se si mësuesit mund t'i përdorin strategjitë në klasë për të mbështetur sjelljet e nxënësve të tyre brenda orës mësimore. Skenari i parë është një veprimtari në një klasë fillore. Skenari i dytë është aplikuar në një shkollë 9-vjeçare.

SKENARI 1. KLASA E TRETË E MËSUESE LILJANËS

BAZAT FILLESTARE TË NDËRHYRJEVE DHE MBËSHTETJES NË KLASË

Mësuese Liljana shpenzoi kohë në hartimin e kujdesshëm të rutinës të klasës së saj përpara se 25 fëmijët e klasës së tretë të vinin në shtator. Ajo me kujdes planifikoi rutinën– duke filluar nga vendi ku nxënësit do të vendosnin materialet pasi të hynin në klasë deri ku do të rreshtoheshin për të dalë dhe siguroi edhe vend fizik në klasë në mënyrë që të lehtësonte nxënësit në kryerjen e rutinave. Ajo gjithashtu shpjegoi se si do të ishte për nxënësit të ndiqnin secilën nga rutinat e vendosura duke ndjekur në të njëjtën kohë pritshmëritë e vendosura në shkollë (siguri, respekt dhe përgjegjësi), të cilat ishin miratuar dhe dokumentuar në matricën të shkollës. Në ditën e parë të shkollës, mësuese Liljana, përshëndeti nxënësit që në hyrje, u prezantua dhe ftoi nxënësit në klasë. Ajo kaloi pjesën më të madhe të ditës së parë duke i mësuar në mënyrë të qartë pritshmëritë brenda rutinave që ajo kishte vendosur në klasë dhe duke krijuar një mjedis pozitiv të nxëni. Gjatë gjithë ditës, ajo në mënyrë sistematike falenderoi me fraza specifike çdo nxënës që ndoqi rutinat (p.sh., "Joni, fakti që mbajtët mend të sillni materialet tuaja është me të vërtetë e përgjegjshme nga ana juaj, kjo është një mënyrë e shkëlqyer për të filluar vitin!"). Ajo gjithashtu shkroi dhe ftoi nxënësit të nënshkruanin një "Kushtetutë të klasës" (e njohur ndryshe edhe si një kontratë sjelljeje).



"KUSHTETUTA" E KLASËS SË

MËSUESE LILJANËS

(STRATEGJITË E PËRDORURA JANË NË KLLAPA)

Nxënësit e klasës tonë janë të respektueshëm, të përgjegjshëm dhe të sigurtë (pritshmëritë). Mësuese Liljana do të na mbështesë duke na mësuar se si mundësohet kjo gjatë aktiviteteve (udhëzime eksplicite), duke na kujtuar përditë (kujtesat) dhe duke na treguar se si po veprojmë në klasë (reagime specifike). Nëse ne do ta bëjmë këtë shumicën e kohës (gjatë 80 për qind të kampionit të kohës së vendosur) çdo ditë, ne do mund fitojmë 10 minuta kohë të dëgjojmë muzikë të qetë në fund të çdo dite mësimore (shpërblimi në grup). Gjatë kësaj kohe, ne mund të fillojmë detyrat e shtëpisë, të lexojmë një libër, ose të bëjmë një lojë të qetë me një shok gjatë dëgjimit të muzikës. Nëse nuk jemi në gjendje ta bëjmë këtë shumicën e kohës, ne do të kalojmë 10 minuta duke ripërsëritur pritshmëritë tona në klasë, në mënyrë që nesër të kemi një ditë më të mirë dhe më produktive.



Zbatimi i vazhdueshëm i praktikave pozitive dhe proaktive

Pas ditës së parë, mësuese Liljana vazhdoi me zbatimin e "Kushtetutës së Klasës së tij. Ajo i përshëndeste nxënësit çdo mëngjes, duke rikujtuar sjelljet e pritshme në fillim të secilës veprimtari në klasë, duke u siguruar që veprimtaritë e planifikuara angazhonin dhe ofronin mundësi të shumta për nxënësit, për t'u përgjigjur dhe për të qenë aktiv. Ajo u jepte nxënësve reagime specifike kur ata zhvillojnë siç duhet veprimtaritë dhe gjithçka tjetër në klasë. Ajo gjithashtu sheh se shumica e nxënësve po demonstronin sjelljen e pritshme.

Probleme të vogla të sjelljes

Me raste ndonjë nxënës kishte probleme të vogla të sjelljes. Për shembull ngandonjëherë, kur ajo shpjegonte, një nxënës fliste pa leje në vend që të ngrinte dorën për të marrë fjalën. Në vend që të nervozohet mësuese Liljana i rikujton se ky është një gabim njësoj si kur një nxënës thotë që $2+2=5$ dhe në vend që t'i bërtasë ajo e korrigjon. Për këto probleme të vogla të sjelljes mësuese Liljana i vë në dijeni nxënësit, duke theksuar që kjo nuk është një sjellje e përshtatshme dhe që pritshmëritë ishin për një sjellje tjetër dhe i jep atyre mundësinë për tu praktikuar



dhe për t'i dhënë një feedback pozitiv (psh. "Tea ngini dorën për të pyetur diçka në vend që të flisni pa leje me zë të lartë. Le ta provojmë përsëri". Pasi Tea ngrii dorën qetësisht mësuesja i dha një vlerësim pozitiv: "Faleminderit që ngrite dorën Tea. Çfarë dëshiron të ndash me klasën?"). Për shumicën e nxënësve ky korrigjim i shpejtë i gabimit i ndihmon ata të jetë në rrugën e duhur dhe t'i përgjigjen pozitivisht pritshmërive të klasës në shumicën e herëve.

Disa nxënës që angazhohen në sjellje jo korrekte

Në fillim të dhjetorit të gjithë nxënësit u detyruan të linin një javë shkollën për shkak të motit të keq. Ata u kthyen në klasë pak përpara se të merrnin pushimet e dimrit dhe shumë nga rutinat e klasës ishin ndërprerë për shkak të ndryshimeve të programit dhe orarit. Mësuese Liljana vuri re se shumë nga nxënësit e saj kishin në mënyrë të vazhdueshme sjellje jo korrekte dhe rikujtesat e saj nuk mjaftonin. Për këtë arsye ajo vendosi të shtonte strategjitë në klasën e saj. Ajo ia rimësoi dhe një herë sjelljet e pritshme, rikujtoi dhe një herë kushtetutën e klasës, shtoi numrin e herëve të kujtesave dhe shtoi edhe një stimul të ri: Çdo nxënës i cili do të zbatonte sjelljet e caktuara deri kur të binte zilja (kjo zile ishte praktikisht një orë kuzhine që mësuese Liljana e kishte improvizuar për klasën e saj dhe vendosej 15 ose 20 minuta) do të fitonte një biletë që nxënësi mund ta përdorte si "kartë dhuratash" për privilegjet e klasës (p.sh. do përdorte fotokopjen e shkollës, s'do bënte një palë detyra shtëpie etj.) në fund të javës. Me këto stimuj të shtuar, shumica e nxënësve u angazhuan sërish duke përmbushur rezultatet e pritshme të sjelljes në klasë.

Pak nxënës që angazhohen në sjellje kronike ose problematike serioze

Pa çka ndërhyrjeve të intensifikuara, mësuese Liljana vuri re se një nxënës, Deni, kishte filluar të shfaqte nivele intensive të sjelljes. Deni lëvizte shpesh nga karrigia e tij dhe ndërpriste shpesh mësimin duke hedhur mjetet mësimore të shokëve të tij në tokë ndërkohë që kalonte pranë bankave të tyre, thërriste shokët e tij (me raste edhe mësuesen) me zë të ulët dhe bërtiste me zë të lartë për të kërkuar diçka, ndërkohë që mësuesja e tij ishte duke shpjeguar mësimin. Mësuese Liljana mbledhi disa informacione. Ajo vuri re se Deni lëvizte nga karrigia e tij në fund të çdo minute përgjatë 20 minutave të kohës që përdorej për të shkruar (koha kur mësuesja ka vënë re se sjellja e Denit bëhej më problematike). Pasi dokumentoi që Deni ishte çuar nga vendi në më shumë se 85% të intervalit të kohës, mbajti shënim për gjërat që Deni thoshte dhe llogariti që Deni ishte larg nivelit të shokëve të tij në klasë. Mësuese Liljana ia përcolli shqetësimin e saj Skuadrës së Mbështetjes së Nxënësve. Skuadra vendosi që Denit mund t'i duhet më shumë mbështetje dhe kontaktoi me prindërit e fëmijës për të marrë miratimin e tyre për vlerësime të mëtejshme. Pasi morën pëlqim e tyre një skuadër mbështetëse (duke përfshirë ekspertë sjelljesh, babain e Denit dhe mësuese Liljanën) u formua në mënyrë që të përcaktonin arsyet e sjelljes dhe format e ndërhyrjes. Mësuese Liljana solli shumë informacione që ndihmuan në vlerësim (të dhëna nga ora mësimore) dhe punoi me skuadrën në mënyrë që të hartonin një plan për të mbështetur sjelljen e Denit.

SKENARI 2.

ORA E SHKENCËS NË KLASËN E NËNTË E MËSUESE IRENËS

Parimet e ndërhyrjeve në klasë

Mësuese Irena i ka dhënë mësim klasave të 9-ta për 15 vjet dhe tani dëgjoi për herë të parë për kornizën e sjelljes me shumë nivele për të trajtuar sjelljen e nxënësve. Pavarësisht se ajo e ka theksuar gjithmonë sigurinë si primare në laboratorin e saj, ajo kuptoi se ndoshta mund të kishte qenë më shumë vepruese. Prandaj, ajo vendosi ta përqafojë këtë qasje të re dhe të rishqyrtojë sjelljet në klasën e saj. Para fillimit të vitit të 16 të mësimdhënies së saj mësuese Irena vendosi të rishikonte dizejnimin fizik të klasës dhe laboratorit të saj. Ajo u siguroi që materialet ishin të sigurta dhe gjithashtu që tavolinat ishin vendosur në mënyrë të atillë që i lejonin nxënësit të kalonin lirshëm nga tavolinat e tyre në laborator dhe anasjelltas. Ajo rishikoi në mënyrë të qartë rregullat e saj dhe vendosi "kujtesa" për rutinat që ajo i konsideronte si të rëndësishme në klasën e saj. Për më tepër, përveç afishimit dhe mësimin të matricës së shkollës të sjelljes, ajo u kujdes që ti detajonte më tej (i sigurtë, i respektueshëm, i përgjegjshëm) për tre rutinat kryesore të vendosura në matricën e klasës së saj, e cila është paraqitur më poshtë.

Në ditën e parë në shtator, mësuese Irena përshëndeti nxënësit e saj sapo hyri në klasë dhe filloi mësimin e saj të parë të vitit. Ajo i kujtoi nxënësit për pritshmëritë e vendosura në shkollë, tregoi një video të krijuar nga nxënësit se si demonstrohej siguria, respekti dhe përgjegjësia në klasë (këtë e bënin të gjithë mësuesit) dhe më pas përshkroi se si zbatoheshin pritshmëritë gjatë orës së saj. Ajo përfshiu nxënësit në një kontroll të shpejtë, ku lexoi disa skenarë dhe pyeti nëse nxënësit në skenar po përmbushnin (ose nuk po përmbushnin) çdo pritshmëri. Më pas, ajo mbajti pjesën tjetër të mësimin dhe vuri në dukje se cilët nxënës shfaqnin sjellje të pritshme. Ajo e përsëriti këtë proces jo vetëm herën e parë që i futi nxënësit në laborator por periodikisht gjatë gjithë vitit.



Rregullat e mësuese Irenës

	Në leksion	Në laborator	Në bankë
I sigurtë	<ul style="list-style-type: none"> - Përdorini materialet për vete - Sigurohuni që kalimi të jetë i lirë - Mbani shënim për udhëzimet e sigurisë në laborator. 	<ul style="list-style-type: none"> - Mbani shënim për udhëzimet e sigurisë në laborator - Vendosni masat mbrojtëse në laborator - Ndiqni procedurat e sigurisë 	<ul style="list-style-type: none"> - Përdorini materialet për vete - Sigurohuni që kalimi të jetë i lirë - Rrini ulur që te maksimizoni qarkullimin dhe vëmendjen.
I respektueshëm	<ul style="list-style-type: none"> - Dëgjoni me kujdes mësimin - Mbani sytë dhe veshët nga mësuese Irena 	<ul style="list-style-type: none"> - Caktoni detyrat për çdo punë në grup dhe komunikoni planin e veprimeve - Kontrolloni me partnerin e laboratorit progresin dhe rolet e gjithë secilit 	<ul style="list-style-type: none"> - Punoni për vete - Mbani qetësi - Ngrini dorën qetësisht nëse ju duhet vëmendja e mësueses
I përgjegjshëm	<ul style="list-style-type: none"> - Mbani shënime për të dokumentuar përmbajtjen e mësimin - Nënvizoni informacionet që do t'ju duhen për të bërë detyrat e shtëpisë 	<ul style="list-style-type: none"> - Përfundoni punën e laboratorit me efektivitet - Dokumentoni procesin dhe rezultatet - Raportoni punët e laboratorit 	<ul style="list-style-type: none"> - Punoni mirë - Kërkoni ndihmë nëse ju nevojitet - Merreni punën e mbetur në shtëpi dhe dorëzoheni të nesërmen

Zbatimi i vazhdueshëm i praktikave pozitive dhe proaktive

Çdo ditë mësuese Irena përshëndet nxënësit e saj te dera duke i rikujtuar atyre aktivitetet e shënuara paraprakisht në tabelë dhe duke iu dhënë kujtesat e nevojshme për çdo veprimtari që do të zhvillohet në laborator. Ajo punoi për t'u siguruar që mësimet e saj i angazhonin dhe i siguronin nxënësve udhëzime për detyrat e dhëna. Ajo gjithashtu hartoi detyra klase dhe shtëpie që përfshinin problema më sfiduese për nxënësit. Përveç kësaj ajo vazhdimisht ju jepte nxënësve feedback pozitiv për sjelljet e duhura dhe të pritshme (p.sh., "Faleminderit që i mbani të sigurta këto pajisje. Unë besoj se ju mund të punoni edhe në laboratorë më të avancuar").



Probleme të vogla të sjelljes

Me raste nxënësit do të përfshiheshin në probleme të vogla të sjelljes. Për shembull, përgjatë orës mësimore nxënësit mund t'i përdornin mjetet laboratorike si lojë. Ajo mernte frymë thellë, i rezistonte nevojës për t'ju bërtitur nxënësve me zë të lartë dhe në vend të kësaj ajo i rikujtonte atyre se materialet duhet të përdoshin me kujdes dhe ti ruanim. Më pas ajo i falendronte ata për kontributin e tyre në ruajtjen e mjeteve dhe i rikujtonte ata t'i vendosnin në vendet përkatëse pas mbarimit të orës së laboratorit.

Disa nxënës që angazhohen në sjellje jo korrekte

Sapo afrohej pranvera mësuesja fillonte dhe i prezantonte nxënësit me punë më të vështira laboratorit. Megjithatë plani i lëndës ndërpritej herë pas here nga aktivitete shkollore (si p.sh., ekskursionet, festa) dhe mësuesja vinte re se kishte një rritje të sjelljeve jo të përshtatshme gjatë orës mësimore. Për shembull kur ajo i prezantoi ata për herë të parë me llambat me alkool një grup nxënësish filluan të luanin me ndezësit (kur ishin të fikur) dhe t'i ndiznin ato kur nuk ishte e nevojshme. Pjesa tjetër e klasës qeshte kur ajo u përpoq t'i tërhiqte vëmendjen grupit që luante me ndezësit. Për këtë arsye ajo mendoi të rishikonte pritshmëritë. Ajo gjithashtu vendosi t'i prezantonte nxënësit me një sistem

të ri sigurie në laborator. Ajo ju premtoi se nëse të gjitha pritshmëritë zbatoheshin ata do të lejoheshin të luanin ndonjëherë me mjetet e laboratorit, një herë në dy javë nëse kjo nuk paraqiste rrezik për ta. Por nëse kishte qoftë dhe një minimum rrezikshmërie në aktivitetin e paraqitur atëherë ora e laboratorit do të pezullohej deri sa nxënësit: a. të kalonin një quiz, b. të tregonin që ishin të përgjegjshëm për orën e laboratorit, c. të firmosnin një kontratë që zotoheshin se do t'i përdornin materialet me kujdes. Me të gjitha këto masa u rrit niveli i sjelljeve të përshtatshme nga nxënësit.

Nxënës që angazhohen me problem serioze ose kronike të sjelljes

Pavarësisht përpjekjeve të mësueses për të qenë proaktive, një nga nxënëset e mësuese Irenës filloi ta shqetësonte atë. Sara ishte një nxënëse, që rrinte shumë e veçuar. Kur mësuesja apo kur ndonjë bashkëmoshatar përpiquej t'i afrohej asaj, Sara do të përgjigjej vrazhdë ose thjesht do largohej. Në fillim mësuesja i la hapësirën e vet nxënëses. Por në tetor ajo kuptoi që sjellja e Sarës nuk kishte përmirësim. Megjithëse ishte shumë e thjeshtë për ta injoruar sjelljen e saj (sepse Sara nuk shqetësonte gjatë orës mësimore), mësuese Irena e bisedoi problemin me një kolege të saj dhe mori vesh se Sara rrezikonte të mbeste në dy lëndë. Mësuesja e shihte Sarën shpeshherë vetëm nëpër



korridore. Ajo e ndau shqetësimin e saj me nëndrejtorin e shkollës, të cilit i ishin caktuar klasat e 9-ta, dhe ai nxori mungesat dhe notat e Sarës nga regjistri i klasës. Ata kuptuan se periudhën e fundit Sara kishte mungesa periodike dhe nuk rrezikonte të ngelte në dy lëndë, por në 5 lëndë. (Megjithatë ata vunë re gjithashtu se Sara ka patur rezultate shumë të larta akademike më parë dhe angazhim të shpeshtë në aktivitetet shkollore). Duke patur parasysh këtë fakt mësuese Irena ju drejtua për ndihmë ekipit të specializuar të shkollës, i cili foli me prindërit e Sarës dhe vendosi të vazhdojë me kryerjen e një vlerësimi funksional të sjelljes ashtu sikurse edhe me hartimin e një plani ndërhyrjeje. Ekipi gjithashtu konsideroi edhe një mbështetje më intensive për t'u zhvilluar në bashkëpunim me Sarën dhe familjen e saj duke vënë në përdorim një proces të larmishëm. Mësuese Irena vazhdoi të ofronte mbështetje shtesë në klasë dhe ajo ishte e kënaqur që pikasi problemet e Sarës dhe se ajo po merrte tashmë ndihmën që i duhej.

Në mënyrë të përmbledhur...

Të gjitha këto strategji në klasë i vijnë në ndihmë mësuesve për të arritur rezultate pozitive për të gjithë nxënësit, të cilët kanë aftësi ndryshe, vijnë nga kultura të ndryshme dhe janë edukuar në mjedise të ndryshme. Pavarësisht se këtu theksohen strategjitë pozitive dhe parandaluese, disa

nxënësve mund t'ju duhet mbështetje shtesë për sjelljen e tyre. Si e tillë, duhet të merren në konsideratë disa supozime të rëndësishme:

- *Nxënësit dhe sjelljet e tyre nuk janë "të këqija". Më saktë, mund të themi që nxënësit përfshihen në sjellje të pahijshme apo të papërshtatshme në një kontekst apo kulturë të caktuar.*
- *Nxënësit përfshihen në sjellje të cilat për ta funksionojnë (p.sh: rezultojnë në sjellje të dëshiruara ose përforcim)*
- *Mësuesit duhet të sillen me profesionalizëm. Kjo do të thotë të planifikosh dhe të zbatosh procedura në nivel shkolle dhe klase në mënyrë të qetë, neutrale dhe serioze.*
- *Sjelljet akademike dhe sociale mësohen, ndryshohen dhe përforcohen me strategji mësimore (modelim, nxitje, monitorim dhe përforcim)*


Gjithashtu, në shtojcën IV, paraqitet një qasje e re dhe strategji e re e marrë nga përvoja të suksesshme ndërkombëtare, si një alternativë apo burim për mësuesit, për të ndihmuar fëmijët që përballen me situata stresi në jetën e përditshme me fokus të veçantë fëmijët të cilët kanë probleme psikologjike, vijnë nga kushte të vështira jetese, janë duke përjetuar ndryshime në jetën e tyre etj.





MODULI 5

**VETËVLERËSIMI
I PRAKTIKAVE
TË NSP-VE NË SHKOLLË
DHE NË KLASË**





VETËVLERËSIMI I PRAKTIKAVE TË NSP-VE NË SHKOLLË DHE NË KLASË

PRITSHMËRITË:

- Identifikimi i procesit të vetëvlerësimit në shkollë si mjet ndihmës në zbatimin e praktikave të NSP-ve
- Evidentimi i disa formateve të vëzhgimit/vetëvlerësimit të shkollës dhe klasës të përshtatshme për shkollën.
- Dallimi dhe përdorimi i instrumenteve të duhura për përmirësimin e praktikave NSP-ve në shkollë dhe në klasë.

Procesi i vetëvlerësimit dhe formatet e vetëvlerësimit të paraqitura në vazhdim janë dizajnuar për të ndihmuar ekipin e shkollës dhe njësitë e tjera organizative arsimore për (a) vlerësimet fillestare të shkollës në të cilën ekzistojnë kapacitetet për të zbatuar NSP-të; (b) planifikimin e veprimeve në nivel shkolle dhe klase për të udhëzuar shpërndarjen e burimeve gjatë procesit të zbatimit të NSP-ve; dhe (c) vlerësimet periodike të kapaciteteve të shkollës për të mbështetur implementimin dhe zgjerimin e NSP-ve.



Instrument për shkollën dhe mësuesin (Instrument hyrës – në fillim të procesit)

VEPRIMTARIA	VEPRIMTARITË E NDËRMARRA SIPAS HAPAVE	KUSH	KUR
1. Vendosja e angazhimit <ul style="list-style-type: none"> • Përfshirja e drejtuesve të shkollës • Vendosja e NSP-ve si një nga qëllimet e shkollës • Stafi zotëron rreth 80% e aftësive në këtë fushë • Një plan veprimi 1-3 vjeçar 	A		
	B		
	C		
	D		
	E		
2. Krijimi i ekipit të shkollës <ul style="list-style-type: none"> • Përfshirja e aktorëve të ndryshëm • Përfshirja e drejtuesve • Procedura efektive për funksionimin e ekipit 	A		
	B		
	C		
	D		
	E		
3. Vetëvlerësimi <ul style="list-style-type: none"> • Zhvillimi i identifikimit të nevojave si proces gjithëpërfshirës 	A		
	B		
	C		
4. Hartimi i planit të veprimit <ul style="list-style-type: none"> • Të gjithë aktorët e përfshirë • Prioritete të klasifikuara • Plan veprimi i hartuar • Plani i veprimit i prezantuar me aktorët 	A		
	B		
	C		
	D		



Instrument për shkollën
Vlerësimi i ndërhyrjeve për sjelljet pozitive në nivel shkoll

Z= zbatuar; ZP= zbatuar pjesërisht; NZ= Nuk është zbatuar

Gjendja aktuale			Karakteristikat / veçoritë	Prioriteti për përmirësim		
Z	ZP	NZ	Në nivel shkolle do të thotë që përfshin të gjithë nxënësit, të gjithë stafin dhe të gjithë mjediset e shkollës.	I lartë	Mesatar	I Ulët
			1. Janë përcaktuar një numër pritshmëri ose rregullash të shprehura qartë dhe pozitivisht.			
			2. Pritshmëritë lidhur me sjelljen e nxënësve janë mësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë.			
			3. Sjelljet e pritshme të nxënësve vlerësohen vazhdimisht.			
			4. Janë përcaktuar qartë cilat janë sjelljet e papërshtatshme.			
			5. Janë përcaktuar pasojat për sjelljet e papërshtatshme.			
			6. Është bërë dallim i qartë mes menaxhimit të sjelljes në nivel shkolle dhe atij në nivel klase.			
			7. Ekzistojnë opsione që mundësojnë vazhdimin e procesit mësimor kur ndodhin sjellje të papërshtatshme.			
			8. Janë vendosur procedurat për të adresuar situatat e rrezikshme apo emergjente.			
			9. Ekziston një ekip për të mbështetur planifikimin dhe zgjidhjen e problemeve që lidhen me sjelljen.			
			10. Stafi drejtues i shkollës është pjesëmarrës aktiv në ekipin e ndërhyrjeve për sjelljen.			
			11. Të dhënat mbi problemet që lidhen me sjelljen janë grumbulluar dhe përmbledhur në një sistem vlerësimi.			
			12. Format e sjelljeve të papërshtatshme të nxënësve u raportohen ekipeve për vendim-marrje aktive në intervale të rregullta kohore (p.sh. mujore).			
			13. Shkolla ka strategji formale për të informuar familjet mbi sjelljet e pritshme nga nxënësit në shkollë.			
			14. Janë zhvilluar aktivitete trajnuese për nxënësit bazuar në të dhënat e shkollës.			
			15. Ekipi i shkollës, mbështetës i sjelljes, ka një plan vjetor.			
			16. I gjithë stafi i shkollës është i përfshirë drejtpërdrejtë ose jo drejtpërdrejtë në ndërhyrjet e parashikuara në nivel shkolle.			
			17. Ekipi i shkollës monitorohet dhe mbështetet vazhdimisht nga specialistët e njësive lokale arsimore.			
			18. Shkollës i është kërkuar të raportojë për klimën e shkollës, nivelin e disiplinës ose sjelljen e nxënësve të paktën një herë në vit.			

Instrument për shkollën
Vlerësimi i ndërhyrjeve për sjelljet pozitive në nivel shkolle

Z= zbatuar; ZP= zbatuar pjesërisht; NZ= Nuk është zbatuar

Gjendja aktuale			Karakteristikat / veçoritë	Prioriteti për përmirësim		
Z	ZP	NZ	Mjediset jashtë klasës janë vendet dhe periudhat kohore brenda shkollës, përveç klasës, theksohet të mbikëqyrjet sjellja e nxënësve (P.sh., korridoret dhe hollet, oborri i shkollës, palestra, biblioteka, autobusi/furgoni i shkollës, etj.).	I lartë	Mesatar	I Ulët
			1. Sjelljet e pritshme të nxënësve në klasë dhe në shkollë zbatohen edhe në mjediset jashtë klasës.			
			2. Sjelljet e pritshme të nxënësve mësohen edhe në mjediset jashtë klasës.			
			3. Monitoruesit vëzhgojnë dhe mbikëqyrin aktivisht nxënësit (lëvizin, skanojnë dhe ndërveprojnë) me nxënësit në mjediset jashtë klasës.			
			4. Ka shpërblime për përmbushjen e sjelljeve të pritshme nga nxënësit në mjediset jashtë klasës.			
			5. Veçoritë e mjedisit fizik/arkitekturor të shkollës janë modifikuar për të kufizuar (a) mjediset e pa mbikëqyrura, (b) shenjat e paqarta të lëvizjes, dhe (c) hyrjen dhe daljen e papërshtatshme nga oborri i shkollës.			
			6. Përcaktimi me një grafik i lëvizjes së nxënësve siguron një numër të përshtatshëm të nxënësve në mjediset jashtë klasës.			
			7. Stafi ka mundësi të herëpashershme për zhvillimin dhe përmirësimin e aftësive të mbikëqyrjes aktive të sjelljes.			
			8. Gjendja e sjelljes së nxënësve dhe praktikat e menaxhimit vlerësohen periodikisht.			
			9. I gjithë stafi është i përfshirë direkt ose indirekt në menaxhimin e mjediset jashtë klase.			
Emri i shkollës _____				data	_____	

Instrument për shkollën
Vlerësimi i ndërhyrjeve për sjelljet pozitive në nivel shkolle

Z= zbatuar; ZP= zbatuar pjesërisht; NZ= Nuk është zbatuar

Gjendja aktuale			Karakteristikat / veçoritë	Prioriteti për përmirësim		
Z	ZP	NZ	Mjediset e klasës janë mjediset ku zhvillohet mësim në të cilat mësuesi(it) mbikëqyrin dhe mësojnë nxënësit dhe grupet e nxënësve.	I lartë	Mesatar	I Ulët
			1. Sjelljet e pritshme të nxënësve dhe rutinat në klasë janë të përcaktuara pozitivisht dhe shpallur qartë.			
			2. Sjelljet problematike apo të papërshtatshme janë përcaktuar qartë.			
			3. Sjelljet e pritshme të nxënësve dhe rutinat në klasë janë mësuar drejtpërsëdrejti.			
			4. Sjelljet e pritshme të nxënësve përgëzohen / shpërblehen rregullisht.			
			5. Sjelljet problematike shoqërohen me pasojat përkatëse.			
			6. Procedurat për sjelljet e pritshme & jo të përshtatshme janë në përputhje me ato të vendosura në nivel shkolle.			
			7. Ka opsione në bazë klase për të lejuar vazhdimin e mësimin kur ndodh një sjellje e papërshtatshme.			
			8. Mësimdhënia dhe kurrikula janë në përputhje me aftësitë e nxënësve.			
			9. Nxënësit përjetojnë nivele të larta të suksesit akademik.			
			10. Mësuesit kanë mundësi për të patur asistencë dhe rekomandime (vëzhgime, këshillime & trajnime).			
			11. Kalimet nga veprimtaritë mësimore në ato jo mësimore janë korrekte dhe efektive.			
Emri i shkollës _____				data	_____	

Instrument për shkollën
Vlerësimi i ndërhyrjeve për sjelljet pozitive në nivel shkolle

Z= zbatuar; ZP= zbatuar pjesërisht; NZ= Nuk është zbatuar

Gjendja aktuale			Karakteristikat/vecoritë	Prioriteti për përmirësim		
Z	ZP	NZ	Ndërhyrjet individuale të nxënësve janë mbështetjet specifike për nxënësit që përfshihen në sjellje kronike të papërshtatshme (1% -7% e të regjistruarve).	I lartë	Mesatar	I Ulët
			1. Zhvillohen rregullisht regjistrime për të identifikuar nxënësit me sjellje kronike problematike.			
			2. Ekziston një proces i thjeshtë për mësuesit që të kërkojnë asistencë.			
			3. Një ekip për mbështetjen e sjelljes përgjigjet menjëherë (brenda 2 ditëve) për nxënësit që paraqesin sjellje kronike problematike.			
			4. Ekipi i mbështetjes së sjelljes ka një individ të aftë në kryerjen e vlerësimit funksional të sjelljes.			
			5. Persona burimore të shkollës përdoren për të kryer planifikimin mbështetës bazuar në vlerësimin funksional të sjelljes.			
			6. Anëtarë të familjeve dhe/ose të komunitetit janë përfshirë kur është e nevojshme dhe e mundur.			
			7. Shkolla ka krijuar mundësi formale që prindërit të marrin trajnime mbi strategjitë prindërore mbështetëse të sjelljeve pozitive.			
			8. Sjelljet janë monitoruar dhe janë siguruar të dhëna për ekipin e mbështetjes së sjelljes.			
Emri i shkollës _____				data	_____	

Shkolla mbështet mësuesit në mënyra të ndryshme për të përmirësuar zbatimin e praktikave efektive të NSP-ve në klasë. Në këtë proces, mësuesit mund të zgjedhin vetë aftësitë që ata dëshirojnë të përmirësojnë dhe të vëzhgojnë në klasën e tyre. Një qasje, tjetër në procesin e përmirësimit, është përdorimi i vëzhgimeve të kryera nga kolegët. Formatet e mëposhtme paraqesin formularë të vëzhgimit/vetëvlerësimit të klasës me synim përmirësimin e praktikave NSP-ve.

Fishë vetëvlerësimi: Menaxhimi i klasës

Mësuesi _____ Vlerësuesi _____ Datë _____

Veprimtaria mësimore	Koha e fillimit _____		
	Koha e mbarimit _____		
Numëro çdo sjellje pozitive të nxënësit	Totali _____	Numëro çdo sjellje negative të nxënësit	Totali _____

Llogarit sa pozitive në raport me ato negative: _____ nga 1



Praktika e menaxhimit të klasës	Vlerësimi	
1. Kam rregulluar orenditë në klasë në mënyrë që të minimizoj grumbullimin në një zonë dhe shpërqendrimin	Po	Jo
2. Kam maksimizuar strukturën dhe dhënë udhëzime të qarta në klasën time (p.sh., rutina të qarta në klasë, udhëzime specifike, etj.).	Po	Jo
3. Kam afishuar, mësuar, rishikuar dhe përforcuar tre pritshmëri pozitive apo rregulla (tre l-të: i sigurtë, i respektueshëm, i përgjegjshëm).	Po	Jo
4. Kam informuar më shpesh dhe rregullisht për sjelljet e duhura sesa për sjelljet që nuk duhet të ndodhin.	Po	Jo
5. Kam krijuar mundësi të shumta për secilin nxënës që të përgjigjet dhe të marrë pjesë gjatë veprimtarive mësimore.	Po	Jo
6. Veprimtaritë mësimore të organizuara kanë angazhuar aktivisht nxënësit në mënyrat dhe metodologjitë vëzhguese.	Po	Jo
7. Kam vëzhguar klasën vazhdimisht gjatë orës mësimore (p.sh., duke lëvizur, skanuar, etj.).	Po	Jo
8. Kam injoruar ose dhënë qortime/ridrejtime të shpejta, direkte dhe të qarta në përgjigje të sjelljeve të papërshtatshme.	Po	Jo
9. Kam në zbatim një sërë strategjish/sistemesh për njohjen dhe mësimin e sjelljeve të duhura (p.sh., sistemi i pikëve që mund të fitohen, falenderimet, etj.).	Po	Jo
10. Në përgjithësi, kam dhënë reagim specifik në përgjigje të gabimeve të sjelljeve sociale dhe akademike dhe përgjigje konkrete.	Po	Jo
Pikët e përgjithshme të menaxhimit të klasës: 10 – 8 "Po" = "Shumë mirë"	Sa "Po" _____	



Fishë e planit të veprimeve për përmirësimin e menaxhimit të klasës

Qëllimi i këtij vlerësimi është

(a) të përcaktohet se në çfarë mase sigurohen si duhet praktikat e menaxhimi efektiv të klasës dhe

(b) hartimi i një plani veprimi për të përmirësimin ose ruajtjen e gjendjes, bazuar në këtë informacion. Ky vlerësim dhe plan veprimi mund të plotësohen si një "vetë vlerësim" ose nga një vëzhgues.

1. Zgjidhet një veprimtari mësimore e drejtuar nga mësuesi e cila ka një rezultat të nxëni specifik.
2. Gjatë zhvillimit të veprimtarisë numërohet numri i kontakteve pozitive apo negative të nxënësit që ndodhin gjatë veprimtarisë.
3. Pas veprimtarisë,
 - a. mblidhni numrin e kontakteve pozitive dhe negative dhe llogarisni raportin e atyre pozitive krahasuar me ato negative.
 - b. vlerësohet nëse çdo praktikë e menaxhimit të klasës është e dukshme.
 - c. mblidhet numri i "Po"-ve për të përcaktuar pikët e përgjithshme të menaxhimit të klasës.
 - d. bazuar në pikët e gjetura zhvillohet një plan veprimi për përmirësimin e mëtejshëm apo ruajtjen e gjendjes.

PLANI I VEPRIMIT		
#	NIVELI AKTUAL I PERFORMANCËS	STRATEGJITË E PËRMIRËSIMIT APO RUAJTJES





NOBODY SECOND CHOICE
UGLY DUMB WIMP POOR
LOSER STUPID
ANOREXIC BABY
PIG FAKE LONELY
WORDS HURT PATHETIC
NERD HURT DULL
DISGUSTING
FAILURE
RETARD SLUT
WORSE
DEAR

SHTOJCA

**Shembuj formatesh dhe
modelesh të përdorura në
shkollë dhe në klasë**



Pritshmëritë e klasës dhe rregullat

Praktika: Rregullat / pritshmëritë e klasës të cilat përputhen me pritshmëritë e gjithë shkollës, afishohen dhe iu referohet rregullisht.

Çfarë janë?

- Pritshmëritë vlerësohen si sjellje dhe qëndrime për të arritur sukses.
- Rregullat janë kritere specifike për arritjen e pritshmërive.
- Rregullat plotësojnë këto 5 udhëzime.

Udhëzime për zhvillimin e rregullave

Udhëzime:	Kjo do të thotë:	Shembuj:	Jo shembuj:
I vëzhgueshëm	Mund ta shoh atë	Ngrije dorën dhe prit të të drejtohen	Jep më të mirën
I matshëm	Mund ta numëroj atë	Silli materialet	Qëndro gati për të nxënë
E formuluar pozitivisht	I tregoj nxënësve çfarë të bëjnë	Këmbët dhe duart pranë vetes	Jo zënka
Të kuptueshme	Fjalori i përshtatshëm për moshën/klasën	Këmbët dhe duart pranë vetes	Ruaj hapësirën personale (fëmijët e moshës së vogël nuk e kanë konceptin e hapësirës personale)
Gjithmonë të aplikueshme	Jam i aftë të zbatoj vazhdimisht	Qëndro në zonën e përcaktuar	Qëndro ulur deri sa të jepet leje për të lëvizur



Zbatimi

- Përfshihen nxënësit në hartimin e rregullave.
- I bëni nxënësit të angazhohen për rregullat.
- Mësoni rregullat e klasës duke demonstruar shembuj.
- Monitoroni dhe jepni reagime të shpeshta kur nxënësit ndjekin rregullat.
- Ndani rregullat me familjet dhe të tjerët.

Instrument i vetëvlerësimit të mësuesit

Karakteristikat e vetëvlerësimit	Po	Jo	Në proces
1. Rregullat e mia të klasës përputhen me pritshmëritë e gjithë shkollës (p.sh., i sigurtë, i respektueshëm, i përgjegjshëm)			
2. Rregullat e mia në klasë janë të dukshme, të matshme, të deklaruara pozitivisht, të kuptueshme dhe gjithmonë zbatohen.			
3. Unë kam 5 ose më pak rregulla për secilën pritshmëri.			
4. Rregullat e mia në klasë janë të afishuara në mënyrë të dukshme.			
5. Kam zhvilluar mësimet për të mësuar rregullat në klasë.			
6. I referohem rregullave rregullisht kur bashkëveprojmë me nxënësit.			
7. Është hartuar një orar mësimor që përfshin mësimet e rregullave në klasë dhe janë në dosje në zyrën e drejtorit.			
8. 80% e nxënësve të mi mund t'i tregojnë pritshmëritë dhe rregullat e klasës.			



Procedurat dhe rutinat e klasës

Praktika: Procedurat në klasë përcaktohen, postohen, mësohen dhe referohen rregullisht.

Çfarë janë?

- Procedurat janë metoda ose procese për mënyrën se si gjërat bëhen brenda klasës.
- Procedurat janë modele për kryerjen e detyrave në klasë.
- Ato krijojnë një vizion të një studenti të suksesshëm.
- Kur procedurat mësohen, vendosen rutinat që i ndihmojnë nxënësit të përmbushin pritshmëritë në klasë.

Zbatimi

- Hapat për krijimin e procedurave:
 - ♪ Bëni një listë të procedurave që do të ndihmojnë në krijimin e parashikueshmërisë dhe strukturës në klasën
 - ♪ Përcaktoni rezultatin e dëshiruar
 - ♪ Shkruani hapat që nxënësit duhet të bëjnë për të përfunduar detyrën
 - ♪ Shkruani procedurat në mënyrë ato janë të vëzhgueshme, të matshme, të deklaruara pozitivisht, të kuptueshme, gjithnjë të zbatueshme
- Krijoni postera që janë në gjuhën miqësore të nxënësve për t'i dhënë stafit dhe nxënësve një kujtesë vizuale.
- I mësoni direkt, i ushtroni rregullisht gjatë gjithë vitit dhe i përgëzoni nxënësit kur ndjekin procedurat.

Karakteristikat e vetëvlerësimit	Po	Jo	Në proces
1. Janë identifikuar procedurat kryesore të klasës.			
2. Procedurat e mia në klasë janë afishuar në mënyrë të dukshme.			
3. Procedurat në klasë mësohen drejtpërdrejt.			
4. Procedurat në klasë rishikohen dhe praktikohen rregullisht gjatë gjithë vitit shkollor.			
5. Nxënësit marrin vlerësime të larta dhe reagime specifike pozitive kur ndjekin procedurat në klasë.			
6. 80% e nxënësve të mi mund të tregojnë dhe të demonstrojnë procedurat e klasës.			



Model i kodit të sjelljes në shkollë

Kodi i sjelljes		
	Në klasë	Në korridor
I respektueshëm	<ul style="list-style-type: none"> • Ngrini dorën për të folur • Shmangni përdorimin e gjuhës së papërshtatshme • Dëgjoni me respekt • Flisni me edukatë • Respektoni pronën e shkollës. • Mbajeni klasën e pastër dhe të rregullt. 	<ul style="list-style-type: none"> • Shmangni përdorimin e gjuhës së papërshtatshme • Mbajini korridoret e pastër dhe të rregullt • Mos flisni me zë të lartë.
I përgjegjshëm	<ul style="list-style-type: none"> • Ejani në kohë në klasë. • Mbajini shënim detyrat e shtëpisë. • Ndiqni udhëzimet e mësuesit. • Plotësoni detyrat e përditshme. • Pranojini pasojat e sjelljeve negative, pa diskutuar. 	<ul style="list-style-type: none"> • Ecni direkt për në klasë. • Ecni nga e djathta juaj nëpër korridore. • Ndiqni gjithmonë udhëzimet e mësuesve. • Pranojini pasojat e sjelljeve negative, pa diskutuar.
I sigurtë	<ul style="list-style-type: none"> • Mbajini mjetet shkollore për vete. • Rrini në vendin e paracaktuar. • Ndiqni procedurat e sigurisë në zona të veçanta dhe daljet e emergjencës. 	<ul style="list-style-type: none"> • Shmangini kontaktet fizike. • Mos vraponi.



Kodi i sjelljes		
	Në tualet	Në bibliotekë
I respektueshëm	<ul style="list-style-type: none"> Mbajini tualetet e pastra dhe të rregullta Respektoni privatësinë e të tjerëve Respektoni pronën e shkollës. 	<ul style="list-style-type: none"> Flisni me zë të ulët Respektoni pronën e shkollës Kini respekt kur flasin të tjerët Bashkëpunoni me njeri tjetrin.
I përgjegjshëm	<ul style="list-style-type: none"> Ndiqni udhëzimet e dhëna Pranojini pasojat e sjelljeve negative pa diskutuar Raportoni vandalizmat te mësuesit Përdorini banjat në mënyrë dhe në kohë të përshtatshme. 	<ul style="list-style-type: none"> Ndiqni udhëzimet e mësuesve Pranojini pasojat e sjelljeve negative pa diskutuar. Përdorini ambientin siç duhet Përdoreni internetin për qëllime shkollore dhe kërkimi. Kthejini materialet në kohë.
I sigurtë	<ul style="list-style-type: none"> Mos nxitoni Lani duart Shmangni kontaktin fizik dhe lojërat në tualet. 	<ul style="list-style-type: none"> Shmangni kontaktet fizike. Përdorini siç duhet mjetet mësimore.



Kodi i sjelljes		
	Në mbledhje	Në lagje
I respektueshëm	<ul style="list-style-type: none"> • Dëgjoni me kujdes. • Duartrokisni kur duhet. 	<ul style="list-style-type: none"> • Respektoni pronën e tjetrit. • Respektoni anëtarët e komunitetit. • Shmangni përdorimin e gjuhës së papërshtatshme.
I përgjegjshëm	<ul style="list-style-type: none"> • Ndiqni udhëzimet e stafit të shkollës. • Pranojini pasojat e sjelljeve negative pa diskutuar. • Shmangni kontaktin fizik. 	<ul style="list-style-type: none"> • Njoftoni prindërit për situatat problematike. • Përdorni gjithmonë trotuarët për të ecur
I sigurtë	<ul style="list-style-type: none"> • Ecni për një • Uluni në vendin dhe shokët e paracaktuar • Dilni pa zhurmë dhe në rresht për një. 	<ul style="list-style-type: none"> • Kaloni rrugën te vijat e bardha. • Bindjuni semaforëve. • Ecni në rrugë të mbikëqyrura



II. Modele veprimtarish

Në vazhdim prezantohen disa shembuj veprimtarish që zhvillohen në klasë me qëllim mësimin nga ana e nxënësve të rregullave dhe procedurave që çojnë në ndryshimin pozitiv të sjelljes dhe në parandalimin e sjelljeve problematike. Mësuesit janë të lirë të parafrzojnë ose ta përpunojnë materialin, sipas nevojës.

Në klasë

Rezultatet e veprimtarisë:

Nxënësit do të jenë në gjendje që të:

- rendisin tre rregullat (pritshmëritë) më kryesore për ta në klasë dhe në shkollë;
- shpjegojnë pse rregullat janë të rëndësishme; dhe
- japin shembuj të asaj se si do jenë rregullat në klasën e tyre.

Vendndodhja: Klasa

Materialet që nevojiten: Tabela e rregullave, markera, tabela e zezë.

- Shfaqni një sinjal (sinjal që bashkë me nxënësit e keni vendosur më parë) se veprimtaria po fillon. Falenderoni nxënësit që i përgjigjen shpejt sinjalit dhe bëjnë shpejt kontaktin me sy me mësuesin dhe heshtin. Kujtoni nxënësit për pritshmëritë e veprimtarisë.
- Pyesni, "Cilat janë rregullat/pritshmëritë e klasës?" (Prisni përgjigjen e nxënësve individualisht ose në grup "i sigurtë, i përgjegjshëm, i respektueshëm – Tre I-të")
- Pyesni, "Përse i kemi këto rregulla/pritshmëri?" (Jepjani fjalën ndonjë vullnetari. Shpjegoni se te gjithë kanë rregulla dhe është e drejta jonë të ndjehemi të sigurtë dhe të respektuar. Të gjithë nxënësit kanë të drejtë të mësojnë. Rregullat mbrojnë të drejtat tona.)



- Pastaj bëni pyetjet e mëposhtme :
 - ♪ “Çfarë duhet të shihte apo të dëgjonte një vizitor në klasën tonë që të kuptonte se ne jemi të sigurtë? ”
 - ♪ “Çfarë duhet të shihte apo të dëgjonte një vizitor në klasën tonë që të kuptonte se ne jemi të përgjegjshëm?”
 - ♪ “Çfarë duhet të shihte apo të dëgjonte një vizitor në klasën tonë që të kuptonte se ne jemi të respektueshëm?”
- (Opsionale) Kërkojini klasës ti hedhë një sy shembujve poshtë çdo rregulli. Pyesni, “Hidhini një sy shembujve poshtë çdo rregulli. Cili nga këto do të ishte i përgjithshëm për të gjitha mjediset dhe jo vetëm në klasë”? Qarkoni shembujt që janë për të gjitha mjediset.
- Thoni, “Le të krahasojmë listën e shembujve me listën e rregullave që kemi në klasë. Ka ndonjë shembull të rëndësishëm që i mungon listës tonë”?
- Në këtë moment zgjidhni disa procedura apo rregulla për t’i praktikuar në klasë në atë moment. Për shembull: Si të tregoni se jeni duke dëgjuar, Si të lëvizni nga njëra klasë te tjetra. Integrojeni praktikën në procedura të tjera të gjithë ditës mësimore sa herë të keni mundësi.
- Bashkë me nxënësit mendoni dhe sugjeroni masa dhe mënyra se si do të shpërblehen ata që respektojnë rregullat e vendosura.



Pritshmëritë në klasë

Në të gjitha mjediset	Në klasë
<p>I sigurtë</p> <ul style="list-style-type: none">• Punoni, luani dhe udhëtoni të sigurtë• Ecni të sigurtë• Kujdes me duart dhe këmbët se mund të lëndoni tjetrin	<ul style="list-style-type: none">• I përdorni materialet mësimore me kujdes
<p>I respektueshëm</p> <ul style="list-style-type: none">• Përdorni intonacion, fjalë dhe sjellje të respektueshme• Respektoni sendet e të tjerëve• Mos e ndërprisni të nxënësin e dikujt tjetër• Përdorni aftësitë e juaja për zgjidhjen e problemeve.	<ul style="list-style-type: none">• Flisini me zë të ulët• Respektoni të tjerët kur flasin
<p>I përgjegjshëm</p> <ul style="list-style-type: none">• Kujdesuni për veten dhe për materialet• Lini të pastër mjedisin• Ndiqni udhëzimet e të rriturve• Jini të ndershëm me fjalët dhe veprimet tuaja.	<ul style="list-style-type: none">• Jepni gjithmonë më të mirën tuaj• Përgatituni për të mësuar.



Korridoret dhe Tualetet

Rezultatet e veprimtarisë:

Nxënësit do të jenë në gjendje që të:

- ♪ rendisin tre rregullat më kryesore për ta në korridore;
- ♪ shpjegojnë pse rregullat janë të rëndësishme;
- ♪ japin shembuj të asaj se si do jenë rregullat në korridore;
- ♪ demonstroi procedurat/rregullat në korridor dhe tualet.

Vendi: Diskutoni në klasë, më pas praktikoni procedurat në korridor.

Materialet që nevojiten: korridoret/tualetet, letër, markera,

- ✎ Shfaqni një sinjal (sinjal që bashkë me nxënësit e keni vendosur më parë) se veprimtaria po fillon. Falenderoni nxënësit që i përgjigjen shpejt sinjalit dhe bëjnë shpejt kontaktin me sy me mësuesin dhe heshtin. Kujtojeni nxënësve pritshmëritë e kësaj veprimtarie. Praktikohuni, sipas nevojës.
- ✎ Për një kohë të shkurtër përsërisni rregullat kryesore që keni në klasë "i sigurtë, i përgjegjshëm, i respektueshëm – Tre I-të" dhe tregoni arsyet pse i kemi këto rregulla.
- ✎ Për secilën nga pyetjet që vijon: fillimisht drejtoni pyetjen, më pas kërkojini nxënësve ta diskutojnë me shokun/shoqen që kanë pranë dhe pastaj prisni përgjigjet. Përgjigjet e nxënësve i shënoni në tabelë ose në një tabak muri.
 - ♪ "Në korridoret e shkollës, çfarë duhet të shihet apo të dëgjonte një vizitor që të kuptonte se ne jemi të sigurtë?"
 - ♪ "Në korridoret e shkollës, çfarë duhet të shihet apo të dëgjonte një vizitor që të kuptonte se ne jemi të përgjegjshëm?"
 - ♪ "Në korridoret e shkollës, çfarë duhet të shihet apo të dëgjonte një vizitor që të kuptonte se ne jemi të respektueshëm?"
- ✎ Thoni: "Le ti krahasojmë listën e shembujve më poshtë me tabelën që gjendet e varur në korridor. A ka ndonjë shembull të rëndësishëm për të qenit të sigurtë, të përgjegjshëm dhe të respektueshëm të cilin nuk e kemi shënuar?"



- ✎ Bëni një 'ecje si praktikë' përgjatë korridoreve, duke theksuar shembujt e një sjelljeje të mirë. Grupe nxënësish do të praktikojnë në korridore nën mbikëqyrjen e mësuesit. Nxënësit do të përgjigjen me sinjalin 'hesht' duke bërë kontaktin sy më sy me të rriturin, duke imituar sinjalin për disa sekonda dhe duke proceduar më pas në heshtje. Nxënësi që është lider i grupit do të ndalojë në korridor dhe to të presë sinjalin e nisjes nga mësuesi. Pikat e ndalesës përfshijnë: këndet nga të cilat do të merret kthesa, shkallë, hyrje klasash. Nxënësit që do të vizitojnë dentistin, oficerin e sigurisë, psikologun etj., do ti duhet të marrin një leje dhe të specifikojnë vendin se ku do shkohet.
- ✎ Mbylleni duke i kujtuar nxënësve rregullat për të qenë të sigurtë, të përgjegjshëm dhe të respektueshëm në korridore.

Pritshmëritë në korridore

Në të gjitha mjediset	Korridore/tualete
<p>I sigurtë</p> <ul style="list-style-type: none"> 🎵 Lëvizni, luani dhe udhëtoni të sigurtë. 🎵 Kujdes me duart dhe këmbët se mund të lëndoni tjetrin. 	<ul style="list-style-type: none"> 🎵 Ecni gjithmonë në të djathtë 🎵 Ndaloni në çdo vend që diskutuam më sipër (cepa, hyrje klasash etj.)
<p>I respektueshëm</p> <p>Përdorni intonacion, fjalë dhe sjellje të respektueshme</p> <ul style="list-style-type: none"> 🎵 Respektoni sendet e të tjerëve 🎵 Mos i ndërprisni apo shqetësoni ato që po bëjnë mësim 🎵 Përdorni aftësitë e juaja për zgjidhjen e problemeve. 	<ul style="list-style-type: none"> 🎵 Qëndroni në heshtje dhe në rresht 🎵 Respektoni privatësinë e tjetrit në tualet
<p>I përgjegjshëm</p> <ul style="list-style-type: none"> 🎵 Kujdesuni për veten dhe për materialet. 🎵 Lini të pastër mjedisin 🎵 Ndiqni udhëzimet e stafit 🎵 Jini të ndershëm me fjalët dhe veprimet tuaja. 	



III. SHEMBUJ SHPËRBLIMESH PËR NXËNËSIT

Në klasat e fillores nxënësi mund:

- ☺ Të ndihmojë në një klasë tjetër.
- ☺ Të dalë në tabelën e nderit.
- ☺ Të jetë lider në lojë, gjatë një ore mësimore.
- ☺ Të jetë asistenti i mësueses për një ditë.
- ☺ Të zgjedhë librin që do lexojë mësuesja në klasë.
- ☺ Të zgjedhë muzikën që do dëgjojë klasa gjatë një ore mësimore.
- ☺ Të zgjedhë lojën që do luajë klasa gjatë orës së fizikuturës
- ☺ Të zgjedhë cilin problem të detyrës së shtëpisë do të zgjidhë mësuesja.
- ☺ Të bëjë gjysmën e një detyre klase.
- ☺ Të vizatojë me shkumës.
- ☺ Të fitojë një biletë për një koncert/teatër të shkollës.
- ☺ Të fitojë një çertifikatë.
- ☺ Të fitojë një send: një litar, një top etj.
- ☺ Të rrijë në kompjuter pak kohë më shumë se shokët e klasës.
- ☺ Të fitojë një orë mësimore jashtë klase me të gjithë shokët dhe shoqet e klasës.
- ☺ Të fitojë "një ditë pa detyra shtëpie"
- ☺ Ta bëjë pushimin e gjatë pak kohë më shumë se shokët.
- ☺ Të ndihmojë klasat pasardhëse me detyrat e klasës.
- ☺ Të mësojë diçka të re në kompjuter nga mësuesi i informatikës (si të shkruajë shpejt, si të ndryshojë shkrimin në word, të shtojë muzikë etj.)
- ☺ Të zgjedhë një lojë gjatë pushimit të madh që do ta luajë me klasën dhe me mësuesen kujdestare.
- ☺ Të luajë në kompjuter.
- ☺ T'i lexojë një libër klasës së tij/saj.
- ☺ Të fitojë një "dhuratë misterioze" (bllok shënimesh, fjalëformuese, libër, ngjyra etj)
- ☺ Të lejohet të bisedojë me një shok/shoqe me zë të ulët në fund të klasës për pak minuta.
- ☺ Të marrë një shënim mirënjohjeje për t'ia treguar prindërve.
- ☺ Të fitojë një vazo me lule për në shtëpi.
- ☺ Të fitojë mjete mësimore: lapsa, stilolapsa, ngjyra, fletore vizatimi, gomë, stilolapsa me ngjyra etj
- ☺ Të marrë një lavdërim nga mësuesja.
- ☺ Të ulet te tavolina e mësueses për një ditë ose për një sasi të konsiderueshme kohe.
- ☺ T'i mësojë klasës një lojë të re.
- ☺ Të përdorë shkumës me ngjyra.
- ☺ Të shohë një video/film të shkurtër në pushimin e madh.



(vazhdim) SHEMBUJ SHPËRBLIMESH PËR NXËNËSIT

Në ciklin e lartë nxënësi mund:

- ☺ Të organizojë një festë për shkollën në palestër, në sallat e kompjuterit, në bibliotekë, etj.
- ☺ Të jetë asistent i mësuesit të fizikut për një ditë, ose një ndeshje midis klasave.
- ☺ Të ketë mundësinë t'i mësojë shokëve/shoqeve të klasës një temë mbi fushën e tij të interesit
- ☺ Të zgjedhë një temë të lirë dhe të bëjë një prezantim me Powerpoint për klasën e tij.
- ☺ Të zgjedhë një detyrë shtëpie për klasën.
- ☺ Të fitojë një biletë për një ndeshje futbollit, basketbollit etj.
- ☺ Të zgjedhë mentorim nga një i rritur për një aktivitetet në orën mësimore (bankë, punë dore etj.)
- ☺ Të mësojë si të luajë shah.
- ☺ Të mësojë diçka më shumë në kompjuter (të dizajnojë, të vizatojë etj.).
- ☺ Të marrë një orë mësimi falas për një sport, që ai/ajo pëlqen.
- ☺ Mundësi për të veshur xhins dhe bluzë sportive në shkollë, në vend të uniformës së shkollës.
- ☺ Fletë lavdërimi për prindërit për të firmosur.
- ☺ Të jetë ambasadori i shkollës gjatë vizitës së shkollave të tjera.
- ☺ Të ullet te tavolina e mësueses për një ditë.
- ☺ Të zgjedhë një DJ, që ai/ajo preferon, për festat e shkollës.
- ☺ Të pijë një kafe me mësuesen kujdestare.
- ☺ Të zgjedhë një problem, që e ka patur detyrë shtëpie, të cilin mësuesja duhet ta zgjidhë për të gjithë klasën.
- ☺ Të ndihmojë mësuesen në klasat që hasin vështirësi.
- ☺ T'i mësojë nxënësit me aftësi të kufizuar lojëra didaktike



IV. “MINDFULNESS” DHE TEKNIKA TË NDRYSHME PËR MENAXHIMIN E STRESIT

Stresi dhe faktorët e tij mbi shëndetin

Të gjithë në ditët e sotme artikulojmë fjalën stres dhe përballemi me të, gjatë ndërveprimit me kolegë, familjarë dhe fëmijët tanë. Këta të fundit e perceptojnë në mënyrë direkte gjendjen tonë. Duket sikur stresi në një farë mënyre qarkullon kudo, nga shtëpia e marrim me vete dhe “transportojmë” në shkollë dhe e kundërta. Por kur ka filluar të përdoret si term? Origjina e termit stres daton që në shek. 17 dhe vjen nga shkencat fizike, inxhinjria, etj. ku stresi tregonte presionin që mund të duronin strukturat fizike, metalike etj. Stresi është një kompleks reagimesh që na shfaqen kur ndeshemi me çdo ndodhi që prish ekuilibrin tonë dhe që sforcon apo kapërcen fuqitë tona përshtatëse. Pra është një kërcënim i mirëqenies sonë, presion ose ndryshim që kërkon një përshtatje ndaj situatës së re. Me stres kuptojmë një gjendje, reagim të organizmit tonë ndaj shkaqeve të ndryshme të brendshme apo të jashtme. Fenomeni i stresit përfshin ndodhinë stresante dhe reagimet që kemi ndaj tij. “Stres” quajmë reagimet që ka organizmi ynë, ndërsa «Stresor» quajmë shkaktarët që na sjellin stres.

Faktorët që mund të shkaktojnë stres mund të jenë fizikë (sëmundjet, plagët, dhimbja, faktorë atmosferikë etj.) ose psikologjik (konflikti, frustracioni etj.). Stresi është një mekanizëm fiziologjik thelbësor që na lejon të reagojmë ndaj stimuljeve, pas reagimit, në fakt duhet të vijë një fazë rikuperimi dhe kthimi në funksionet normale (homeostaza), por shpesh nuk ndodh kështu pasi mbetemi në një gjendje distresi të mbartur. Mënyra se si ne reagojmë ndaj kërkesave të stresit në jetën tonë quhet përshtatje dhe ekzistojnë tre të tilla: keqpërshtatja, përshtatja dhe kompetenca. Stresi ka tre faza. E para është “Alarmi”, është reagimi i menjëhershëm ndaj stresit. Organizmi mobilizon rezervat e tij mbrojtëse për të përballuar stresorin. Ai gjithashtu, përgatitet për situatë urgjence duke rritur vigjilencën dhe duke aktivizuar Sistemin Nervor Simpatik (SNS). Reagimi fiziologjik i alarmit nënkupton “luftë ose ikje” dhe është një mekanizëm i përsosur mbrojtës. Gjatë kësaj faze rriten rrahjet e zemrës rritet presioni i gjakut, rritet niveli i sheqerit në gjak, zmadhohen pupilat e syve, muskujt tendosen, çlirohet adrenalina ngadalësohet tretja etj. Faza e dytë është “Rezistenca”, nëse mobilizimi i organizmit është i suksesshëm, por stresanti vazhdon të veprojë në fazën e rezistencës. Duket në fakt, sikur organizmi po kthehet në normalitet, sikur i është adaptuar gjendjes kërcënuese, por rezistenca ndaj stresorit është në nivelin më të lartë dhe nuk mund të zgjasë pa kufi. Kjo i kushton shtrenjtë organizmit duke bërë që



forca e sistemit imunitar të bjerë dukshëm dhe rezervat e organizmit fillojnë të mbarojnë dhe ai bëhet më i ndjeshëm ndaj sëmundjeve. Faza e tretë është "Rraskapitja". Gjatë kësaj faze rezervat e organizmit kanë shtuar, niveli i sheqerit në gjak dhe gjëndrat adrenale nuk funksionojnë siç duhet dhe sistemi imunitar bie. Organizmi bëhet pre e sëmundjeve dhe infeksioneve. Në prezencën e stresanteve fizikë të ashpër dhe mungesën energjive të reja mund të shfaqen çrregullime të rënda të funksioneve të organizmit apo dhe vdekje.

Stresi mund të jetë një nga faktorët që shkakton sëmundje të ndryshme si: Hipertensioni (prej adrenalines dhe noradrenalines shtohen rrahjet e zemrës që rritin sasinë e gjakut, kjo çon në rritje të tensionit dhe kortizoli në tepricë çon në ngushtim të enëve të gjakut). Hemorragjia cerebrale (çarje e enëve të gjakut në tru prej rritjes së tensionit të gjakut). Ataku i zemrës, dhe kanceri, gjithashtu ndikohen nga stresi, nga ndrydhja e emocioneve, zemërimi, ankthi, depresioni. Sekretimi i tepërt i kortizolit prej stresit, çon në pakësimin e limfociteve (qelizat e bardha të gjakut) duke sjellë rënie të sistemit imunitar. Por duhet të themi që shkenca në ditët e sotme na ka pajisur me teknika që kanë rezultuar nga më efikasat për të parandaluar shumë nga sëmundjet e përmendura më lart.

Çfarë është "Mindfulness" dhe si ndikon ajo tek shëndeti ynë

Jon Kabat-Zinn përkufizoi "Mindfulness" si vetëdije, e cila vjen nga të paturit vëmendje të qëllimshme në momentin që ndodhesh. Kjo arrihet duke e fokusuar vëmendjen tonë me qëllim, tek momenti i tanishëm pa qenë gjykues për atë çka është apo do të vijë. "Mindfulness" mund të konsiderohet një gjendje, një praktikë ose tipar. Ne mund të kemi një moment të (gjendjes) së "Mindfulness" ose të kemi një tendencë të "Mindfulness" (tipar). Ne gjithashtu mund të bëjmë praktikë të qëllimshme të "Mindfulness" duke përdorur posturën dhe aktivitetet të ndryshme: duke u ulur në mënyrë "Mindfulness", duke ecur në mënyrë "Mindfulness", ose duke ngrënë "Mindfulness". Praktika formale e "Mindfulness" na drejton më tepër në përmirësimin e tiparit.

Modeli konceptual i "Mindfulness" bazohet në dy komponentë kryesorë: ndërgjegjësim mbi kohën aktuale dhe qetësi. Ndërgjegjësimi mbi kohën aktuale, i referohet një gjendjeje stabël, të qartë dhe alerte të momenteve që jemi duke jetuar. Në momentin që vetë-ndërgjegjësohemi për momentin aktual ne e ndjejmë momentin duke patur një ndjesi sensoriale si për shembull të parit, tingujt, ndjesitë, mendimet, dhe ne jemi të ndërgjegjshëm për gjendjen tonë. Ndërgjegjësimi për kohën



aktuale shihet si një kombinim i stabilitetit, qartësisë dhe të qenit alert. Imagjinoni sikur po shihni hënën në një teleskop, por nëse teleskopi tundet, është shumë e vështirë ta shohim të plotë hënën e njëjta gjë ndodh me fokusin e vëmendjes tonë në momentin aktual duke mos qenë të ndërgjegjshëm. Hëna gjithashtu do të turbullohej nëse lentja nuk do të ishte në fokus. Në praktikën e “Mindfulness” vizioni bëhet më i qartë. Ne mund të kapim detaje, karakteristika të imëta të eksperiencës tonë. Si përfundim duhet të jemi alert për momentin prezent. Nëse ne shohim hënën nga një teleskop i fokusuar dhe i qëndrueshëm por jemi përgjumësh nuk do të shohim detajet. Kur ne praktikojmë “Mindfulness” përqendrojmë vëmendjen, dhe mbetemi vigjilent ndaj objektit të vëmendjes sonë. Elementi i dytë i “Mindfulness” është qetësia. Qetësia është një term shumë i përdorur në kontekstin e praktikës së “Mindfulness” dhe mund të përkufizohet si një ndjenjë ekuilibri konjektiv-emocional. Qetësia ka kuptime të ndryshme: lehtësim, mosmanipulim i përvojës dhe tolerancë, intensifikimi dhe zhdukje e përvojave subjektive. Si përfundim, ne e përkufizojmë “Mindfulness” si: të pranishëm të ndërgjegjshëm në momentin aktual dhe me qetësi.

Në dekadat e fundit, janë bërë shumë studime lidhur me benefitet që sjell praktikimi i teknikave të “Mindfulness”. Kërkimet kanë vërtetuar që të fokusuarit tek eksperiencia prezente dhe të pranuarit të saj pa asnjë gjykim mund të na ndihmojë të jemi më të lumtur. “Mindfulness” mund të prekë shumë aspekte psikologjike të mirëqenies tonë, duke përmirësuar humorin, duke rritur emocionet positive, duke ulur ankthin, dhe duke ulur reagimet emocionale. Ekzistojnë evidenca të shumta shkencore për përfitimet që sjell “Mindfulness”, tek truri i njeriut duke ndikuar pozitivisht si tek struktura ashtu edhe tek funksioni. Përdorimi i teknikave të “Mindfulness” sjell në parandalimin e sëmundjeve të zemrës, alzajmerit dhe ndikon pozitivisht në aftësitë konjiktive. Ai gjithashtu ndihmon për të patur një vetëdije më të madhe lidhur me marrëdhëniet dhe se si ti menaxhojmë ato (duke përfshirë edhe ato në shtëpi), duke ofruar një kuptim më të gjerë mbi vetë-vlerësimin dhe optimizimin. “Mindfulness” ndikon tek sistemi imunitar, ul stresin, ankthin dhe depresionin tek fëmijët dhe të rriturit.

Neuroshkenca sugjeron se praktikata e “Mindfulness” mund të kenë më shumë ndikim në aftësitë njohëse, kur truri është në fazat më të hershme të zhvillimit. Kjo ndodh sepse truri i zhvillon lidhjet në lobin parabolllor më shpejt gjatë fëmijërisë. Megjithëse edhe të rriturit mund të përfitojnë nga meditimi për të reduktuar stresin dhe lodhjen fizike, por efektet e tij në rritjen e vëmendjes dhe kontrollit konjitiv janë më pak ndikuese se sa tek të vegjlit.

Një studim i vitit 2015 zbuloi se fëmijët e klasave të katërta dhe të pesta që ndoqën një program meditimi katër mujor, treguan



përmirësime në aftësitë njohëse, memorien afatgjatë dhe patën rezultate më të mira në matematikë. Një studim i publikuar së fundmi në revistën akademike "Mindfulness" zbuloi përmirësime të ngjashme në rezultatet matematikore të nxënësve të klasave të pesta me mungesë të përqendrimit dhe sjellje hiperaktive. Këto studime tregojnë se praktikat medituese kanë aftësinë të ndryshojnë strukturën e funksionimit të trurit në atë mënyrë që rrit suksesin akademik.

Shkolla të ndryshme në botë kanë filluar përdorimin e kësaj qasje me mësues dhe fëmijë dhe kombinimi me NSP-të ka sjellë rezultate të mahnitshme në gjendjen psikologjike dhe fizike duke bërë të mundur përmirësimin e arritjeve në shkollë sidomos nga fëmijë të cilët vijnë nga situata të vështira ekonomike-sociale. Fëmijët duhen ndihmuar për të njohur shqetësimin, të menaxhojnë situatat stresuese dhe të mësojnë strategji për t'ia dalë në provime. "Mindfulness" në shkolla nuk është vetëm për fëmijët, por sidomos për ata që kujdesen për ta. Përfitimet që sjellin praktikat mbi mësuesit, drejtuesit dhe stafin e shkollës ka vite që studiohen dhe rezultojnë shumë efikase. Këto përfitime lidhen me vetë-rregullimin emocional dhe uljen e stresit, me nivelin e vetë-vlerësimit dhe efikasitetin e të shpjeguarit.

Disa nga teknikat e mindfulness?

Kur u mësojmë të rinjve dhe fëmijëve të jenë më të vetëdijshëm për emocionet, mjedisin dhe vendimet e tyre, ne i ndihmojmë ata të bëhen më të qëllimshëm në përgjigjet dhe veprimet e tyre. Hulumtimet mbi "Mindfulness" tregojnë si se si praktika e saj ndihmon nxënësit me probleme në përqendrim duke i sjellë përfitime në rregullimin emocional, duke rritur dhembshurinë për të tjerët dhe duke i qetësuar ata. Më poshtë do të ofrojmë disa ushtrime praktike mbi "Mindfulness" që mund t'i përdorni në klasë në çdo kohë.

Qetësia dhe meditimi

Materiale të nevojshme: një orë, muzikë (Opsionale)

Në periudhën fillestare, kur fëmijët nuk kanë praktikuar meditim, është e vështirë t'u kërkohet atyre që të kalojnë kohë të gjatë (për shembull 30 minuta) në qetësi, por mund të fillohet çdo ditë nga pak minuta (p.sh, 2 minuta) dhe duke e rritur çdo ditë më shumë. Mund të vendosni së bashku me fëmijët një sfidë mujore të re të quajtur sfida e "heshtjes" dhe të shihet deri në sa minuta meditim kanë bërë deri në fund të muajit duke e shënuar në një poster. Ju mund të filloni me ngadalë të praktikoni momente



qetësie në klasën tuaj duke filluar nga fikja e dritave dhe vendosja e një muzike të qetë. Kërkojuni nxënësve të gjejnë një vend komod dhe të ulen të qetë. Mësuesi u komunikon fëmijëve se objekti i sfidës do të jetë të mbahen sytë të mbyllur, të ulen në qetësi dhe përqendrohen në frymëmarrjen ngadalë. Nxitini nxënësit që të mos flasin dhe të shqetësohen. Ata duhet të përipiqen të ulen sa më shumë që të jetë e mundur dhe nëse mendimet e tyre enden, i udhëzoni me mirësi të sjellin vëmendjen përsëri në frymëmarrje. Në fund bëni të gjithë një shtriqje të mirë të muskujve dhe pyetini se si shkoi seanca. Ditën tjetër provoni tre minuta e kështu me radhë.

Të ushqyerit në mënyrë “mindfulness”

Materiale të nevojshme: orë, karamela ose dicka tjetër.

Së pari, zgjidhni ushqimin që do të përdorni, mund të jetë një karamela, një kokërr rrushi i thatë, një biskotë etj. Vendosini orën deri në tre minuta. Ideja është që fëmijët të mbyllin sytë, të mbajnë (karamelen) në gojë dhe të përqendrohen në të pa e përtypur. Për tre minuta, fëmijët duhet të përqendrohen në karamelen që shkrihet ngadalë në gojë. Nëse mendimet e tyre devijojnë ata thjesht duhen sjellë përsëri tek ushtrimi. Ata duhet të përqendrohen në përvojën shqisore-shijen dhe ndjenjën e objektit. Kjo lë kështu një shenjë të shijshme për mendjen dhe ndërton kapacitetin për qetësi dhe përqendrim.

Sfida ndijore

Materiale të nevojshme: orë, muzikë qetësuese.

Kjo sfidë mund të bëhet kudo-brenda klasës, në shesh lojërash, ose në një udhëtim në terren. Kërkojuni nxënësve të ulen të qetë dhe t'i mbyllin sytë. Merrni pak frymë thellë së bashku dhe më pas ofroni këto kërkesa:

1. Për 30 sekonda, përqendrohuni thellë në atë që mund të dëgjoni, duke u fokusuar edhe në zhurmat më të vogla.
2. Për 30 sekonda, përqendrohuni thellë në erën që vjen.
3. Për 30 sekonda, përqendrohuni thellë në atë që mund të ndjeni.
4. Për 30 sekonda shikoni lart dhe përqendrohuni thellë në atë që mund të shihni.



Skanimi i trupit dhe relaksimi progresiv

Materiale të nevojshme: Meditim i skanimit të trupit.

Me anë të meditimit të skanimit të trupit nxënësit kalojnë duke u fokusuar në çdo pjesë të trupit në qetësi me sy mbyllur. Nxënësit duhet të ulen ose të shtrihen në mënyrë të qetë. Ata ftohen të dëgjojnë muzikë relaksuese që mësuesi mund të vendosë në sfond. Mësuesi u kërkon nxënësve të marrin frymë thellë, të ndalin mendimin në pjesë të ndryshme të trupit duke i kërkuar atyre që të ç'tensionojnë muskujt dhe të përqendrohen në relaksin që sjell ai moment. Kjo praktikë mund t'i ndihmojë nxënësit të mësojnë të vlerësojnë tensionin dhe të përdorin frymën e tyre për ta çliruar atë.



V. “FUNKSIONET E GRUPIT TEKNIK, NDËRSEKTORIAL DHE VLERËSIMI I PLOTË I RASTIT TË FËMIJËS NË NEVOJË PËR MBROJTJE”

1. Gjatë vlerësimit të plotë të rastit të fëmijës në nevojë për mbrojtje, grupi teknik, ndërsektorial, në bashkëpunim me NJMF-në/PMF-në, ka detyrimin të bëjë vlerësimin e:

- a) Nivelit të rrezikut për fëmijën;
- b) Nevojave për shërbime për fëmijën dhe familjen;
- c) Kapaciteteve dhe burimeve të fëmijës dhe familjes;
- ç) Ndërhyrjeve të nevojshme dhe veprimeve të caktuara, që duhen ndërmarrë nga organe apo struktura të caktuara, me qëllim garantimin e mbrojtjes apo të aksesit të drejtave të fëmijës, si dhe mbrojtjes apo fuqizimit të familjes;
- d) Nevojës për marrjen e masës së mbrojtjes apo të një urdhri mbrojtjeje, në kuadër të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar;
- dh) Nevojës për të plotësuar ose për të proceduar më tej me një aplikim për azil, sipas ligjit nr. 121/2014, “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”, në rastin e fëmijëve të pashoqëruar, të huaj apo pa shtetësi, që ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Anëtarët e GTN-së, në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në pikën 1, të këtij kreu, kanë detyrimin të:

- a) Të shkëmbejnë me NJMF-në çdo informacion të disponueshëm për situatën e fëmijës dhe familjes;
- b) Të kryejnë vizita të përbashkëta me PMF-në në mjedisin ku jeton fëmija;
- c) Të ofrojnë ekspertizë sipas fushave apo institucioneve që ata përfaqësojnë në vlerësimin e nivelit të rrezikut, nevojave për shërbime, identifikimin dhe caktimin e ndërhyrjeve të nevojshme;
- ç) Të konfirmojnë informacionin e ndarë në mbledhjen e GTN-së nga PMF-ja dhe anëtarë të tjerë të grupit, i cili do të merret parasysh gjatë hartimit të planit individual të mbrojtjes;
- d) Të mbështesin dhe të lehtësojnë pjesëmarrjen e fëmijës në mbledhje dhe marrjen e mendimit të tij, nëpërmjet vënies në dispozicion të mjeteve logjistike apo të mbështetjes institucionale, në rastet kur kjo kërkohet nga NJMF-ja.



FUNKSIONET E GRUPIT TEKNIK, NDERSEKTORIAL NË MIRATIMIN DHE ZBATIMIN E PLANIT INDIVIDUAL TË MBROJTJES

1. Në përfundim të vlerësimit të plotë, anëtarët e GTN-së bien dakord për projektplanin individual për mbrojtjen e fëmijës, bazuar në interesin më të lartë të fëmijës.
2. Plani individual për mbrojtjen e fëmijës dokumentohet me formularin e planit individual të mbrojtjes (PIM), i cili përmban detyrat dhe përgjegjësitë që ndërmerren nga secili anëtar i grupit, sipas strukturës që përfaqëson, për të përmbushur nevojat e fëmijës dhe të familjes, si dhe afatet kohore për përmbushjen e tyre.
3. Plani individual për mbrojtjen e fëmijës plotësohet dhe firmoset nga të gjithë anëtarët e grupit teknik, ndërsektorial, sipas formularit përkatës, dhe miratohet nga drejtori i strukturës përkatëse për shërbimet shoqërore në bashki. Pas miratimit nga drejtori, PMF-ja ndan zyrtarisht me të gjithë anëtarët e GTN-së PIM-in përfundimtar.
4. Në raste të veçanta, kur nevojat e fëmijës brenda PIM-it nuk adresohen plotësisht nga shërbimet brenda territorit të bashkisë apo njësisë administrative, drejtuesi i GTN-së identifikon ofruesin e shërbimit të nevojshëm më të afërt. Drejtuesi i GTN-së dhe përfaqësuesi i Shërbimit Social Rajonal, anëtar i GTN-së, përgatisin kërkesën për mbështetje nga struktura e identifikuar si shërbimofruese. Kjo kërkesë

- i drejtohet edhe agjencisë, në rastet kur është e nevojshme ndërhyrja në nivel qendror.
5. Çdo anëtar i GTN-së është përgjegjës për ndërmarrjen e veprimeve, të ndërhyrjeve apo ofrimit të shërbimeve të përcaktuara në PIM-in për fëmijën, prindërit apo anëtarët e familjes së tij.
6. Çdo anëtar ka detyrimin të raportojë menjëherë te drejtuesi i GTN-së nëse një veprim, ndërhyrje apo shërbim i marrë përsipër për t'u garantuar nga ana e tyre, në kuadër të PIM-it, nuk po realizohet, duke treguar arsyet dhe shkaqet konkrete.
7. Çdo anëtar i GTN nuk mund dhe nuk duhet të presë mbledhjen e radhës së GTN-së për të referuar pamundësitë e përmbushjes së detyrave e përgjegjësive të tij, por duhet, në mënyrë proaktive, të bashkëpunojë me strukturat e mbrojtjes në nivel vendor dhe, nëse është e nevojshme, edhe në nivel qendror, me qëllim realizimin e zbatimit të PIM-it.
8. Anëtarët e GTN-së detyrohen të bashkëveprojnë e të bashkërendojnë punën me njëritjetrin për gjetjen e zgjidhjes më të mirë, bazuar në interesin më të lartë të fëmijës, dhe mbajnë përgjegjësi për vendimet e marra në këto takime.
9. Drejtuesi i GTN-së informon agjencinë në rastet e mosveprimit apo të mospjesëmarrjes së pajustificuar të



anëtarëve të GTN-së dhe agjencia fillon procedurën e vendosjes e të shqyrtimit të kundërvajtjes administrative, si dhe merr masat përkatëse, sipas nenit 69, të ligjit nr. 18/2017.

10. PMF-ja ka të drejtë të kërkojë informacion, sipas afateve të përcaktuara në PIM, për realizimin e ndërhyrjeve, të shërbimeve dhe detyrave të tjera të anëtarëve të GTN-së dhe autoriteteve të tjera, te të cilat është referuar rasti.

11. PMF/NJMF-ja referon tek agjencia rastet kur autoritetet shtetërore nuk bashkëpunojnë e ndihmojnë në aksesin dhe realizimin e të drejtave të fëmijëve, me qëllim zbatimin e sanksioneve të parashikuara në ligjin nr. 18/2017, "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës".

FUNKSIONET E GRUPIT TEKNIK, NDËRSEKTORIAL NË RISHQYRTIMIN E PLANIT INDIVIDUAL TË MBROJTJES DHE MBYLLJEN E RASTIT

1. GTN-ja ka detyrimin të bëjë rishqyrtimin formal të PIM-it të fëmijës në nevojë për mbrojtje të paktën 6 javë, pas hartimit të planit të parë, dhe, në mënyrë periodike, çdo 3 muaj.

2. Paraprakisht, nga anëtarët e GTN-së ose për shkaqe të justifikuara, drejtuesi i GTN-së mund të vendosë që mbledhjet për rishqyrtimin e PIM-it të fëmijës në nevojë për mbrojtje të bëhen para afatit të parashikuar ose më shpesh, në varësi të situatës dhe nevojave.

3. Në takimin e rishqyrtimit të PIM-it, të gjithë anëtarët raportojnë për zbatimin e planin, rezultatet që janë arritur dhe ndryshimet që ata propozojnë për uljen e nivelit të rrezikut.

4. PMF-ja merr masa për reflektimet e ndryshimeve në PIM, bazuar në shënimet e bëra në formularin përkatës, i cili firmoset nga anëtarët e grupit teknik, ndërsektorial.

5. PMF-ja raporton te GNT-ja për mbylljen e rastit nëse, pas rishqyrtimit të PIM-it, rezulton se:

a) veprimet, ndërhyrjet e ndërmarra dhe shërbimet e ofruara sipas PIM-it janë kryer dhe se fëmija është jashtë rrezikut e nuk ka shqetësime të tjera për të;

b) fëmija ka mbushur moshën 18 vjeç. Nëse PMF-ja vlerëson se fëmija ka ende nevojë për shërbime, rasti do të referohet për marrjen e shërbimeve të përshtatshme të strukturat që mbulojnë shërbime për këtë grup-moshë dhe në përputhje me nevojat e individit;

c) fëmija vdes;

ç) fëmija ka ndryshuar vendbanim ose vendqëndrim dhe dosja e tij është transferuar.

6. Në çdo rast, vendimi për mbylljen e rastit merret nga drejtori i strukturës së shërbimeve shoqërore në bashki, bazuar në rekomandimin e NJMF-së, pas rishqyrtimit të PIM-it në GTN.



FUNKSIONET E GRUPIT TEKNIK, NDËRSEKTORIAL DHE VLERËSIMI I PLOTË I RASTIT TË FËMIJËS NË NEVOJË PËR MBROJTJE

1. Gjatë vlerësimit të plotë të rastit të fëmijës në nevojë për mbrojtje, grupi teknik, ndërsektorial, në bashkëpunim me NJMF-në/PMF-në, ka detyrimin të bëjë vlerësimin e:

- a) Nivelit të rrezikut për fëmijën;
- b) Nevojave për shërbime për fëmijën dhe familjen;
- c) Kapaciteteve dhe burimeve të fëmijës dhe familjes;
- ç) Ndërhyrjeve të nevojshme dhe veprimeve të caktuara, që duhen ndërmarrë nga organe apo struktura të caktuara, me qëllim garantimin e mbrojtjes apo të aksesit të drejtave të fëmijës, si dhe mbrojtjes apo fuqizimit të familjes;
- d) Nevojës për marrjen e masës së mbrojtjes apo të një urdhri mbrojtjeje, në kuadër të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", të ndryshuar;
- dh) Nevojës për të plotësuar ose për të proceduar më tej me një aplikim për azil, sipas ligjit nr. 121/2014, "Për azilin në Republikën e Shqipërisë", në rastin e fëmijëve të pashoqëruar, të huaj apo pa shtetësi, që dodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Anëtarët e GTN-së, në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në pikën 1, të këtij kreu, kanë detyrimin të:

- a) Të shkëmbejnë me NJMF-në çdo informacion të

disponueshëm për situatën e fëmijës dhe familjes;

- b) Të kryejnë vizita të përbashkëta me PMF-në në mjedisin ku jeton fëmija;

- c) Të ofrojnë ekspertizë sipas fushave apo institucioneve që ata përfaqësojnë në vlerësimin e nivelit të rrezikut, nevojave për shërbime, identifikimin dhe caktimin e ndërhyrjeve të nevojshme;

- ç) Të konfirmojnë informacionin e ndarë në mbledhjen e GTN-së nga PMF-ja dhe anëtarë të tjerë të grupit, i cili do të merret parasysh gjatë hartimit të planit individual të mbrojtjes;

- d) Të mbështesin dhe të lehtësojnë pjesëmarrjen e fëmijës në mbledhje dhe marrjen e mendimit të tij, nëpërmjet vënies në dispozicion të mjeteve logjistike apo të mbështetjes institucionale, në rastet kur kjo kërkohet nga NJMF-ja.

FUNKSIONET E GRUPIT TEKNIK, NDËRSEKTORIAL NË MIRATIMIN DHE ZBATIMIN E PLANIT INDIVIDUAL TË MBROJTJES

1. Në përfundim të vlerësimit të plotë, anëtarët e GTN-së bien dakord për projektplanin individual për mbrojtjen e fëmijës, bazuar në interesin më të lartë të fëmijës.

5. Çdo anëtar i GTN-së është përgjegjës për ndërmarrjen e veprimeve, të ndërhyrjeve apo ofrimit të shërbimeve të përcaktuara në PIM-in për fëmijën, prindërit apo anëtarët e familjes së tij.



6. Çdo anëtar ka detyrimin të raportojë menjëherë te drejtuesi i GTN-së nëse një veprim, ndërhyrje apo shërbim i marrë përsipër për t'u garantuar nga ana e tyre, në kuadër të PIM-it, nuk po realizohet, duke treguar arsyet dhe shkaqet konkrete.

7. Çdo anëtar i GTN nuk mund dhe nuk duhet të presë mbledhjen e radhës së GTN-së për të referuar pamundësitë e përmbushjes së detyrave e përgjegjësisë të tij, por duhet, në mënyrë proaktive, të bashkëpunojë me strukturat e mbrojtjes në nivel vendor dhe, nëse është e nevojshme, edhe në nivel qendror, me qëllim realizimin e zbatimit të PIM-it.

10. PMF-ja ka të drejtë të kërkojë informacion, sipas afateve të përcaktuara në PIM, për realizimin e ndërhyrjeve, të shërbimeve dhe detyrave të tjera të anëtarëve të GTN-së dhe autoriteteve të tjera, te të cilat është referuar rasti.

ndryshimet që ata propozojnë për uljen e nivelit të rrezikut.
2. NJMF-ja apo PMF-ja përgatit dhe qarkullon procesverbalin brenda një jave, në formë të shkruar dhe nëpërmjet postës elektronike, për të vërtetuar saktësinë e përmbajtjes. Në takimin e radhës, procesverbali firmoset nga të gjithë anëtarët e GTN-së.

FUNKSIONET E GRUPIT TEKNIK, NDËRSEKTORIAL NË RISHQYRTIMIN E PLANIT INDIVIDUAL TË MBROJTJES DHE MBYLLJEN E RASTIT

1. GTN-ja ka detyrimin të bëjë rishqyrtimin formal të PIM-it të fëmijës në nevojë për mbrojtje të paktën 6 javë, pas hartimit të planit të parë, dhe, në mënyrë periodike, çdo 3 muaj.

3. Në takimin e rishqyrtimit të PIM-it, të gjithë anëtarët raportojnë për zbatimin e planin, rezultatet që janë arritur dhe

